

**DRAFT**

**VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR I  
PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL TË  
PRIZRENIT 2025 - 2033**

## **PËRMBAJTJA**

|                                                                               |    |
|-------------------------------------------------------------------------------|----|
| I. HYRJE                                                                      | 6  |
| II. KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE                                        | 7  |
| 2.1 Direktiva për Vlerësimin Strategjik Mjedisor e BE-së                      | 7  |
| 2.2 Direktiva të tjera të BE-së                                               | 8  |
| 2.3 Strategjia 2020 e BE-së                                                   | 8  |
| 2.4 Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit të Kombeve të Bashkuara            | 8  |
| 2.5 Konventat ndërkombëtare mjedisore                                         | 9  |
| 2.6 Historiku legjislativ, organet administrative përgjegjëse                 | 10 |
| III. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E VSM                                             | 12 |
| 3.1 Procesi dhe metodologjia e VSM                                            | 13 |
| IV. ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE                                             | 15 |
| Pozita gjeografike                                                            | 15 |
| Veçoritë mjedisore                                                            | 16 |
| V. PËRMBLEDHJE E PROBLEMEVE MJEDISORE                                         | 34 |
| Zonat me probleme mjedisore                                                   | 34 |
| VI. PËRMBLEDHJE E PËRMBAJTJES SË PZHK                                         | 36 |
| Vizioni dhe skenarët e zhvillimit                                             | 36 |
| Qëllimet dhe objektivat e PZHK sipas fushave tematike                         | 37 |
| Koncepti i zhvillimit hapësinor                                               | 47 |
| Aspekte përkatëse të gjendjes aktuale mjedisore                               | 55 |
| Veçoritë natyrore kryesore të komunës dhe zonat që ndikohen                   | 57 |
| Zonimi i territorit të komunës                                                | 57 |
| Mjedisi i ndërtuar dhe kultura                                                | 62 |
| VII. PARIME, OBJEKTIVA DHE KRITERE MJEDISORE                                  | 64 |
| Objektivat e VSM                                                              | 64 |
| Parime, objektiva e kriteret mjedisore që kufizojnë zhvillimin komunal        | 64 |
| Qëllimet strategjike                                                          | 63 |
| Përmirësimi i mjedisit, cilësia, ofrimi i shërbimeve, dhe efienca e energjisë | 69 |
| VIII. NDIKIMET E MUNDSHME MJEDISORE DHE MASAT PËR ZBUTJEN E TYRE              | 71 |
| Metodologjia për përcaktimin e shkallës së ndikimeve                          | 71 |
| Përcaktimi i Indikatorëve dhe Kriteret e Vlerësimit                           | 72 |
| IX. MASAT E NEVOJSHME PËR MBROJTJEN E MJEDISIT                                | 75 |
| Konceptet zhvillimore të përdorimit të tokës, qasja policentrike              | 75 |
| Ndryshimet në klimë                                                           | 76 |
| Cilësia e ajrit                                                               | 76 |

|                                                                                                                      |    |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| Energjia e rinovueshme                                                                                               | 77 |
| Mbrojtja e tokës                                                                                                     | 78 |
| Mbrojtja e resurseve ujore                                                                                           | 78 |
| Reduktimi i rrezikut nga fatkeqësitë natyrore                                                                        | 79 |
| Rritja e mbrojtjes, menaxhimit dhe ruajtjes së qëndrueshme të të gjitha pyjeve dhe gjelbërimi i zonave të degraduara | 79 |
| Menaxhimi i mbeturinave                                                                                              | 80 |
| X. PLANI I MONITORIMIT                                                                                               | 81 |
| XI. PËRFUNDIME                                                                                                       | 84 |
| XII. LITERATURA                                                                                                      | 85 |

#### **Lista e tabelave**

|                                                                                                 |    |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| Tabela 1 Hapat e hartimit të VSM dhe përshkrime të shkurtra të punës                            | 15 |
| Tabela 2 Temperatura mesatare vjetore - IHMK                                                    | 23 |
| Tabela 3 Temperatura maksimale absolute vjetore - IHMK                                          | 23 |
| Tabela 4 Drejtimidominant i erës – IHMK 2021                                                    | 24 |
| Tabela 5 Shpejtsia mesatare mesatare _m/s minimale dhe maksimale e erës sipas muajve ,IHMK      | 24 |
| Tabela 6 Shpejtsia mesatare e erës sipas muajve të vitit IHMK,2022                              | 24 |
| Tabela 7 Tabela e shkarkimeve për ujërat e zeza për zonat joshensive konform UA 13/2008         | 26 |
| Tabela 8 Gjatesia e rrugëve sipas kategorive                                                    | 28 |
| Tabela 9 Parametrat e cilësisë së ajrit në stacionin monitorues Prizren për periudhën 2021-2024 | 31 |
| Tabela 10 Komponentët mjedisorë të parapara në raportin e VSM                                   | 72 |
| Tabela 11 Analiza e shkallës së ndikimit në komponentët mjedisorë                               | 74 |
| Tabela 12 Analizë matricore e efekteve kumulative të elementeve të PZHK-së                      | 75 |
| Tabela 13 Plani i Monitorimit Mjedisor                                                          | 84 |

#### **Lista e hartave**

|                                                        |    |
|--------------------------------------------------------|----|
| Harta 1 Formacionet pedologjike                        | 17 |
| Harta 2 Karakteristikat gjeologjike                    | 20 |
| Harta 3 Hipsometria e terrenit dhe lartësitë mbidetare | 21 |

|                                                                                      |    |
|--------------------------------------------------------------------------------------|----|
| Harta 5 Infrastruktura rrugore                                                       | 29 |
| Harta 6 Infrastruktura e transportit                                                 | 30 |
| Harta 7 Koncepti kryesor për zhvillimin e ardhshëm hapësinor të komunës së Prizrenit | 55 |

## Lista e shkurtimeve

|          |                                                                  |
|----------|------------------------------------------------------------------|
| VSM –    | Vlerësimi Strategjik Mjedisor                                    |
| VNM –    | Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis                                   |
| BE –     | Bashkimi Evropian                                                |
| KB –     | Kombet e Bashkuara                                               |
| EC –     | European Commission                                              |
| MMPHI –  | Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës |
| MBPZHR – | Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural           |
| IHMK –   | Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës                           |
| AMMK –   | Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës                   |
| PZHK –   | Plani Zhvillimor Komunal                                         |
| KRM –    | Kompania Regjionale e Mbeturinave                                |
| KEDS –   | Kompania Kosovare për Distributim me Energji Elektrike           |
| KEK –    | Korporata Energjetike e Kosovës                                  |
| IPPC –   | International Plant Protection Convention                        |
| IKSHPK – | Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike                        |
| ITUN –   | Impianti i Trajtimit të Ujërave të Ndotura                       |
| QKMF –   | Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare                            |
| QMF –    | Qendër e Mjekësisë Familjare                                     |
| AMF –    | Ambulancë e Mjekësisë Familjare                                  |
| OM –     | Objektiva Mjedisore                                              |
| GIS –    | Geographic Information System                                    |
| SHBO5 –  | Shpenzimi Biokimik i Oksigjenit                                  |
| DSHPM –  | Drejtoria për Shërbime Publike dhe Mjedis                        |
| DBZHR –  | Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural                         |

DPU – Drejtoria për Planifikim Urban

DKRS – Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

DSHMS – Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

## I. HYRJE

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) për politika, plane dhe programe vlerëson pasojat qysh në fazat e hershme të vendimmarrjes. Gjithashtu VSM është një proces që synon integrimin e konsideratave mjedisore në përgatitjen dhe miratimin e planeve, programeve dhe politikave. Koncepti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor vjen nga politikat dhe programet e niveleve më të larta të planifikimit dhe shfrytëzimit të tokës të cilat kanë synime strategjike dhe vizionare dhe për të cilat kërkohet VSM sipas ligjit.

Qëllimi i raportit të VSM për Planin Zhvillimor Komunal të Komunës së Prizrenit është që të bëjë identifikimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të rëndësishme që mund të rezultojnë nga zbatimi i Planit Zhvillimor Komunal, si dhe të ofrojë alternativën më të favorshme për zhvillimin e tij nga pikëpamja mjedisore. Në raportin e VSM-së duhet të përfshihen edhe propozimi i masave për mënjanimin dhe zbutjen e ndikimeve të dëmshme që dalin nga propozimet e Planit Zhvillimor Komunal.

Metodologjia e ndjekur është në përputhje me Direktivën 2001/42/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, për vlerësimin e efekteve të planeve dhe programeve të caktuara në mjedis, dhe ligjin Nr. 03/L-230 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, i cili është transpozim i Direktivës 2001/42/EC të Bashkimit Evropian dhe përcakton kushtet, procedurat dhe mënyrën e vlerësimit strategjik të mjedisit për të siguruar mbrojtjen e tij dhe shëndetit të njeriut.

Vlerësimi i strukturuar mjedisor për Planin Zhvillimor Komunal të Prizrenit do të organizohet si vijon:

Përmbledhje të informacionit bazë për vlerësimin mjedisor; përshkrimin e vizionit, prioritetëve dhe objektivave kryesore të Planit Zhvillimor Komunal të Prizrenit dhe marrëdhëniet e tij me politikat, planet dhe programet e tjera që kanë lidhje me të;

Përshkrimin e aspekteve të gjendjes aktuale të mjedisit si dhe zhvillimet e pritura në rast të mos zbatimit të planit;

Përshkrimin e karakteristikave mjedisore të zonave që kanë të ngjarë të ndikohen në mënyrë të konsiderueshme nga plani;

Përshkrimin e problemeve ekzistuese mjedisore të cilat kanë lidhje me planin;

Përshkrimin e objektivave për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara në nivel kombëtar ose ndërkombëtar, të cilat kanë të bëjnë me planin dhe programin si dhe mënyrat në të cilat këto objektiva janë marrë parasysh gjatë përgatitjes së raportit;

Përshkrimin e ndikimeve të mundshme dhe të konsiderueshme në mjedis duke përfshirë shëndetin publik, florën, faunën, biodiversitetin, tokën, klimën, ajrin, ujin, peizazhin, zonat natyrore, vlerat materiale, trashëgiminë kulturore si dhe ndërveprimin ndërmjet këtyre faktorëve;

Efektet kumulative të komponentëve mjedisore;

Përshkrimin e masave që parashikohen për parandalimin, reduktimin dhe/ose lehtësimin e ndikimeve negative në mjedis, të cilat mund të rezultojnë nga zbatimi i planit;

Përmbledhje e alternativave të shqyrtuara, duke përfshirë vështirësitë e ndryshme ose mungesën e të dhënave që hasen gjatë përpilimit të raportit;

Përshkrimin e planit të monitorimit dhe raportimit.

Të dhënat dhe informacionet për komunën e Prizrenit janë siguruar nga Komuna dhe drejtoritë përkatëse, nga hulumtime të ndryshme të kryera për këtë komunë, nga Plani Zhvillimor Komunal i vjetër dhe hulumtime tjera nga interneti.

## II. KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE

### 1 Direktiva për Vlerësimin Strategjik Mjedisor e BE-së

*Direktiva 2001/42/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi vlerësimin e efekteve të planeve dhe programeve të caktuara në mjedis, u aprovua më 27 Qershor 2001. Kjo direktivë vlen për një varg të gjerë të planeve dhe programeve publike të cilat janë subjekt i përgatitjes dhe/ose miratimit nga një autoritet në nivelin kombëtar, rajonal ose lokal, ose që përgatiten nga një autoritet për miratim përmes procedurave legjislative dhe të cilat kërkohen nga dispozitat legjislative, rregullatore ose administrative.<sup>1</sup>*

Një Vlerësim Strategjik Mjedisor është i obligueshëm për planet/programet si vijon:

Përgatitjen e planeve për bujqësi, pylltari, peshkim, energjetikë, industri, transport, menaxhim të mbeturinave, menaxhimin e ujërave, telekomunikim, turizëm, planifikim të qytetit dhe vendit ose shfrytëzimit të tokës, dhe të cilat vendosin kornizën për miratimin e zhvillimit të ardhshëm të projekteve të shënuara në listën e Direktivës për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor (VNM);

Janë përcaktuar për të kërkuar një vlerësim sipas Direktivës së Vendbanimeve. Gjerësisht, për planet/programet që nuk janë të përfshira më lartë, shtetet anëtare duhet të kryejnë një procedurë të shoshitjes për ta përcaktuar nëse planet/programet kanë mundësi të kenë efekte domethënëse në mjedis. Nëse raste të tilla, nevojitet një VSM. Procedura e shoshitjes bazohet në kriteret e përcaktuara në Shtojcën II të Direktivës.

### **Procedura e VSM-së**

Raporti i VSM përgatitet dhe në të identifikohen efektet domethënëse të mundshme në mjedis dhe alternativa të arsyeshme të planit ose programit të propozuar. Autoritetet publike dhe mjedisore informohen dhe konsultohen lidhur me projektin e planit ose të programit dhe përgatitet raporti VSM. Raporti VSM dhe rezultatet e konsultimeve merren parasysh para aprovimit. Me aprovimin e planit apo programit, informohen autoritetet mjedisore dhe opinioni, si dhe informatat përkatëse vihen në dispozicion të tyre. Në mënyrë që të identifikohen efektet e pa parashikueshme jo të favorshme në fazat e hershme, efektet domethënëse mjedisore të planit ose të programit duhet të monitorohen.

### 2.2 Direktiva tjera të BE-së

Ekzistojnë shumë Direktiva tjera të BE-së me të cilat Direktiva VSM ka lidhje të qarta dhe të cilat janë të rëndësishme nëse janë duke u shqyrtuar çështjet mjedisore. Sipas Marsden (2008) VSM-ja ka lidhje të ngushta procedurale me Direktivën e VNM, në veçanti me që vlerësimi i mjedisit për sektorët e shënuar nën këtë të fundit duhet ta vendosë kornizën për projektet e shënuara nën këtë të parën. Po ashtu ka lidhje të ngushta procedurale me Direktivën për Vendbanimet, e cila përmendet qartë në direktivën e VSM. Direktiva Kornizë për Ujërat bashkërisht me Direktivën për Vendbanimet përmban kërkesat e veta jo vetëm për paraqitjen e planeve dhe programeve, por po ashtu edhe të vlerësimit, duke nxitur nevojën për procedura të bashkërenduara ndërmjet ligjeve të ndryshme.

### 2.3 Strategjia 2020 e BE-së

Përveç dokumenteve legjislative të BE-së të përmendura më sipër, strategjia 2020 e BE-së me prioritetet, objektivat dhe nismat më të mëdha, është dokument i rëndësishëm i politikave si për vetë BE-në ashtu edhe për rajonet fqinje, në veçanti Ballkanin Perëndimor, duke qenë se bashkëpunimi rajonal me këtë rajon është identifikuar si njëri prej prioritetëve të politikave për BE-në. Në kuadër të strategjisë 2020 të BE-së zgjerimi i mundshëm i BE-së me vendet e Ballkanit Perëndimor është identifikuar si mjet i jashtëm i politikave për zhvillim dhe vende pune. Prioritetet strategjike përfshijnë “zhvillimin e shpejtë, të qëndrueshëm, gjithëpërfshirës”. Janë shtatë nisma të mëdha si: “Evropa efikase sa ju përket burimeve” dhe “Një politikë industriale për epokën e globalizimit” të lidhura drejtpërdrejtë me çështjet e qëndrueshmërisë. Nisma të

---

<sup>1</sup> <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:32001L0042>

tjera si “Agjenda Digjitale për Evropën”, “Unioni i Përtëritjeve”, “Rinia në lëvizje”, “Një agjendë për shkathtësi dhe vende të reja pune” dhe “Platforma evropiane kundër varfërisë”, gjithashtu kanë një kontribut në parimin e zhvillimit të qëndrueshëm nëse do të zbatoheshin në mënyrë efikase.

Strategjia gjithashtu përfshin objektivat e matshme që duhet të arrihen gjatë periudhës së zbatimit, nuk ka dyshim që është plotësisht e dobishme si për shtetet anëtare aktuale ashtu edhe për ato të ardhmet që të bashkëpunojnë në mënyrë që t’i arrijnë objektivat mjedisore të strategjisë, siç janë:

zvogëlimi prej 20% i emetimeve të gazrave serrë;

20% rritje të shkallës së energjisë nga burime të ripërtëritshme efikase të energjisë.

Prandaj është e arsyeshme që drejtimi i këtyre objektivave të integrohet në strategjitë dhe planet e veprimit mjedisore kombëtare, rajonale dhe lokale, përfshirë procedurat për vlerësim strategjik mjedisor.

## **2.4 Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit të Kombeve të Bashkuara**

Kombet e Bashkuara kanë një rol aktiv në zhvillimin e Kosovës. Edhe pse jo shtet anëtar, KB veprojnë në Kosovë nën mandatin e Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), për të siguruar kushte për një jetë paqësore dhe normale për të gjithë banorët e Kosovës dhe avancimin e stabilitetit rajonal në Ballkanin Perëndimor. Objektivat strategjike të KB janë aprovuar në vitin 2000, kur udhëheqësit botërorë u mbledhën në New York për të marrë pjesë në Samitin e Mijëvjeçarit, ku pjesëmarrësit aprovuan Deklaratën e Mijëvjeçarit të KB (Asambleja e Përgjithshme e KB, 2000) me qëllimin kryesor të përgjithshëm për ta zvogëluar varfërinë me afatin e fundit kohor vitin 2015. Kjo nismë është bërë e njohur si Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit<sup>2</sup>. Nga shtatë (7) objektivat e kësaj nisme, një nga to i kushtohet qëndrueshmërisë mjedisore, në mënyrë që të sigurohet vendosja e qëllimeve në vijim:

Integrimi i parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në politikat dhe programe të vendit dhe kthimi mbrapsht i humbjes së burimeve mjedisore;

Zvogëlimi i humbjeve të biodiversitetit duke arritur deri më 2010 një zvogëlim domethënës të shkallës së humbjes;

Përgjysmimi i përqindjes së popullsisë pa qasje të qëndrueshme në ujë të pijshëm të sigurt dhe higjiena publike themelore deri në vitin 2015;

Deri më 2020 të arrihet një përmirësim i rëndësishëm në jetë e së paku 100 banorëve të lagjeve të varfra.

Edhe pse në këto 15 vitet e fundit është bërë progres i dukshëm në arritjen e OZHM-ve, shumë objektiva nuk u arritën. Për të përshpejtuar progresin dhe avancuar zhvillimin përtej vitit 2015, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, më 25 shtator 2015 miratoi agjendën e zhvillimit të pas-2015, duke vendosur objektivat dhe pikësynimet e reja për 15 vitet e ardhshme. Agjenda e re përcakton shtatëmbëdhjetë (17) Objektiva për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZHQ) ose Sustainable Development Goals (SDG), të cilat kanë si afat vitin 2030 dhe kërkojnë të ndërtojnë dhe plotësojnë atë që OZHM nuk e kanë arritur. Në këtë agjendë të re të zhvillimit, komponenta e mjedisit konsiderohet të ketë rol kyç në të gjitha dimensionet e zhvillimit të qëndrueshëm, për sa çështjet mjedisore kanë lidhje me disa probleme kryesore globale duke afektuar të gjitha aktivitetet njerëzore dhe cilësinë e jetës së njeriut. Kjo është arsyeja pse mjedisit i janë dhënë objektiva të posaçme (OZHQ nr. 11, 13 dhe 15) por edhe objektiva të tjera të cilat në thelb përmbajnë aspekte mjedisore. Këto objektiva janë të rëndësishme që të kenë një qasje gjithëpërfshirëse në trajtimin dhe adresimin e problemeve globale të mjedisit.

## **2.5 Konventat ndërkombëtare mjedisore**

---

<sup>2</sup>[http://ec.europa.eu/europe2020/index\\_en.htm](http://ec.europa.eu/europe2020/index_en.htm)

**Konventa e Aarhus-it** (25 Qershor 1998), sipas të cilës shteti duhet të garantojë të drejtën e publikut për të pasur informacion për mjedisin, të marrë pjesë në marrjen e vendimeve mjedisore dhe t'i drejtohet trupave gjyqes në lidhje me çështjet e mjedisit. Tri shtyllat kryesore të konventës:

E drejta e publikut për informacion

E drejta e publikut për pjesëmarrje

E drejta e publikut për drejtësi

**Konventa Espoo** përcakton obligimet e palëve për ta vlerësuar ndikimin në mjedis të aktiviteteve të caktuara në një fazë të hershme të planifikimit. Po ashtu i formulon obligimet e përgjithshme të shteteve për ta njoftuar njëra tjetrën dhe për t'u këshilluar me njëra tjetrën lidhur me të gjitha projektet e mëdha që janë në shqyrtim dhe që ka gjasa të kenë ndikim të rëndësishëm të pafavorshëm në mjedis përtej kufijve.

**Protokolli i Kievit** kërkon që vlerësimi strategjik i mjedisit të kryhet për planet dhe programet të cilat përgatiten për bujqësi, pylltari, peshkim, energjetikë, industri përfshirë minierat, transportin, zhvillimin rajonal, menaxhimin e mbeturinave, menaxhimin e ujërave, telekomunikimin, turizmin, planifikimin e qytetit ose të fshatit ose shfrytëzim të tokës, dhe të cilat vendosin kornizën për miratimin e zhvillimit të ardhshëm për projektet. Protokolli lejon identifikimin dhe parandalimin e ndikimeve të mundshme mjedisore që nga fillimi i procesit të vendimmarrjes duke zhvilluar politika të qëndrueshme të transportit se sa minimizimin e ndikimeve mjedisore në ndërtimin e rrugëve.

Protokolli i Kievit për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, kërkon nga palët e tij që të vlerësojnë pasojat e planeve dhe programeve të tyre zyrtare. Protokolli i Kievit ofron një pjesëmarrje të gjerë të publikut në vendimmarrjen e qeverisë në sektorët zhvillimorë. Protokolli i Kievit rëndësi të veçantë i kushton edhe shëndetit njerëzor.

## **2.6 Historiku legjislativ, organet administrative përgjegjëse**

### **2.6.1 Ligji i Kosovës për Vlerësimin Strategjik Mjedisor**

Ligji nr. 03/L-230 Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, ka për qëllim që përmes vlerësimit strategjik mjedisor të planeve dhe programeve, të sigurojë shkallë të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit të njeriut. Ligji nënvizon rëndësinë e integritet të parimeve për mbrojtjen e mjedisit në procedurën e përgatitjes, miratimit dhe realizimit të planeve dhe programeve përkatëse me ndikim domethënës në mjedis, me synim të promovimit të zhvillimit të qëndrueshëm. Ligji përcakton kriteret për përcaktimin e nevojës për VSM, të dhëna mbi përgatitjen e raportit, informacionet që duhet përfshirë, debati publik, etj. Planet dhe programet të cilat duhet t'i nënshtrohen procesit të VSM, nuk mund të aprovohen ose t'i dorëzohen organit legjislativ për aprovim pa raportin e VSM. Ligji është përafshuar me Direktivën 2001/42/EC, datë 27 Qershor 2001.<sup>3</sup> Përveç, Ligjit Nr. 03/L-230 të Kosovës për Vlerësimin Strategjik Mjedisor janë konsultuar edhe ligjet tjera relevante mjedisore dhe aktet nënligjore më të rëndësishme të aplikuara për hartimin e këtij raporti:

- Ligji nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit
- Ligji nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor
- Ligji nr.04/L-147 për Ujërat e Kosovës
- Ligji nr. 03/L-233 mbi Mbrojtjen e Natyrës
- Ligji nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore, shfuqizuar pjesërisht nga Ligji nr. 04/L-040 për Rregullimin e Tokës
- Ligji nr. 06/L-035 për Veprimtaritë Hidrometeorologjike

---

<sup>3</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2711>

- Ligji nr. 02/L-102 për Mbrojtjen nga Zhurma
- Ligji nr. 08/L-145 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes
- Ligji nr. 08/L-025 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja
- Ligji nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis
- Ligji nr. 04/L-060 për Mbeturina, ndryshuar/plotësuar nga Ligji nr. 08/L-071 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-060 për Mbeturina
- Ligji nr. 04/L-197 për Kimikate
- Ligji nr. 08/L-116 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-197 për Kimikate
- Ligji nr. 02/L-78 për Shëndetësi Publike
- Ligji nr.08/L-137 për Pyjet
- Ligji nr. 02/L-53 për Gjuetinë
- Ligji nr. 08/L-084 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 02/L-53 për Gjuetinë
- Ligji nr. 08/L-074 për Turizmin
- Ligji nr. 04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera
- Ligji nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet
- Ligji nr. 08/L-214 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-158
- Ligji 2003/11 për Rrugët
- Ligji nr. 03/L-040 për Vetqeverisje Lokale
- Ligji nr. 06/L-029 për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore
- Ligji nr. 03/L-039 për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, etj.

### **2.6.2 Ligji i Kosovës për Planifikim Hapësinor**

Ligji për Planifikimin Hapësinor është aprovuar në shtator 2003 dhe është ndryshuar në nëntor 2008 (Ndryshimi i Ligjit për Planifikim Hapësinor, Ligji Nr. 03/L-106), ndërsaq në Korrik të viti 2013 është aprovuar Ligji i ri i Planifikimit (Ligji Nr. 04/L-174) duke pasur si qëllim kryesor:

Rregullimin e të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me planifikimin hapësinor dhe urban;

Duhet t'i respektojë parimet e mbrojtjes së burimeve natyrore dhe ta përkrahë zhvillimin e qëndrueshëm;

Duhet t'i përkrahë proceset gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrëse dhe duhet t'i përfshijë të gjitha palët e interesuara dhe komunitetet;

Përkrahja e zhvillimeve hapësinore evropiane që janë duke ndodhur etj.

Sipas Ligji Nr. 04/L-174 në Kosovë ekzistojnë 2 nivele të planifikimit (qendror dhe lokal) dhe llojet e planeve janë Plani Hapësinor i Kosovës, Harta Zonale e Kosovës, Planet Hapësinore për Zona të Veçanta, Planet Zhvillimore Komunale (PZHK), Harta Zonale e Komunës dhe Planet Rregulluese Urbane të Hollësishme. Për të gjitha ato lloje të planeve është i obligueshëm rishikimi dhe mundësitë për pjesëmarrjen e palëve të interesuara. PZHK, si lloji më i rëndësishëm për detyrën aktuale është plani multi-sektorial për gjithë

territorin e komunës që i përcakton objektivat afatgjata për zhvillimin ekonomik, shoqëror dhe hapësinor. Ai përfshin periudhën minimale 8 vjeçare dhe planin për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale brenda komunës. Të gjitha nivelet e planeve duhet të përfshijnë zhvillimin e qëndrueshëm si dhe për secilin plan obligohet përgatitja e raportit të VSM paralelisht me planin.

Sipas Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) është përgjegjëse për bashkërendimin e planifikimit hapësinor në Kosovë dhe për propozimin për politikën e zhvillimit hapësinor në fushën e planifikimit hapësinor, si dhe për hartimin e dokumenteve dhe të raporteve përkatëse për planifikimin hapësinor, shqyrtimin dhe monitorimin e të gjitha dokumenteve planifikuese në mbarë territorin e Kosovës. Ndërsa autoritetet lokale janë përgjegjëse për zbatimin e zhvillimeve urbane të nivelit lokal të cilat duhet të jenë në harmoni me politikën dhe programet nacionale si dhe duke respektuar përgjegjësitë që dalin nga Ligji Nr. 04/L-174.

### **Planet dhe programet e tjera të rëndësishme**

Përveç legjislacionit, raporti i VSM-së duhet të marrë parasysh edhe Planin Hapësinor të Kosovës 2010-2020+, Strategjinë për Mjedisin dhe Planin e Veprimit në Mjedis, si dhe disa plane, programe dhe dokumente të ndryshme të politikave të përgatitura dhe të lëshuara rishtazi nga autoritetet nacionale dhe institucionet e tjera relevante për të vazhduar më tutje me zbatimin e objektivave strategjike dhe të kërkesave ligjore.

### **III. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E VSM**

Qëllimi i hartimit të VSM për Planin Zhvillimor Komunal të Prizrenit është që të bëjë identifikimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të rëndësishme që mund të rezultojnë nga zbatimi i planit, si edhe të japë alternativën më të favorshme për zhvillimin e tij nga pikëpamja mjedisore.

#### **Objektivat:**

Të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit  
Të konsiderojë efektet e planit mbi mjedisin;  
Të identifikojë alternativat më të përshtatshme për mjedisin;  
Të identifikojë dhe parandalojë efektet kumulative;  
Të rrisë performancën e VNM;  
Të identifikojë dhe orientojë procesin lidhur me efektet potenciale negative mbi mjedisin;  
Të ofrojë argumente për justifikimin e projekteve të propozuara;  
Të reduktojë kohën për grumbullimin e informative apo për studime paraprake;  
Të integrojë çështjet mjedisore në procesin e vendimmarrjes;  
Të promovojë mbrojtjen e mjedisit;  
Të kontribuojë për një vendimmarrje sa më të mirë;  
Të ndihmojë për një vendimmarrje transparente, përballë interesave të publikut dhe grupeve të interesit.

#### **3.1 Procesi dhe metodologjia e VSM**

Vlerësimi Strategjik Mjedisor është një proces i identifikimit paraprak dhe shqyrtimit të ndikimeve të mundshme negative në mjedis dhe shëndetin e njeriut, të shkaktuara nga zbatimi i planit, programit ose dokumenteve tjera strategjike. Në raportin e VSM përfshihen edhe masat e rekomanduara për mënjanimin dhe zbutjen e ndikimeve të dëmshme që dalin nga propozimet e planit. Për të siguruar efektivitetin e procesit të VSM, është thelbësore që dokumentet strategjike të marrin në konsideratë disa opsione alternative për arritjen e qëllimeve të identifikuar. Në këtë rast VSM lejon vendimmarrësit të marrin në konsideratë opsionin më miqësor ndaj mjedisit.

Fazat kryesore të procesit të VSM me bazë mbi praktikën ndërkombëtare:

## SCREENING

Plani/programi subjekt i VSM

## SCOPING

Çështjet që duhet të trajtohen në raportin e VSM

## DOKUMENTAT/RAPORTI

Përgatitja e raportit të VSM dhe Projekt Planit/Programit

## KONSULTIMI

Konsultimi me grupet e interesit dhe me publikun

## VENDIMMARRJA

Lëshimi i vendimit për planin/programin përfundimtar bazuar në inputet nga hapi i konsultimit

## MONITORIMI

Monitorimi i efekteve mjedisore të planit përfundimtar

| Nevojshmëria                                       | Përshkrimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
|----------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Përfshirja/qëllimi t të VSM-së                     | Identifikimi i çështjeve që do të përfshihen në studimin e VSM-së do të orientojë vlerësimin e gjendjes bazë të mjedisit, vlerësimin aktual të ndikimeve të pritshme dhe konsideratat për opsione të mundshme alternative. VSM merr në konsideratë përfshirjen e aspekteve më të gjera mjedisore apo sociale në zonë dhe konservimin e të gjitha asetëve më rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare.                                                                                                                                                                                                              |
| Analiza e gjendjes ekzistuese                      | Analiza e gjendjes ekzistuese përbën bazën për vlerësimin e ndikimeve dhe përpilimin e skemes së monitorimit. Për VSM-në është e rëndësishme të konsiderohen tendencat e mundshme të zhvillimit. Qëllimi i analizës së gjendjes ekzistuese është që të orientojë drejt një specifikimi me të mirë të çështjeve kyçe, dhe një identifikimi me të mirë të problemeve kryesore që lidhen me planet, programet apo projektet përkatëse.                                                                                                                                                                           |
| Analiza e ndikimeve dhe formulimi i masave zbutëse | VSM analizon efektet e konsiderueshme negative si dhe ato pozitive të planeve të propozuara. VSM mundëson identifikimin e efekteve mjedisore të planit, dhe si i tillë ai do të adresojë efektet e pritshme kumulative, të cilat mund të rezultojnë prej aktiviteteve ose planeve të tjera në afërsi të zonës. VSM do të analizojë specifikisht masat adekuate përmirësuese që do të rezultojnë nga plani. Duke konsideruar, bashkërisht, ndikimet dhe raportin benefit/cost të veprimit ose mos veprimit do të analizohen opsionet dhe përzgjidhet ai që rezulton më i miri në planin ekonomik dhe mjedisor. |
| Hartimi i raportit të VSM-së                       | Raporti i VSM përmbledh të gjitha gjetjet dhe konkluzionet e nxjerra gjatë gjithë procesit të VSM dhe shërben si bazë për konsultimet me autoritetet përkatëse dhe grupet tjera të interesit. Qëllimi i kësaj faze është përgatitja e një raporti i cili paraqet të gjithë informacionin dhe të dhënat e rëndësishme, konkluzionet dhe rekomandimet në mënyrë të qartë, dhe kështu do të mundësojë konsultime efektive me autoritetet përkatëse dhe grupet tjera të interesit.                                                                                                                                |

|            |                                                                                                                                                                                                                                                     |
|------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Adoptimi   | Jepet informacion mbi përputhshmërinë e objektivave mjedisore me elementët kyçe të planit, të identifikuar paraprakisht. Mos përputhshmëria e objektivave mjedisore me planin nevojitet të rishikohen dhe propozohen ndryshime të mundshme në plan. |
| Monitorimi | Monitorimi i efekteve të konsiderueshme mjedisore dhe realizimi i veprimeve të duhura korrigjuese/zbutëse për çdo efekt mjedisor të konsiderueshëm të paparashikuar në këtë studim.                                                                 |

*Tabela 1 Hapat e hartimit të VSM dhe përshkrime të shkurtra të punës*

#### IV. ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE

##### Pozita Gjeografike

Komuna e Prizrenit gjendet në pjesën jugperëndimore të Republikës së Kosovës dhe është njëra ndër komunat më të mëdha territorialisht dhe më të populluara. Ajo shtrihet në koordinatat gjeografike përafërsisht midis 42°10' – 42°30' gjerësi veriore dhe 20°30' – 20°50' gjatësi lindore. Komuna e Prizrenit me sipërfaqe prej 640 km katrorë (5.94% e territorit të Kosovës) gjendet në jugperëndim të Kosovës me 74 vendbanime dhe kufizohet me komunën e Gjakovës, Rahovecit, Suharekës, Shtërpces, Dragashit, Mamushës si dhe me shtetet fqinje Shqipërinë dhe Maqedoninë Veriore.

Territori i Prizrenit është i përbërë nga fusha pjellore e Rrafshit të Dukagjinit në pjesën veriperëndimore dhe masivet malore të Sharrit në juglindje. Kjo konfigurata gjeomorfologjike e bën atë një zonë me potencial të lartë për bujqësi, turizëm natyror dhe zhvillim të qëndrueshëm.

##### Veçoritë mjedisore

##### Pedologjia – përmbajtja e dherave

Në rajonin e Prizrenit pedologjia e territorit të komunës karakterizohet nga një diversitet i lartë i llojeve të dheut, i cili është rezultat i ndërveprimit të faktorëve natyrorë si klima, relievi, gjeologjia dhe aktivitetet antropogjene.

Në bazë të analizave të kryera, dheu në territorin e Prizrenit ndahet në disa kategori kryesore: dheu i aluvionit i përhapur përgjatë lumenjve si Lumbardhi i Prizrenit dhe Drini i Bardhë, ky dhe karakterizohet nga përmbajtje e lartë e materies organike dhe është shumë i përshtatshëm për bujqësi intensive. Kjo tokë renditet në klasën e II-të të bonitetit, dheu karbonik i gjetur në zonat malore, ky dhe ka përmbajtje të lartë të karbonateve dhe është më pak i përshtatshëm për bujqësi, por ka rëndësi për kullota dhe pylltari, dheu i eroduar, në disa zona të pjerrëta dhe është i ekspozuar ndaj erozionit duke kërkuar masa për mbrojtje dhe rehabilitim

Dheu në Komunën e Prizrenit ka një rëndësi të madhe për bujqësinë. Zonat me dhe të pasur janë të përshtatshme për kultivimin e kulturave të ndryshme bujqësore, pylltarinë ku dheu në zonat malore mbështet rritjen e pyjeve dhe biodiversitetin dhe zhvillimin urban ku njohja e karakteristikave të dheut është esenciale për planifikimin e infrastrukturës dhe ndërtimit.

**Tokat aluviale (fluvisol)** janë kryesisht të koncentruar në shtratin e Drinit të Bardhë dhe përfaqësohen nga materialet argjilore, rëra dhe zhavorri.

##### Klasa e tokës

Toka e përshtatshme për mbjelljen e perimeve: smonica e kaftë, aluvioni argjilor, aluvioni i shkrifët dhe aluvioni i kaftë

Toka e përshtatshme për mbjelljen e frutave dhe për vreshtat: tokë e shkrifët e livadheve, aluvion i shkrifët ranor, kompakt gëlqeror dhe aluvion argjilor


Toka e përshtatshme për mbjelljen e drithërave: smonica e kaftë, aluvioni argjilor, aluvioni i shkrifët dhe aluvioni i kaftë

Toka e përshtatshme për pyje: rërë e shkrifët e kaftë në të kuqe të zbehtë në sediment (fundërrinë) me ngjyrë të kuqe të zbehtë, kompakt gëlqeror

Toka e përshtatshme për barishte: rërë e shkrifët e kaftë në të kuqe të zbehtë në sediment (fundërrinë) me ngjyrë të kuqe të zbehtë, kompakt gëlqeror, livadh argjilor dhe toka e cekët e kaftë

Duke pasur parasysh këtë ndarje, regjioni i Prizrenit është i përshtatshëm për kultivimin e perimeve siç janë: domatet, speci, lakra, karrota, trangujt, spinaqi dhe kultivimi i perimeve në sera. Toka është po ashtu e përshtatshme për kultivimin e drithërave si luledielli, misri, elbi, tërshëra dhe thekra. Kushtet janë të volitshme për themelimin e parkut botanik dhe kopshtit zoologjik.

Cilësia e tokës në regjionin e Kabashit është e lartë dhe e përshtatshme për kultivimin e domateve, specit, patates, misrit, mollëve, dardhave, kumbullave etj, Anadrini, Vërrini dhe Hasi janë po ashtu të përshtatshëm për perime. Në regjionin e Kabashit mund të kultivohen edhe bimët mjekuese si kamomili, menta, lule elbasani etj. Regjioni i Anadrinisë është i përshtatshëm për kultivimin e rrushit. Lloji i tokës në Regjionin e Lumës e bën këtë regjion të përshtatshëm për kultivimin e drithërave dhe bimëve mjekuese si dhe të perimeve siç janë speci, domatja, kungulli, patatja, fasulja, bizelja, qepët etj. Në regjionin e Zhupës, posaçërisht në lartësinë mbi detare deri në 1000 m mund të kultivohen manaferrat, mjedrat dhe bimët mjekuese si menta, lule elbasani dhe kamomili.



Harta 1 Formacionet pedologjike

## Gjeologjia dhe tokat

Komuna e Prizrenit është mjaft interesante sa i përket gjeologjisë së saj, aspektit tektonik, petrologjisë dhe pasurive minerale. Janë bërë studime, dhe janë publikuar një numër i publikimeve që kanë të bëjnë me gjeologjinë, tektonikën, stratigrafinë, hidrogeologjinë, geomorfologjinë, burimeve të mineraleve etj. Aplikimi i teknologjive të reja në hulumtimin e këtyre pasurive është kusht imediat për vlerësimin e këtyre vlerave në funksion të zhvillimit ekonomik. Prizreni ka shkëmbinj të moshave dhe litologjisë së ndryshme.

Shkëmbinjtë më të vjetër datojnë nga Paleozoiku, Permiani, Triasiku i hershëm dhe i vonshëm, Jurasik, Kretaku, Neogjeni dhe Kuaternari.

### **Shkëmbinjtë e Paleozoikut**

Shkëmbinjtë e Paleozoikut formojnë majat e larta të maleve Kojusha e Madhe, Nikolla e Zezë, pjesët e basenit të Lumit të Brodit etj. Këta shkëmbinj janë formuar nga rreshpet kristalin, graniti, migmatitet e granitit etj.

*Rreshpet kristaline* – albit klorit sericit SAB – ndodhen në mes të Kojushës së Madhe dhe shpateve të Lumbardhit. Ato formohen nga albiti, sericiti, muskoviti, apatitet etj.

*Rreshpet klorite sericite* Scose – formohen nga shkëmbinjtë me përbërje të ndryshme. Në disa shkëmbij, dominon kloriti ndërsa në të tjerat dominon sericiti. Tekstura e këtyre shkëmbinjve është rreshpore me nivele të larta të kuarcit.

*Rreshpet epidot aktinolit* – janë shkëmbinjtë metamorfik të formuar pas metamorfozës së shkëmbinjve vullkanike bazalti dhe sfilite.

*Meta konglomeratet* ndodhen kryesisht në verilindje duke filluar nga Brodosana në drejtim të vendit Nikolla e Zezë.

*Gëlqeret e zeza kristaline* – janë gjetur në disa pjesë të Majës së Zezë, Kojushë, Kuqibabë etj. Tekstura e këtyre shkëmbinjve është e pllakëzuar me shtresat prej 1.5 m deri 20m.

*Flitet* – janë formuar nga sericiti, kuarci, koloriti, albiti dhe pigmentet organike. Mineralet sekondare janë magnetiti, rutili, zirkoni etj. Ngjyra e këtyre shkëmbinjve zakonisht është e zezë dhe në raste të rralla e përhimët.

*Metaranoret e kuarcit dhe kuarciti* – gjenden në formë të shtresave të holla dhe ngjyra e tyre është e përhimët.

*Shkëmbinjtë metagabro* – gjenden në veri dhe perëndim të vendit të quajtur Nikolla i Zi. Ato kanë teksturë rreshpore dhe janë të gjelbër. Janë të formuar nga plaglokliasi, augiti etj.

*Meta – diabazat* – kanë ngjyrë të gjelbër në të përhimët dhe kanë teksturë homogjene. Përbëhen nga plagioklasat, kloriti, epiroti, koesiti etj.

*Granitet gneis* – mund të gjenden në Malet e Sharrit dhe janë të formuar nga kuarciti, albiti, biotiti, muskoviti etj.

*Granitet* – janë shkëmbinjtë acidike magmatike që gjenden në kurorat e Kuqibabës dhe në Lumbardhë. Granitet janë shkëmbinj metamorfik dhe shumë rrallë kanë reliktet e strukturës preliminare.

*Shkëmbinjtë Permian – Triasik* – gjenden në afërsi të Lubiqevës, Jeshkovë dhe Reqan. Këta shkëmbinj formohen nga sedimentet e pelitit psamit pas një metamorfoze të dobët. Po ashtu përmbajnë konglomerate, kuarcit, shkëmbinjtë magmatike gabro, albit, kuarc – porfirin etj.

### **Shkëmbinjtë e Mezozoikut**

*Shkëmbinjtë e Triasikut* – sedimentet karbonike të triasikut të mesëm dhe të vonshëm formojnë masivet e Maleve të Koritnikut, Cvilenit dhe luginën e Lumbardhit. Shkëmbinjtë e Triasikut përfaqësohen nga gurët masive gëlqerore me shtresa të trasha, mermer dhe dolomit me ngjyrë të përhimtë me nuansa nga e kuqja. Këta shkëmbinj janë të rikristalizuar; struktura e tyre është ksenoblastike dhe janë të formuar kryesisht nga kalciti. Këta shkëmbinj janë të thyer nga lëvizjet tektonike.

*Shkëmbinjtë e Jurasikut* – rrethojnë brezin e përmendur të shkëmbinjve të Triasikut në jug të fshatit Nashec dhe pjesët tjera të regjionit. Përfaqësues i këtyre shkëmbinjve është melanzhi olistromik.

*Shkëmbinjtë e Kretakut* – përfaqësohen nga sedimentet senoniane, të pasuara nga Turoniane dhe më pak nga senomaniane.

*Senomanian* – sedimentet e senomanianit formojnë majat e larta të Pashtrikut. Shtresat primare formohen nga shtresat e holla të konglomerateve (për këtë arsye nuk duken në hartë) dhe konglomerateve gëlqerore. Fragmentet në konglomerate rrjedhin nga shkëmbinjtë e përzier dhe cementi është kryesisht karbonik.

Gëlqeret kryesisht përbëhen nga 60- 80% të  $\text{CaCo}_3$  ndërsa pjesa tjetër përbëhet nga komponenti argjilor i pelitit. Trashësia është 700m.

*Turonian* – sedimentet e Turonianit gjenden në pjerrinat e Pashtrikut dhe janë formuar gradualisht nga gëlqeret e senonianit. Trashësia e kësaj shtrese është 150 – 200 m

*Senonian* – sedimentet e senonianit gjenden në pjesët e pjerrëta të Pashtrikut dhe janë formuar gradualisht nga sedimentet e turonianit dhe janë shpërndarë në afërsi të fshatit Mazrek, Zym dhe Dedaj. Nivelet e larta të senonianit janë kryesisht të përbërë nga peliti dhe gëlqeret me globturkana. Këto sedimente formojnë hipuritet dhe janë të trasha 600m.


### **Shkëmbinjtë e Kenozoikut**

*Sedimentet e Pliocenit* – përfaqësohen nga sedimentet e pliocenit të mesëm dhe të vonshëm që formojnë regionin e ngushtë të fshatit Gjonaj. Rezervat kryesore të këtyre shkëmbinjve gjenden në pjesën e rrafshët të Prizrenit, në jug të luginës së Dukagjinit. Ato janë kryesisht të mbuluar me sedimentet e kuaternarit. Në afërsi të Krushës së madhe, Landovicës dhe Randobravës, këta shkëmbinj janë kryesisht të mbuluar dhe formohen nga rëra, argjila dhe zhavorri. Në bazë të studimeve, del se shtresat e thella të pliocenit dominohen nga argjila psamite dhe pelite deri në fund të kretakut të vonshëm ku janë gjetur shtresa të qymyrit. Sedimentet e Pliocenit në Prizren kanë ruajtur zgjatimin e tyre parësor, respektivisht kanë shtrirje horizontale dhe një trashësi prej afro 350 m. Në fshatin Gjonaj janë gjetur dy horizonte të qymyrit.

*Sedimentet e kuaternarit* – përfaqësohen nga sedimentet e liqeve dhe të terracave të lumenjve të Pleistocenit si dhe nga depozitat proluviale të terra rosa dhe aluvialet e Holocenit. *Sedimentet e liqeve* gjenden në jug të fshatit Nashec dhe luginën e Prizrenit. Janë të përfaqësuara nga argjilat ranore me ngjyrë të verdhë, rëra dhe zhavorri. Trashësia ndryshon prej 20 deri 50m. Sedimentet e terracave të lumenjve janë kryesisht përgjatë shtratit të lumit Drini i Bardhë dhe janë të trashë 20 m.

*Depozitimet Proluviale* – janë prezente në formë të zonave të vogla të parregullta dhe të izoluar sikur në rastin e fshatit Gjonaj. Janë të përfaqësuar nga pjesët e rrumbullakëta dhe gjysmë të rrumbullakëta të shkëmbinjve të ndryshëm. Terra Rosa është e zhvilluar në shkëmbinjtë e Kretakut në gropat e vogla të luginave karstike siç është rasti me fshatin Zym. Trashësia e tyre është 100 m.

*Sedimentet aluviale* – janë kryesisht të koncentruar në shtratin e Drinit të Bardhë dhe përfaqësohen nga materialet argjilore, rëra dhe zhavorri.



Harta 2 Formacionet gjeologjike

### Karakteristikat hidrografike

Komuna e Prizrenit është një prej komunave më të pasura me ujëra sipërfaqësorë dhe nëntokësorë. Të gjithë lumenjtë e kësaj komunë i takojnë pellgut të Detit Adriatik, përkatësisht pellgut të Drinit të Bardhë, i cili hyn në Prizren nga ana veriore dhe vazhdon rrugën e tij kah Shqipëria dhe Deti Adriatik. Lumi formon një liqe të vogël në mes të fshatit Dobrusht dhe fshatit Vermicë.

Hidrografinë e pjesës lindore të komunës e bën pellgu i Lumëbardhit të Prizrenit, lum i cili është i gjatë 35,5 km, buron nga Zhupa dhe vazhdon të rrjedhë nëpër grykën e Lumëbardhit të Prizrenit, pastaj nëpër qytetin e Prizrenit, derisa i shkarkon ujërat e tij në Drinin e Bardhë. Sipas gjatësisë, sipërfaqes së pellgut dhe prurjes, është dega kryesore e majtë e Drinit të Bardhë.


Prej sipërfaqes së përgjithshme të territorit të komunës, 647 km<sup>2</sup> i takojnë ujëmbledhësit të Lumëbardhit. Buron në malet e Sharrit, në lartësi 2360 m. Gjatë rrjedhjes së tij mbledh shumë degë të pasuara me ujë, ndërsa në jug të fshatit Kobë derdhet në Drinin e Bardhë. Sistemi i Lumëbardhit përfshin edhe këto degë: Lumi i Pllanjanës, Lumi i Drajçit, Lumi i Berishës, Lumi i Hoçës etj. Një lumë tjetër i rëndësishëm është Toplluha, me gjatësi 37 km, sipërfaqja e pellgut 503 km<sup>2</sup>, i cili hyn në Komunën e Prizrenit nga ana veriore prej Mamushës, kurse afër fshatit Krajë, i shkarkon ujërat në Drinin e Bardhë.

Një ndër lumenjtë kryesor që e karakterizon territorin e komunës së Prizrenit është Drini i Bardhë, Lumëbardhi i Prizrenit etj.

### Lartësia mbidetare

Topografia e Komunës së Prizrenit ka strukturë të valëzuar kështu që lartësia ka një shtrirje ndërmjet 300 m–2600 m. Ndërsa qendra e qytetit është e vendosur në hapësirë të rrafshët, topografia kodrinore vërehet në drejtim të anës perëndimore por në mënyrë më të qartë vërehet kah ana jugore. Vendndodhja

gjeografike e Prizrenit ofron kushte të përshtatshme për zhvillimin e bujqësisë, rritjen e kafshëve, industrinë e ushqimit dhe turizëm. Pjesët malore mbi 1500 m mbulojnë përafërsisht 15% të të gjithë kufijve komunal. Fusha e Prizrenit është një sipërfaqe e gjerë e rrafshët me një pjerrësi ndërmjet 0-5%. Ajo mbulon rreth 14000 ha që përbën përafërsisht 22% të hapësirës së Komunës së Prizrenit



Harta 3 Hipsometria e terrenit dhe lartësitë mbidetare

### Kushtet klimatike

Klima e Prizrenit është e ndryshueshme kontinentale me një ndikim të lehtë të klimës mesdhetare në pjesët më të ulëta të Rrafshit të Dukagjinit në jugperëndim, ndërsa në male dominon klima malore. Klima mesdhetare vjen nga deti Adriatik nëpërmjet luginës së Drinit të Bardhë. Ajo ndihmon në kultivimin e rrushit dhe frutave e perimeve tjera. Pozita gjeografike, largësia prej bregdetit (vetëm 105 km), lartësia mbidetare, ekspozicioni, ndikojnë drejtpërdrejtë në klimën e Komunës së Prizrenit. Elementet kryesore meteorologjike që mundësojnë njohjen më të mirë të klimës në Komunën e Prizrenit janë: diellzimi, temperatura, reshjet, lagështia e ajrit, erërat, të cilët janë trajtuar më poshtë. Temperatura mesatare vjetore, sipas të dhënave të IHMK, është 12.95 gradë celsius. Muajt më të nxehtë janë Korriku dhe Gushti, me temperaturë mesatare 23.8 dhe 23.3 gradë celsius, ndërsa më i ftohti është janari me 1.3 gradë celsius. Maksimumi absolut i temperaturës së ajrit është në Korrik 27.7 gradë celsius, ndërsa minimumi –5.4 gradë celsius.

|    | I   | II  | III | IV   | V    | VI   | VII  | VIII | IX   | X    | XI  | XII | Vjetore |
|----|-----|-----|-----|------|------|------|------|------|------|------|-----|-----|---------|
| tC | 1.3 | 5.2 | 5.3 | 11.1 | 17.9 | 22.4 | 23.8 | 23.3 | 17.5 | 12.9 | 8.9 | 5.5 | 12.95   |

Tabela 2 Temperatura maksimale vjetore, IHMK 2022

|  | I | II | III | IV | V | VI | VII | VIII | IX | X | XI | XII | Vjetore |
|--|---|----|-----|----|---|----|-----|------|----|---|----|-----|---------|
|--|---|----|-----|----|---|----|-----|------|----|---|----|-----|---------|

|    |      |      |      |      |      |      |      |      |      |      |      |      |       |
|----|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|-------|
| tC | 11.2 | 11.6 | 13.6 | 16.6 | 24.6 | 26.8 | 27.7 | 27.6 | 23.4 | 17.3 | 13.9 | 13.8 | 19.00 |
|----|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|-------|

Tabela 3 Temperatura minimale vjetore, IHMK 2022

|    | I    | II  | III  | IV  | V    | VI   | VII  | VIII | IX   | X   | XI  | XII  | Vjetore |
|----|------|-----|------|-----|------|------|------|------|------|-----|-----|------|---------|
| tC | -5.4 | 1.1 | -1.1 | 4.8 | 10.5 | 17.3 | 15.6 | 20.1 | 10.5 | 8.5 | 3.0 | -0.8 | 7.00    |

Tabela 4 Temperatura mesatare vjetore, IHMK 2022

**Të reshurat** – pas temperaturës janë elementi më i rëndësishëm i klimës. Reshjet atmosferike ndikojnë në kushtet hidrologjike, mbulesën bimore, pamjen e peizazhit, varësisht nga sasia, intensiteti, regjimi pluviometrik dhe tipi, kanë ndikim të rëndësishëm për mjedisin jetësor dhe për aktivitetet njerëzore. Në regjimin pluviometrik në Prizren, ndikim më të madh kanë aktivitetet ciklonike, gjë e cila manifestohet me depërtimin nga rajoni i Mesdheut. Mesatarja vjetore e reshjeve në Prizren është 693.3 mm. Në vlera mesatare, gjatë muajit Nëntor, Prizreni merr sasinë më të madhe të reshjeve me 106.9mm, kurse sasinë më të vogël e ka në Mars 12.0mm.

Reshje më shumë paraqiten në pjesën jugore dhe jugperëndimore të Komunës së Prizrenit, të cilat kanë vlerën deri në 1500 mm, përkatësisht në malin e Sharrit dhe Koritnik, kurse në pjesën e ulët fushore të gropës së Prizrenit paraqitet minimumi i reshjeve me rreth 700 mm. Pra, relievi ka ndikim direkt në sasinë e reshjeve dhe llojin e tyre, njëkohësisht kjo ndikon në formën e tyre, e cila në male bie më shumë në trajtën e reshjeve të borës.

Reshjet e borës, pas atyre të shiut, paraqesin formën kryesore për nga sasia e ujit, rëndësia agroklmatike, turistike etj. Ato kanë rëndësi dhe ndikim të madh në kushtet e regjimit hidrik të lumenjve, krijimin e rezervave të ujërave nëntokësore për bujqësi, e sidomos për aktivitetet rekreative dhe ato të turizmit dimëror. Në pjesët e larta të maleve të Sharrit, numri i ditëve me reshje të borës vlerësohet rreth 150 ditë, kurse në qendrën e skijimit në Brezovicë rreth 83 ditë. Trashësia maksimale e borës në Malet e Sharrit arrin deri 180 cm.<sup>4</sup>

Sasitë mesatare vjetore sillen rreth 693.3 mm në Prizren, sipas të dhënave të IHMK.

Tabela 3 Shuma mesatare vjetore dhe mujore e të reshurave mm, IHMK 2022

|                  | I    | II   | III  | IV   | V    | VI   | VII  | VIII | IX    | X    | XI    | XII  | Vjetore |
|------------------|------|------|------|------|------|------|------|------|-------|------|-------|------|---------|
| H <sub>mes</sub> | 38.5 | 29.0 | 12.0 | 80.9 | 37.3 | 62.7 | 75.7 | 37.8 | 103.0 | 26.8 | 106.9 | 82.7 | 693.3   |

**Era-** Pozita e Komunës së Prizrenit, me pjesën veriore të hapët të fushës dhe me barriera malore në jug, kushtëzojnë rastisjen e drejtimeve kryesore të erërave. Ndër erërat më të shpeshta në territorin e Prizrenit janë erërat nga drejtimi i verilindjes (NE) me rastisje prej 164%, nga jugperëndimi (SW) me 149% dhe veriu me 132%<sup>5</sup>.

#### Vlerësimi i Rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera për Komunën e Prizrenit

Ibid

Tabela 4 Drejtimi dominant i erës, IHMK 2021

| Drejtimi dominant/muaj | I  | II  | III | IV      | V   | VI  | VII     | VIII | IX  | X   | XI | XII |
|------------------------|----|-----|-----|---------|-----|-----|---------|------|-----|-----|----|-----|
|                        | SW | ENE | ENE | ENE, SW | WSW | ENE | ENE, SW | WSW  | ENE | ENE | N  | ENE |

<sup>4</sup> Vlerësimi i Rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera për Komunën e Prizrenit

Tabela 5 Shpejtësia mesatare (m/s) minimale dhe maksimale e erës sipas muajve, IHMK 2021

|      | I    | II   | III  | IV  | V    | VI  | VII | VIII | IX   | X   | XI  | XII  |
|------|------|------|------|-----|------|-----|-----|------|------|-----|-----|------|
| Mes. | 5.7  | 5.7  | 5.7  | 4.7 | 6.3  | 5.1 | 4.5 | 5.1  | 4.8  | 3.2 | 3.5 | 5.8  |
| Min. | 1.4  | 1.5  | 2.7  | 1.4 | 2.1  | 2.2 | 2.4 | 2.6  | 1.6  | 1.6 | 1.4 | 1.2  |
| Max. | 12.5 | 11.9 | 10.5 | 8.9 | 11.2 | 8.3 | 8.3 | 12.7 | 10.5 | 8.3 | 8.7 | 12.2 |

Tabela 6 Shpejtësia mesatare e erës sipas muajve dhe vitit IHMK 2022

## Biogeografia dhe biodiversiteti

### Biogeografia: Zona biogeografike e Komunës së Prizrenit

Komuna e Prizrenit i përket rajonit biogeografik të Alpeve Dinarike dhe Sharr-it, që përfshin një sërë zonash ekologjike të veçanta për nga relievi, klima dhe lartësia mbidetare. Kjo zonë është ndër më të pasurat në biodiversitet në Kosovë dhe në gjithë Gadishullin Ballkanik. Biogeografikisht, territori ndahet në tri njësi kryesore: zona alpine-subalpine e Sharrit (mbi 1,800 m): me livadhe alpine, kullota dhe shkëmbinj të zhveshur, zona pyjore montane (1,200–1,800 m): e përbërë nga pyje halore dhe gjetherënëse, zona e fushave dhe kodrinave të Prizrenit (400–900 m): tokë bujqësore dhe moçalore, e rëndësishme për zogjtë shtegtarë dhe amfibët, Biodiversiteti: speciet, habitatet dhe rëndësia ekologjike.

### Fauna

Territori i Prizrenit është i pasur edhe me një florë dhe faunë të larmishme dhe karakteristike për këtë region. Më poshtë është e paraqitur harta e bimëve shëruese dhe fauna karakteristike për territorin e Komunës së Prizrenit. Duke pasuar parasysh që një pjesë e mirë e territorit të Komunës së Prizrenit i takon masivit të Maleve të Sharrit, bota shtazore është mjaft e zhvilluar. Zona e Prizrenit, sidomos pjesa e Parkut Kombëtar “Sharri”, është habitat i rëndësishëm për shumë lloje faune. Fauna e gjitarëve të Sharrit është e përfaqësuar gati me të gjitha llojet të cilat jetojnë në Kosovë, si dhe ca lloje të cilat me ekologjinë e tyre janë të lidhura ekskluzivisht me biotopet e viseve të larta malore, ndërsa llojet tjera janë të përhapjes së gjerë. Fauna e Sharrit deri sot nuk është hulumtuar sa duhet, mirëpo në bazë të të dhënave të literaturës mund të konstatohet se fauna e Sharrit përbëhet prej: 7 lloje peshq, 9 lloje amfibe, 10 lloje reptilë, 154 lloje shpendë dhe 30 lloje gjitarë. Flora e Prizrenit është një nga zonat me më shumë bimësi endemike dhe relikte në Kosovë, me mbi 1,500 lloje bimë të identifikuara. Zonat e mbrojtura dhe vlerat natyrore, Parku Kombëtar “Sharri” shtrihet pjesërisht në territorin e Komunës së Prizrenit (në juglindje). Është themeluar me Ligjin nr. 04/L-087 dhe ka një sipërfaqe prej mbi 53.000 ha, nga të cilat një pjesë e madhe përfshin territorin e Prizrenit. Zona përfshin: habitate alpine, pyje të thella, lumenj të pastër dhe livadhe me rëndësi për shtegtimin dhe riprodhimin e shumë specieve.

### Infrastruktura teknike

Në përputhje me Ligjin për Planifikimin Hapësinor (nr. 04/L-174), Plani Zhvillimor Komunal (PZK) ka për detyrë të vlerësojë gjendjen ekzistuese të infrastrukturës teknike, si në nivel lokal ashtu edhe në nivel qendror. Kjo vlerësim përbën bazën për përcaktimin e prioritetëve zhvillimorë dhe ndërhyrjeve të nevojshme për përmirësimin e kushteve infrastrukturore në territorin e komunës.

Në këtë kuadër, më poshtë paraqitet një pasqyrë e detajuar e rrjeteve dhe shërbimeve teknike në Komunën e Prizrenit, duke përfshirë:

- **Shtirirjen gjeografike të rrjeteve ekzistuese,**
- **Kapacitetet aktuale të shërbimeve,** si dhe
- **Cilësinë dhe funksionalitetin e infrastrukturës për fushat si:**
  - Furnizimi me ujë të pijshëm,
  - Rrjeti i kanalizimit dhe trajtimi i ujërave të ndotura,
  - Sistemi i energjisë termike,
  - Rrjetet e ujitjes bujqësore,
  - Sistemet e drenazimit,

- Menaxhimi i mbeturinave, dhe
- Telekomunikacioni dhe rrjetet dixhitale.

Kjo analizë e thelluar synon të identifikojë mangësitë ekzistuese dhe potencialet zhvillimore në fushën e infrastrukturës teknike, duke u shërbyer si bazë për planifikimin e investimeve dhe përmirësimin e shërbimeve publike në përputhje me vizionin afatgjatë të zhvillimit të qëndrueshëm të Komunës së Prizrenit.

### Ujësjiellësi dhe furnizimi me ujë të pijshëm

Sistemi i furnizimit me ujë në Prizren menaxhohet nga Kompania Rajonale e Ujësjiellësit "Hidroregjioni Jugor", ofron shërbimet e saj në pjesën jugore të Kosovës duke përfshirë këto komuna:

Komuna e Prizrenit: Qyteti i Prizrenit dhe 35 fshatra (numri total i fshatrave: 72)

Komuna e Suharekës: Qyteti i Suharekës dhe 16 fshatra (numri total i fshatrave: 42)

Komuna e Dragashit: Qyteti i Dragashit dhe 3 fshatra (numri total i fshatrave: 38)

Komuna e Malishevës: Qyteti i Malishevës dhe 19 fshatra (numri total i fshatrave: 44)

Komuna e Mamushës.

Shërbimet e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të zeza për qytetarët e Komunës së Prizrenit ofrohen nga ofruesi publik rajonal KRU " Hidroregjioni Jugor " sh. a, e licencuar nga Autoriteti Rregullativ i Shërbimeve të Ujit. Zona e shërbimit që i kryen shërbimet e furnizimit me ujë të pijshëm KRU HRJ, përfshin 4 njësi operationale ne 5 komuna: Prizren, Suharekë, Dragash, Malishevë dhe Mamushë. Furnizimi me ujë bëhet prej burimeve vetanake. Në nivel të kompanisë furnizohen edhe 64 fshatra që janë të kyçur në rrjetin e kompanisë Regjionale Prizren, Suharekë, dhe Malishevë. Numri i popullatës që kompania e ujësjiellësit K.R.U. "Hidroregjioni Jugor" SH.A. i kryen shërbimet e veta vlerësohet të jetë rreth 200.000 banorë. Kapaciteti prodhues përfshin kapacitetet përmes puseve që janë alternativë, si dhe burimet që nuk janë të shfrytëzuara aktualisht me kapacitet të plotë. Furnizimi bëhet 45% me pompa dhe 55% me gravitet<sup>1</sup>.

Sa i përket rrjetit të kanalizimit në Prizren, materiali i tubave prej betoni përbën 44% të rrjetit, duke dominuar si materiali kryesor. Ky material ndiqet nga tubat prej PVC, të cilët janë gjithashtu të përhapur, ndërsa tubat prej HDPE, të cilët aktualisht konsiderohen më të avancuar dhe me përdorim më të gjerë në sisteme moderne të kanalizimit, përbëjnë 35% të rrjetit të kanalizimit brenda zonës së shërbimit të Prizrenit. Megjithatë betoni ka qenë tradicionalisht një zgjedhje e qëndrueshme, ai paraqet sfida të mirëmbajtjes dhe jetëgjatësisë, duke e bërë zëvendësimin dhe modernizimin e rrjetit me materiale më të avancuara si HDPE një prioritet për përmirësimin e sistemit të kanalizimit në këtë zonë. Kjo do të ndihmonte në reduktimin e rrjedhjeve dhe bllokimeve, duke rritur efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e përgjithshme të rrjetit. Edhe sa i përket rrjetit të kanalizimit, materiali i gypave nga betoni dominon me 44%, duke u pasuar nga materiali PVC, ndërsa materiali HDPE, i cili aktualisht ka përdorim më të gjerë, përbën 35% të sistemit të rrjetit të kanalizimit brenda zonës së shërbimit të Prizrenit.

Komuna e Prizrenit ka disa vite që ka në përdorim Impiantin e Trajtimit të Ujërave të Ndotura (ITUN), i cili bënë trajtimin e ujërave të ndotura për qytetin e Prizrenit. Kapaciteti i ITUN për fazën e parë është 50.000 pe. Situacioni përfshin hapësirën rreth 12 ha ku brenda kësaj hapësire janë te vendosura te gjitha predispozitat për Fazën II që të operojë me kapacitet prej 140.000 pe.

*Tabela 7 Parametrat e shkarkimeve për ujëra të zeza për zonat josensitive konform UA 13/2008*

| Parametrat                             | Njësia | Në hyrje | Në dalje |
|----------------------------------------|--------|----------|----------|
| Kapaciteti nominal                     | p.e.   | 50,000   | 50,000   |
| Prurjet max. të ujërave për trajtim    | m3/d   | 38,000   | -        |
| Shpenzimi Biologjik i Oksigjenit- BOD5 | mg/1   | 195      | 25       |
| Shpenzimi Kimik i Oksigjenit- COD      | mg/1   | 391      | 125      |

|                                |        |     |       |
|--------------------------------|--------|-----|-------|
| Largimi Total i së ngurtës-TSS | mg/1   | 234 | 35    |
| Azoti Total - N                | mg/1   | 35  | -     |
| Fosfori - P                    | mg/1   | 7.8 | -     |
| Sasia e llumit të mbetur       | Kg/d/b | -   | 0.142 |

Rrjeti elektrik menaxhohet nga KEDS dhe KOSTT, përfshirë nënstacionin kryesor 110/35/10 kV Prizreni 2. Zonat urbane janë të mbuluara mirë, por linjat e tensionit të ulët në fshatra janë shpesh të amortizuara.

Konsumi energjetik rritet në dimër për shkak të ngrohjes me energji elektrike. Potenciali për energji të ripërtëritshme: Instalimi i paneleve solare në ndërtesa publike dhe potencial për energji hidro në lumin Drin.

Aktualisht shërbimi i menaxhimit, grumbullimit dhe transportit të mbeturinave në Komunën e Prizrenit ofrohet nga Kompania Regjionale e Mbeturinave “Ekoregjioni”. KRM “Ekoregjioni” Sh.A. Prizren, është kompani e pajisur me leje Mjedisore përkatëse nga MMPHI për mbledhjen, grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave në rajonin e Prizrenit, Dragashit, Suharekës, Rahovecit dhe Malishevës. Veprimtari dytësore e kompanisë përveç shërbimit të mbeturinave është edhe mirëmbajtja e rrugëve (pastrimi, larja dhe fshirja), mirëmbajtja e oazave të gjelbërta, mirëmbajtja e lokacioneve publike etj. Kompania shërben tri kategori të konsumatorëve, respektivisht konsumatorët e ekonomive familjare, bizneset dhe konsumatorët publik.

Të dhënat nga operatori tregojnë se rrjeti i shërbimit është i shtrirë në rreth 90% të territorit të komunës. Shërbimi i grumbullimit të mbeturinave ofrohet në zonën urbane, peri-urbane dhe atë rurale. Klientët e amvisërisë ndahen sipas mënyrës se si e pranojnë shërbimin, pjesa më e madhe e pranojnë shërbimin derë më derë (grumbullimi kryhet çdo ditë të javës) dhe klientë të pajisur me kontejnerë (grumbullimi kryhet 1 herë në javë). Në zonat peri-urbane dhe rurale, klientët e amvisërisë e pranojnë shërbimin derë më derë, me frekuencë grumbullimi po ashtu 1 herë në javë.

Të dhënat nga Raporti i Menaxhimit të Mbeturinave Komunale në Kosovë, viti raportues 2021, tregojnë se rrjeti i shërbimit ka arritur shkallën e mbulimit të shërbimit të mbledhjes dhe transportit të mbeturinave prej 100%, ku të gjitha ekonomitë familjare në këtë komunë mbulohen me shërbim. Aktualisht, komuna përbëhet nga 76 vendbanime, nga të cilat 72 janë të mbuluara plotësisht nga shërbimet e grumbullimit dhe transportit të mbeturinave. Ky mbulim i gjerë siguron që afërsisht 95% e territorit të përfitojë nga shërbimet e rregullta të menaxhimit të mbeturinave. Duke iu referuar censusit të vitit 2011, vendbanimet të cilat nuk pranojnë shërbimin aktualisht (Dojnicë, Kobajë, Kushtendil dhe Vërbiçan) janë të pabanueshme.

### Infrastruktura e transportit dhe transporti

Nëpër territorin e Komunës së Prizrenit, kalojnë rrugë me karakter të ndryshëm si: autoudhë, rrugët nacionale, rrugët rajonale dhe rrugët lokale. Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës është përgjegjëse për menaxhim, mirëmbajtje dhe ndërtim të autoudhëve, rrugëve nacionale dhe rajonale, ndërsa Komuna është përgjegjëse për rrugët lokale dhe ato në vendbanim.

| Kategoria                   | Gjatësia   |
|-----------------------------|------------|
| Autoudhe #                  | 54,861.86  |
| Rruge nacionale/ rajonale # | 121,451.50 |
| Rruge lokale #              | 832,302.49 |
| Rruge urbane- primare #     | 219.72     |
| Rruge e vendbanimit #       | 1,009.73   |

*Tabela 8 Gjatësia e rrugëve sipas kategorive*

**Autoudha**-Nëpër territorin e komunës së Prizrenit kalon një pjesë e autoudhës “Ibrahim Rugova” apo “Ruga e Kombit” që lidh Republikën e Kosovës me Republikën e Shqipërisë, ndërsa Kosovës i krijon mundësi për


dalje në det. Shtrirja e autoudhës nëpër territorin e komunës së Prizrenit përfshinë rreth 17.5 km dhe përgjatë territorit të komunës janë dy kycje në autoudhë.

**Rruga nacionale N25** që vjen nga Nishi deri në kufirin veri lindor me Serbinë, kalon nëpër Prishtinë dhe Prizren dhe mbaron në kufi me Shqipërinë. Rruga nacionale N-25 Prishtinë-Prizren paraqet arterien kryesore të qarkullimit rrugor që kalon nëpër territorin e komunës së Prizrenit. Kjo rrugë nacionale mundëson lidhje me pjesët qendrore dhe perëndimore të Kosovës, duke e përfshirë edhe kryeqytetin, ndërsa përmes degëzimeve mundëson lidhjen me shtetet fqinje, Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut.


**Rrugët lokale** -Rrjeti i rrugëve lokale, sipas Ligjit mbi rrugët, janë rrugët që lidhin vendbanimet e një komune, ku kompetencë mbi kategorizimin dhe ndryshimin e tyre i takon qeverisë lokale. Nisur nga kjo si dhe koncepti i organizimit të rrjetit të rrugëve në nivel të komunës

**Hekurudha Prizren** - Klinë është një linjë hekurudhore e cila ndodhet në pjesën jugperëndimore të Kosovës. Është e gjatë 58.43 km dhe në veri (afër qytetit të Klinës) lidhet me linjën Fushë Kosovë – Pejë. Linja hekurudhore Veri-Jug, e cila kalon përgjatë Kosovës nga kufiri me Serbinë deri në kufirin me Maqedoninë e Veriut prej një gjatësie në total prej 148 km është linjë e vetme hekurudhore operationale për bartjen e mallrave dhe shërbime të pasagjerëve. Linja hekurudhore Verilindje-Perëndim përbëhet nga tri degë, ku linja hekurudhore nga Klina në Prizren themelon degën Jug- Perëndim dhe ka një gjatësi prej 58 km. Hekurudha fillon nga Prizreni dhe shkon në drejtim të Gjakovës. Ajo lidhë hekurudhën Pejë – Prishtinë në komunën e Klinës.

**Transporti publik** i udhëtarëve në komunën e Prizrenit është i organizuar si një kombinim i transportit urban, urbano-periferik dhe me shërbimet Taksi, të cilat plotësojnë njëra-tjetrën. Përveç transportit publik, qyteti i Prizrenit përbëhet gjithashtu nga një rrjet i linjave të transportit publik ndërrurban dhe ndërkombëtar me autobus të cilat përdorin korridoret themelore të transportit publik urban.



*Harta 5 Infrastruktura rrugore*



### Faktorët mjedisor dhe nivelet e ndotjes

Në Komunën e Prizrenit, cikli i planifikimit dhe menaxhimit mjedisor gjatë vitit 2023 ka pasur sfida të dukshme në qasjen e strukturuar dhe të organizuar. Hartimi i politikave mjedisore kërkon një dinamizëm më të lartë për të përmbushur nevojat aktuale, duke qenë se Plani Lokal i Veprimit në Mjedis ka skaduar që nga viti 2018 dhe nuk është hartuar një plan i ri.

Sektori i Mjedisit dhe Menaxhimit të Mbeturinave (SMMM) që funksionon në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, ka realizuar disa aktivitete gjatë vitit 2023, përfshirë vetëdijesimin, eliminimin e hotspotëve, minimizimin e mbeturinave dhe edukimin në shkollë. Megjithatë, raportet e zbatimit dhe rezultatet e arritura për këto programe nuk janë prezantuar. Projekte të tjera të realizuara përfshijnë menaxhimin e mbeturinave, mirëmbajtjen e rrugëve, shesheve dhe hapësirave të gjelbra, si dhe shtratit të Lumbardhit, por niveli i përgjithshëm i menaxhimit mjedisor ka mangësi të dukshme.<sup>6</sup>

Drejtoria e Inspektorateve ka adresuar disa çrregullime mjedisore, duke marrë masa ndëshkuese në raste të caktuara, përfshirë ndalimin e veprimtarive të gurore dhe konfiskimin e rërës së nxjerrë nga Drini i Bardhë. Komuna e Prizrenit është një ndër komunat me numrin më të madh të separacioneve. Në këto komuna, ekzistojnë një numër i madh i operatorëve, të cilët operojnë apo janë në pritje të marrjes së Lejes Mjedisore.<sup>7</sup> Aktivitetet e nxjerrjes së zhavorrit dhe gurëthyesve, kryesisht ndodhen në regjionin e Hasit dhe regjionin e Anadritisë përgjatë aksit rrugor Prizren - Gjakovë. Aktivitetet, e lidhura me nxjerrjen e zhavorrit janë titulluar si bazë asfalti, depo, separimi i gurëve, rërës etj. Për sa i përket krijimit, grumbullimit dhe menaxhimit të të dhënave mjedisore, në Komunën e Prizrenit nuk ekzistojnë sisteme monitorimi (përveç monitorimit të cilësisë së ajrit nga niveli qendror) për cilësinë e tokave, ujërave apo nivelet e zhurmës. Ndërsa parashikimi dhe paralajmërimi i vërshimeve dhe thatësirave bëhet nga niveli qendror. Komuna e Prizrenit përballlet me sfida të konsiderueshme sa i përket menaxhimit mjedisor dhe kërkon përpjekje më të strukturuar dhe të qëndrueshme për të përmirësuar gjendjen e mjedisit.

### Ndotja e ajrit

Komuna e Prizrenit është pjesë e ZKS1 në rrjetin shtetëror të monitorimit të cilësisë së ajrit, nga të cilat të dhëna, do të bëhet vlerësimi i ndotjes brenda territorit të komunës. Monitorimi i cilësisë së ajrit bëhet për grimcat e pluhurit (PM10 dhe PM2.5) si dhe katër lloje të gazrave (NO<sub>2</sub>, SO<sub>2</sub>, O<sub>3</sub> dhe CO).

Normat e cilësisë së ajrit të zbatueshme për monitorimin e cilësisë së ajrit në Kosovë, janë të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ Nr.02/2011 për normat e cilësisë së ajrit, të cilat janë prezantuar më poshtë. Sistemi online ofron mundësinë që qytetarët të jenë të informuar për gjendjen reale dhe parashikimin e cilësisë së ajrit në territorin e Republikës së Kosovës.

Në kuadër të të dhënave nga sistemi i monitorimit, janë marrë për analizë parametrat në dispozicion (PM10, PM2.5, NO<sub>2</sub>, SO<sub>2</sub>, CO, O<sub>3</sub>), nga stacioni i monitorimit Prizren - lloji i zonës urbane/rezidenciale. Pragjet alarmuese për dyoksidin e squfurit dhe dyoksidin e azotit, si dhe informacioni dhe alarmi për ozonin dhe PM10, sipas UA 02/2011 "Për normat e cilësisë së ajrit" dhe Ligji Nr. 08/L-025 Për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja.

Tabela 9 Parametrat e cilësisë së ajrit në stacionin monitorues Prizren për periudhën 2021 – 2024

| Substancat ndotëse, Lokacioni matës (µg/m3) | Viti |      |      |      |
|---------------------------------------------|------|------|------|------|
|                                             | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 |

<sup>6</sup> Raport Monitorimi i Sektorit të Mjedisit në Nivel Komunal, 2023. EC Ma Ndryshe

<sup>7</sup> Raport Vjetor për Gjendjen e Mjedisit 2021

|                       |      |      |      |      |
|-----------------------|------|------|------|------|
| <b>PM10, Prizren</b>  | 22.6 | 19.6 | 16.4 | 13.1 |
| <b>PM2.5, Prizren</b> | 16.1 | 14.1 | 11.3 | 9.1  |
| <b>NO2, Prizren</b>   | 19.1 | 17.1 | 15.1 | 17.5 |
| <b>SO2, Prizren</b>   | 6.6  | 9.6  | 5.2  | 7    |
| <b>O3, Prizren</b>    | 60.3 | 59.2 | 56.1 | 54.5 |
| <b>CO, Prizren</b>    | 0.5  | 0.6  | 0.6  | 0.7  |

Të dhënat tregojnë një rënie të vazhdueshme të koncentrimëve të PM10 dhe PM2.5 gjatë periudhës 2021-2024. Të dyja këto parametra mbeten nën vlerat limite vjetore për mbrojtjen e shëndetit (PM10: 40µg/m<sup>3</sup> dhe PM2.5: 25µg/m<sup>3</sup>).

Vlerat e NO2 për periudhën 2021-2024 vlerat limite vjetore për mbrojtjen e shëndetit (40µg/m<sup>3</sup>) dhe për mbrojtjen e vegjetacionit (30µg/m<sup>3</sup>).

Vlerat e SO2, O3 dhe CO janë gjithashtu shumë më të ulëta se vlerat limite për mbrojtjen e shëndetit, duke treguar një situatë të mirë në lidhje me këtë ndotës.

#### ***Ndotja e ujit***

Territori i Komunës së Prizrenit është pjesë e pellgut ujqor të lumit Drini i Bardhë dhe pellgut ujqor të lumit Vardar, përkatësisht Detit Adriatik dhe Detit Egje. Lumi më i gjatë dhe më i rëndësishëm në Prizren është Drini i Bardhë (111 km), i cili hyn në Prizren nga ana veriore dhe vazhdon në drejtim të Shqipërisë dhe Detit Adriatik. Lumi formon një liqe të vogël në mes të fshatit Dobrusht dhe fshatit Vërmicë. Dy lumenjtë tjerë kryesorë janë Lumbardhi (35 km) i cili rrjedh përgjatë luginës së Zhupës dhe vazhdon në qendrën e qytetit të Prizrenit dhe lumi Toplluha (37 km), i cili hyn në komunë nga pjesa veriore (prej Mamushës) dhe derdhet në Drinin e Bardhë, në fshatin Krajk.<sup>8</sup>

Sa i përket ndotjes, Plani Zhvillimor Komunal në fuqi, thekson hedhjen e mbeturinave dhe shkarkimin e ujërave të zeza në lumenj si shkaktarë kryesorë të ndotjes së ujërave në komunë. Në bazë të Planit Hapësinor të Kosovës 2010-2020+, Drini i Bardhë në komunën e Prizrenit radhitet në vendin e tretë për kah prioriteti për uljen e ndotjes së ujit.

#### ***Ndotja e tokës***

Burime pikësore dhe difuze të ndotjes së tokës përgjithësisht janë si rezultat i praktikave bujqësore të pakontrolluara, ndërtimit të paplanifikuar të vendbanimeve, industrisë (mbeturinat e ngurta, gërmimet), ndërtimit të infrastrukturës rrugore, mbeturinave shtëpiake dhe atyre ilegale, deponive, erozionit dhe nxjerrjes së pakontrolluar të zhavorrit.

Instituti Bujqësor i Kosovës dhe Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës janë institucionet përgjegjëse për monitorimin dhe vlerësimin e treguesve të cilësisë së tokës. Aktualisht, ligji i detyron operatorët ekonomik me potencial ndotës të mjedisit të bëjnë vetë-monitorimin e rregullt të cilësisë së tokës (dheut), por edhe AMMK bën monitorimet periodike, sipas legjislacionit në fuqi.

Monitorimi i tokave sa i përket aspektit bujqësor, është përgjegjësi e Institutit Bujqësor të Kosovës (IBK), i cili mes tjerash ka përgjegjësi për: mbështetjen teknike dhe shkencore për departamentet teknike të MBPZHR-së, kontrollin e cilësisë së inputeve bujqësore, ushqimit dhe ruajtjes së ambientit jetësor, realizimin e hulumtimeve të varieteteve të kulturave bujqësore (grurit, elbit, misrit dhe patates) në kushtet agroekologjike të Kosovës, vlerësimin e cilësive prodhuese dhe bonitetit të tokave, hulumtimin,

<sup>8</sup> Plani Zhvillimor i Komunës së Prizrenit 2013-2025

identifikimin dhe inventarizimin e agjentëve të dëmshëm biologjik (dëmtuesve, patogjenëve, barojave të këqija) etj.

Deri më tani nuk kemi hasur në testime apo të dhëna që lejojnë përcaktimin e shkallës së ndotjes, qoftë nga ndotës prioritarë (As, B, Cd, Cr, Cu, Pb, etj.), qoftë pesticidet apo metalet apo komponentë të hidrokarbureve të mbetura nga aktivitete të mëhershme, industritë që kanë pushuar së funksionuari, trajtime të drurit, apo nga përdorimi historik i tokës, etj. E vetmja e dhënë është sipërfaqja e tokës bujqësore të ndotur (ha) në Kosovë, ku Prizreni vlerësohet me 5 ha sipërfaqe toke të ndotur.<sup>9</sup> Studimi është kryer për 17 komuna të Kosovës, ku janë marrë mostra për studimin e ndotjes së tokës bujqësore dhe vlerësimin e përmbajtjes së përgjithshme dhe të pranishme të metaleve të rënda dhe elementet me potencial toksik, por duke mos u kufizuar në Fe, Al, As, B, Cd, Co, Cr, Cu, Hg, Mn, Mo, Ni, Pb, Se, Sr, Zn, herbicidet triazine.

### **Ndotja akustike**

Sipas vlerësimeve të Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës (IHMK) dhe vëzhgimeve komunale, ndotja akustike në Prizren shkaktohet kryesisht nga trafiku rrugor:

Rruga nacionale dhe autoudha R7 (segmenti Vërmicë–Prizren) janë burimet më intensive të zhurmës.

Ndërtimet dhe aktivitetet urbane, veçanërisht në zonën e qendrës dhe lagjet e dendura urbane, objektet rekreative dhe muzikore (klube, dasma), sidomos gjatë sezonit veror. Zonat e ekspozuara janë kryesisht qendra e qytetit (Shadërvani, Bazhdarhane, Ortakoll) ku zhurma shpesh tejkalon 60 dB dhe rruga tranzite drejt Vërmicës dhe N2 drejt Gjakovës/Suharekës.

### **Sipërfaqet me rrezikshmëri**

Duke marrë për bazë kushtet fiziko-gjeologjike, përbërjen litologjike të kores së tokës, kushtet klimatologjike dhe faktorët e tjerë, të cilët kanë ndikim në krijimin e shembjeve dhe të erozionit të tokës, është vlerësuar se një dukuri e tillë nuk është e theksuar në permasa të mëdha në komunën e Prizrenit. Megjithatë, viteve të fundit, ka ndodh të ketë fenomeneve të tilla për shkak të ndryshimeve klimatike dhe ndryshimeve në përdorimin e tokës. Deri më tani, erozioni është i pranishëm në nivele të ndryshme, nga erozioni i dobët deri te erozioni i fortë, duke prekur zonat malore dhe ato me pjerrësi të lartë.

Territori i Prizrenit ndahet në disa kategori bazuar në intensitetin e erozionit:

Zonat me erozion shumë të dobët: përbëjnë rreth 15% të territorit dhe përfshijnë kryesisht pjesët rrafshinore të komunës, si Prizreni, Pirana, Zojza dhe Petrova. Këto zona janë më pak të prekura nga erozioni për shkak të pjerrësisë së ulët dhe kushteve më të qëndrueshme gjeomorfologjike.

Zonat me erozion të dobët: zënë rreth 21% të territorit dhe shtrihen në pjesën qendrore të komunës, përfshirë vendbanime si Atmaxhë, Tupec, Vlashnje, Nebregoshtë, Lubinjë e Poshtme, Mushnikovë, Gornjasellë, Pllanjan. Këto zona janë të prekura nga erozioni në masë më të madhe sesa zonat rrafshinore, por ndikimi i erozionit është ende i menaxhueshëm.

Zonat me erozion të mesëm: përbëjnë rreth 36% të territorit dhe përfshijnë vendbanime si Randobravë, Zym, Dedaj, Kushnin, Kabash i Hasit, Mazrek, Kojushë, Planejë, Murademë, Milaj, Poslisht, Billushë, Hoçë e Qytetit, Manastiricë, Streckë, Kabash, Korishë, Skorobisht, Novosellë, Lubizhdë, Verbiçan etj. Këto zona janë të prekura nga një intensitet më i lartë erozionit që shfaqet si rezultat i kombinimit të faktorëve natyrorë dhe antropogjen.

Zonat me erozion të fortë: zënë rreth 11% të territorit dhe përfshijnë vendbanime si Shkozë, Zhur, Vërmicë, Zhivinjan, Reçan dhe Struzhë. Këto janë zonat më të prekura nga erozioni dhe janë më të rrezikuara për shkak të pjerrësisë së lartë dhe degradimit të vegjetacionit.

---

<sup>9</sup> Studimi mbi Ndotjen e Tokës Bujqësore (SNTB) në Kosovë, 2015

## **Menaxhimi i mbeturinave**

Shërbimi i menaxhimit, grumbullimit dhe transportit të mbeturinave në Komunën e Prizrenit ofrohet nga Kompania Regjionale e Mbeturinave “Ekoregjioni”. KRM “Ekoregjioni” Sh.A. Prizren, e cila kompani është e pajisur me leje Mjedisore përkatëse nga MMPHI për mbledhjen, grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave në rajonin e Prizrenit, Dragashit, Suharekës, Rahovecit dhe Malishevës. Veprimtari dytësore e kompanisë përveç shërbimit të mbeturinave është edhe mirëmbajtja e rrugëve (pastrimi, larja dhe fshirja), mirëmbajtja e oazave të gjelbërta etj. Kompania shërben tri kategori të konsumatorëve, respektivisht konsumatorët e ekonomive familjare, bizneset dhe konsumatorët publik.

Të dhënat nga operatori tregojnë se rrjeti i shërbimit është i shtrirë në rreth 90% të territorit të komunës. Shërbimi i grumbullimit të mbeturinave ofrohet në zonën urbane, peri-urbane dhe atë rurale. Klientët e amvisërisë ndahen sipas mënyrës se si e pranojnë shërbimin, pjesa më e madhe e pranojnë shërbimin derë më derë (grumbullimi kryhet çdo ditë të javës) dhe klientë të pajisur me kontejnerë (grumbullimi kryhet 1 herë në javë). Në zonat peri-urbane dhe rurale, klientët e amvisërisë e pranojnë shërbimin derë më derë, me frekuencë grumbullimi po ashtu 1 herë në javë.

Sipas kapaciteteve ekzistuese, mungon infrastruktura për ndarjen e mbeturinave të veçanta, ku si pasojë ato përzihen me mbeurina tjera në kontejnerë dhe përfundojnë në deponi. Gjenerimi i lartë i mbeturinave përbën një shqetësim të madh për mjedisin. Përqindja e mbeturinave nga ndërtim/demolimi është e lartë duke krijuar nevojën për vëmendje të veçantë në menaxhimin e tyre në të ardhmen, ku bashkë me mbeturinat shtazore ato mbesin të pa menaxhuara, gjë për të cilën shfaqet nevoja për infrastrukturë dhe menaxhim të integruar. Reciklimi ndodh në bazë vullnetare nga sektori privat, do të thotë nga disa kompani private që operojnë në komunë. Ekzistojnë iniciativa për riciklim dhe kompostim, megjithatë informacioni mbi efektivitetin e tyre është i kufizuar.

## **V. PËRMBLEDHJE E PROBLEMEVE MJEDISORE**

Më poshtë paraqiten problemet më të rëndësishme mjedisore, zonat mjedisore dhe faktorët avantazhues, përkeqësues, kërcënues dhe mundësitë për përmirësim.

**Zonat me probleme mjedisore**

Ky seksion përfshin një përmbledhje të:

Zonave që vuajnë nga një degradim i thellë mjedisor apo që po kalojnë një shok mjedisor;

Zonave me ndjeshmëri të veçantë mjedisore, të cilat mund të pësojnë ndryshime të pakthyeshme të ekosistemeve, nëse nuk u ofrohet një mbrojtje më e mirë mjedisore; dhe

Përmbledhje të natyrës dhe shkallës së ndikimeve të mundshme në mjedis, nisur nga përshkrimet e bëra në këtë kapitull.

**Zonat në rrezik të degradimit të thellë mjedisor**

Degradimi i tokës bujqësore për shkak të ndërtimit të paautorizuar në periferi të qytetit. Të gjithë lumenjtë dhe përroskat vuajnë degradim dhe ndotje mjedisore të shkakuar nga hedhja e vazhdueshme e mbeturinave të ujërave të ndotura dhe i lëndëve të ngurta, sidomos rrjedhat e poshtme të lumenjve ku ka shakarkime të mëdha të ujërave të zeza nga kanalizimet që hidhen në të po ashtu degradimi ndodh edhe nga Erozioni i tokës në fshatra si Zym, Pouskë, Planjane, ku mungon mbrojtja e shpateve.

Zona me rrezik të lartë janë Zona e Hasit dhe Koritnikut e degraduar nga prerjet ilegale të pyjeve, zona industriale e Landovicës ku ndodhin ndotje të vazhdueshme nga aktivitete të ndryshme, Bregu i Drinit dhe lumi i Prizrenit ku ndotja nga ujerat e zeza është evidente

Deponitë e hapura vazhdojnë të paraqesin një kërcënim serioz për mjedisin, pasi ato mungojnë në veshje mbrojtëse dhe pajisje teknike për parandalimin e ndotjes së tokës. Po ashtu, nuk janë ndërmarrë masa adekuate për të zvogëluar ndikimet nga reshjet intensive dhe stuhitë, të cilat shpesh shkaktojnë derdhje ndotëse në ujëra sipërfaqësorë dhe nëntokësorë. Ndërkohë, aktivitetet industriale dhe deponimi i

pakontrolluar i mbeturinave vazhdojnë të kontribuojnë në ndotjen e rëndë të tokës, ujit dhe ajrit. Rreziqet shtesë nga zjarret pyjore, shpërthimet potenciale dhe pikat e shpërndarjes së karburanteve rrisin edhe më tej cenueshmërinë e mjedisit dhe kërcënojnë sigurinë e komuniteteve përreth.

Zonat me ndjeshmëri të lartë mjedisore, si Parku Kombëtar “Sharri” dhe zonat me biodiversitet të pasur, po përballen me presion të shtuar nga shpyllëzimi dhe ndërtimet ilegale. Në kuadër të planifikimit të zhvillimeve të ardhshme në Planin Zhvillimor Komunal (PZHK), është thelbësore të mbrohen këto zona të trashëgimisë natyrore. Ato përfaqësojnë habitate kritike për ruajtjen e larmisë biologjike, luajnë rol kyç në stabilizimin e klimës dhe ofrojnë potencial të madh për zhvillimin e turizmit dhe rekreacionit të qëndrueshëm. Kjo kërkon ndërhyrje të synuara që promovojnë uljen e emetimeve të karbonit dhe përmirësimin e menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve ujore.”

Parku Kombëtar “Sharri” - Biodiversitet, pyje alpine, burime ujore

Zona e Koritnikut dhe Malësisë së Hasit - Ekosistem ujqor dhe korridor ekologjik

Duhet marrë vendime të kujdesshme në lidhje me përdorimin e ardhshëm të tokës në zonat e parapara për viken/rekreacion si dhe zonat tjera të pazhvilluara rreth vendbanimeve konform kufijve të propozuar ndërtimor.

Problemet mjedisore të identifikuar lidhur me menaxhimin e mbeturinave të ngurta apo të lëngëta, si dhe ndotja e ajrit janë të trajtueshme nëse investimet kryhen në kohë dhe në mënyrë efektive. Me këtë plan janë trajtuar:

furnizimi me ujë;

menaxhimi i ujërave të zeza;

trafiku; dhe

menaxhimi i integruar i mbeturinave

Ekziston ndërkohë edhe legjislacioni dhe politikat përkatëse të cilat po zhvillohen me qëllim që t’u përgjigjen problemeve mjedisore. Potencialisht ekziston problemi i ndotjes dhe i rënies së nivelit të ujërave nëntokësore për shkak të lumenjve të ndotur dhe të degraduar nga eksploatimi i rërës dhe zhavorrit si dhe pompimit të ujërave nëntokësore. Efekti i kësaj ndotjeje dhe i zvogëlimit të ujërave nëntokësore mund të jetë i vështirë për t’u parashikuar dhe riparuar.

Nëse nuk ndalohen ndërtimet pa kriterë në zonat e rëndësishme mjedisore, në mënyrë të veçantë, zhvillimi i cili po ndodh në rrethinë të disa vendbanimeve, si në tokat me bonitet të lartë ashtu edhe në zonat kodrinore, ndikon në aspektin biologjik, prishjen e zinxhirit ushqimor, ndërprerjen e korridoreve të rëndësishme për komunikim të ekosistemeve mes vete, si dhe në aspektin peizazhik, rritjen e rrjedhjes sipërfaqësore, gjë e cila mund të përshpejtojë proceset natyrore të erozionit dhe të shkaktojë rrëshqitje të tokës ose përmytje, sidomos në zonën urbane.

Në raportet e nivelit qendror, ofrohen në formë të përgjithësuar informata të sektorit shëndetësor në Kosovë, duke vënë në dukje çështje si siguria e ujit të pijshëm dhe siguria rrugore si shqetësime madhore, por në këto raporte nuk trajtohet në mënyrë specifike, ndërkohë që vë në pah edhe natyrën kontradiktore të disa prej treguesve shëndetësorë. Këto raporte që në përmbajtje kanë edhe aspektin mjedisor, mund të shfrytëzohen për të rekomanduar që Qeveria e Kosovës dhe ajo komunale duhet të kalojnë nga ndërhyrjet me karakter kurativ në mjedis dhe shëndetësi, në ato me karakter parandalues.

## **VI. PËRMBLEDHJE E PËRMBAJTJES SË PZHK**

Vizioni dhe skenarët e zhvillimit

Vizioni i Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Prizrenit 2025-2033 është:

**Prizreni** - kryeqytet historik, kulturor dhe turistik, me rëndësi nacionale dhe ndërkombëtare, qendër e sigurt, lider rajonal që lidh qytetërimet, urë lidhëse moderne në udhëkryqin rajonal, zhvillim rezilient i qëndrueshëm urban dhe policentrik, turizëm të integruar të trashëgimisë kulturore e natyrore me infrastrukturë bashkohore “SMART”.

*Qëllimet dhe objektivat e PZHK sipas fushave tematike*

#### ZHVILLIMI EKONOMIK

|                  |                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
|------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>QËLLIMI 1</b> | <b>Zhvillimi ekonomik i qëndrueshëm dhe policentrik përmes shpërndarjes së balancuar të aktiviteteve ekonomike në gjithë territorin e komunës</b>                                                                                                                                |
| Objektivi 1      | Fuqizimi i rolit funksional dhe ekonomik i nën qendrave si Korishë, Reçan, Zhur, Gjonaj, Piranë të përcaktuara me koncept hapësinorë deri në vitin 2033.                                                                                                                         |
| Objektivi 2      | Përcaktimi i zonave të reja ekonomike, përfshirë: zona industriale (Lubizhdë, Vlashnjë, Korish, ish kampi i bechtel enka Zhur), zona komerciale (rruga Tirana dhe korridoret hyrëse në qytet) dhe zona inovative dhe teknologjike (ITP Prizren).                                 |
| <b>QËLLIMI 2</b> | <b>Zgjerimi i mundësive për punësim të rinjve dhe gjinisë femërore</b>                                                                                                                                                                                                           |
| Objektivi 1      | Nxitja e investimeve në sektorin e industrisë përpunuese, bujqësisë moderne dhe turizmit, që rezultojnë në hapje të vendeve të punës (parashikohet rritje e numrit të punësuarve deri në 24,515 deri më 2032).                                                                   |
| Objektivi 2      | Reforma në arsimin profesional dhe forcimi i lidhjes mes shkollave profesionale/Universitetit “Ukshin Hoti” me bizneset lokale, për të reduktuar mospërputhjen e aftësive.                                                                                                       |
| Objektivi 3      | Subvencione dhe lehtësira fiskale për bizneset e vogla dhe të mesme, kryesisht në zonat rurale, me qëllim decentralizimin e zhvillimit ekonomik.                                                                                                                                 |
| <b>QËLLIMI 3</b> | <b>Krijimi i hapësirave të specializuara për zhvillim ekonomik-turistik jashtë qendrës urbane deri në vitin 2033</b>                                                                                                                                                             |
| Objektivi 1      | Zhvillimi i infrastrukturës turistike në zona urbane dhe rurale, në veçanti me fokus në asetat e trashëgimisë kulturore dhe natyrore (Qendra Historike, Kalaja me rrethine, Zym, Korisha, Vlashnje dhe zonat malore, Sharri, Hasi, Vrrini, Potguri dhe Luma) deri në vitin 2033. |
| Objektivi 2      | Restaurim dhe mirëmbajtje e aseteve historike (Kalaja e Prizrenit, Qendra Historike, Lidhja e Prizrenit, Kishat e vjetra, Xhamitë e periudhës osmane) për të ruajtur autenticitetin kulturor deri në vitin 2033.                                                                 |
| <b>QËLLIMI 4</b> | <b>Rritja e kapaciteteve prodhuese për industrinë e lehtë inovative dhe potencial për eksport</b>                                                                                                                                                                                |
| Objektivi 1      | Modernizimi i zonave industriale, përfshirë sigurimin e rrugëve, kanalizimeve, energji stabile dhe qasje në internet për fabrikat e reja ose ekzistuese deri në vitin 2033.                                                                                                      |
| Objektivi 2      | Mbështetje për industrinë e përpunimit të drurit dhe tekstilit, duke lehtësuar qasjen në tregjet ndërkombëtare, certifikime të cilësisë (ISO, CE) dhe promovim të produkteve artizanale.                                                                                         |
| Objektivi 3      | Nxitja e vlerës së industrisë së përpunimit ushqimor, për t’i shtuar vlerë produkteve vendore dhe për të siguruar tregje të reja eksportuese në vazhdimësi deri në vitin 2033.                                                                                                   |
| <b>QËLLIMI 5</b> | <b>Rritja, zhvillimi dhe diversifikimi i sektorit të bujqësisë dhe agro industrisë në komunën e Prizrenit</b>                                                                                                                                                                    |

|                  |                                                                                                                                                                                                                                                      |
|------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Objektivi 1      | Rritja e aftësisë konkurruese në sektorin agro-ushqimor dhe kalimi në standardet e BE-së në prodhim dhe përpunim deri në vitin 2033, duke ngritur standarde kyçe të BE-së për produkte bujqësore;                                                    |
| Objektivi 2      | Nxitja e konkurrueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së zingjirit agro-ushqimor duke rritur numrin e fermerve dhe nderlidhjen me kompanitë e përpunimit të produkteve agro-ushqimore me 50% deri në vitin 2033;                                            |
| Objektivi 3      | Investime në infrastrukturën publike që mbështesin zhvillimin e tokave bujqësore, duke ndihmuar në rehabilitimin e 500 hektarëve, përmirësimin e rrugëve fushore dhe vendosjen e 1000 ha të tokës bujqësore në sistem të ujitjes deri në vitin 2033; |
| Objektivi 4      | Diversifikimi i 30% të fermave ekzistuese në sektorë të rinj të bujqësisë (si prodhimi i produkteve organike, serra, etj.) dhe krijimi i 1500 vendeve të reja të punës deri në vitin 2033.                                                           |
| Objektivi 5      | Rritja e fondit blegtoral për 50% deri vitin 2030.                                                                                                                                                                                                   |
| Objektivi 6      | Rritja e fondit bletar për 20% deri 2033.                                                                                                                                                                                                            |
| Objektivi 7      | Konsolidimi i 40% të tokave bujqësore të shpërndara dhe nxitja e rritjes së efikasitetit të përdorimit të tyre deri në vitin 2033, përmes sistemeve të menaxhimit të tokave dhe mbështetje për fermerët;                                             |
| Objektivi 8      | Përmirësimi i rrjetit të ujitjes dhe zgjerimi i saj në bashkpunim me Radoniqi-Dukagjini deri vitin 2033.                                                                                                                                             |
| Objektivi 9      | Krijimi i mundësive për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të shpeztaris, përmes krijimit të strategjive për mbrojtjen e mjedisit dhe rritjen e numrit të fermave të shpeztarëve me 25% deri në vitin 2033.                                        |
| <b>QËLLIMI 6</b> | <b>Zvogëlimi i varësisë nga remitencat dhe sektori Informal, përmes zhvillimit të shumë sektorëve</b>                                                                                                                                                |
| Objektivi 1      | Stimulimi i startup-eve në fushën e IT-së, marketingut digjital, shërbimeve kreative, si pjesë e ITP Prizren dhe qendrave të tjera inovative.                                                                                                        |
| Objektivi 2      | Përfshirja e ekonomisë së gjelbër: projekte për efikasitet energjetike, parqe me panele solare, ngritjen e industrisë së riciklimit dhe prodhimin e produkteve organike.                                                                             |
| Objektivi 3      | Zgjerimi i tregtisë ndërkufitare me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut (hapja e pikave të reja doganore, promovimi i produkteve vendore), duke shfrytëzuar autostradën “Ibrahim Rugova” dhe mundësinë e zhvillimit të infrastrukturës hekurudhore.   |
| Objektivi 4      | Organizimi i panairove tregtare vjetore/rajonale dhe platformave online, për të promovuar produktet e Komunës së Prizrenit (bujqësore, artizanale, industriale).                                                                                     |
| <b>QËLLIMI 7</b> | <b>Shfrytëzimi i qëndrueshëm, i kontrolluar dhe me përfitim ekonomik lokal i pasurive nëntokësore, në përputhje me standardet mjedisore dhe planifikimin hapësinor</b>                                                                               |
| Objektivi 1      | Të legalizohen ose të ri-rishikohen 100% e aktiviteteve ekzistuese të nxjerrjes brenda territorit komunal deri në vitin 2028, përmes përfshirjes në dokumentet hapësinore dhe pajisjes me leje sipas ligjit për pasuri minerare.                     |
| Objektivi 2      | Shfrytëzimi racional dhe miqësor me mjedisin i pasurive nëntokësore deri në vitin 2030.                                                                                                                                                              |
| <b>QËLLIMI 8</b> | <b>Zhvillimi dhe shfrytëzimi i burimeve të energjisë së ripërtëritshme për qëllime ekonomike, duke kontribuar në tranzicionin energjetik, reduktimin e varësisë nga burimet fosile dhe krijimin e vendeve të reja të punës.</b>                      |
| Objektivi 1      | Nxitja e Investimeve Lokale për energji me Partneritet Publiko-Private, deri 2033.                                                                                                                                                                   |
| Objektivi 2      | Të integrohen burimet e energjisë diellore në të paktën 30% të ndërtesave komunale deri në vitin 2033.                                                                                                                                               |
| Objektivi 3      | Të mundësohet prodhimi i energjisë së ripërtëritshme për vetë-konsum dhe shitje të tepricës nga të paktën 10 ndërmarrje ose ferma të mëdha private deri në vitin 2033.                                                                               |

#### INFRASTRUKTURA TEKNIKE

| Objektivi 1      | Angazhimi i komunitetit në planifikim për 100% të zonave me ndërtime pa leje, deri me 2033.                                                                                                                                                                                                           |

#### **BANIMI**

|                  |                                                                                                               |
|------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>QËLLIMI 1</b> | <b>Sigurimi i banimit të qëndrueshëm për të plotësuar nevojat e tanishme dhe në të ardhmen</b>                |
| Objektivi 1      | Përmirësimi i cilësisë dhe qëndrueshmërisë së fondit të banimit deri në vitin 2032.                           |
| Objektivi 2      | Shfrytëzim efikas dhe i mençur i tokës për banim deri në vitin 2032.                                          |
| Objektivi 3      | Ruajtja e vlerave kulturore dhe ambientale në zhvillimin e banimit deri në vitin 2026                         |
| Objektivi 4      | Fuqizimi i kapaciteteve institucionale dhe pjesëmarrja qytetare në planifikimin e banimit deri në vitin 2027. |
| Objektivi 1      | Sigurimi i banimit të përballueshëm dhe gjithëpërfshirës                                                      |
| Objektivi 1      | Sigurimi i strehimit të përballueshëm dhe adekuat për të gjithë qytetarët deri në vitin 2032.                 |
| Objektivi 2      | Integrimi socio-hapësinor dhe përzjerja e funksioneve deri në vitin 2032.                                     |

#### **SHFRYTËZIMI I TOKËS**

|                  |                                                                                                         |
|------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>QËLLIMI 1</b> | <b>Mbrojtje e sipërfaqeve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore në kuadër të shfrytëzimit të Tokës</b> |
|------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------|

|                  |                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
|------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Objektivi 1      | Konservimi dhe promovimi i sipërfaqeve me trashëgimi kulturore dhe natyrore deri në vitin 2033 dhe në vazhdimësi.                                                                                                                                                                        |
| Objektivi 2      | Promovimi i sipërfaqeve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore si dhe ngritja e vetëdijes në mbrojtjen të këtyre sipërfaqeve në funksion të shfrytëzimit të Tokës dhe zhvillimit të turizmit deri në vitin 2033 dhe në vazhdimësi.                                                       |
| <b>QËLLIMI 2</b> | <b>Prizreni komunë me vendbanime kompakte</b>                                                                                                                                                                                                                                            |
| Objektivi 1      | Mbajtja nën kontroll e zhvillimeve të ndërtimit në vendbanimet e shpërndara me theks të veçantë : Lubizhdë, Korishë, Lutogllavë dhe Petrovë, Nashec.                                                                                                                                     |
| <b>QËLLIMI 3</b> | <b>Shfrytëzimi për banim të qëndrueshëm në komunën e Prizrenit.</b>                                                                                                                                                                                                                      |
| Objektivi 1      | Promovimi i ndërtesave eficiente në sipërfaqet për banim, me shfrytëzim të energjisë së ripërtërishtme deri në vitin 2033.                                                                                                                                                               |
| Objektivi 2      | Zhvillimi i banimit përmes ndërtesave të mençura deri në vitin 2033 dhe në vazhdimësi.                                                                                                                                                                                                   |
| <b>QËLLIMI 4</b> | <b>Shfrytëzimi efikas i Tokës për një zhvillim të qëndrueshëm për infrastrukturë publike dhe sociale.</b>                                                                                                                                                                                |
| Objektivi 1      | Zhvillimi i sipërfaqeve të planifikuara për infrastrukturë në shërbim të arsimit, shëndetësisë, institucioneve të mirëqenies sociale, institucione kulturore, administratë, institucione kulturore, hapësira sportive, ndërtesa fetare dhe varreza deri në vitin 2033 dhe në vazhdimësi. |
| <b>QËLLIMI 5</b> | <b>Shfrytëzimi efikas i Tokës për një zhvillim të qëndrueshëm socio-ekonomik dhe mjedisor</b>                                                                                                                                                                                            |
| Objektivi 1      | Ruajtja e harmonisë mes shfrytëzimit të Tokës për banim dhe shfrytëzimeve të përziera, industrisë, rekreimit dhe institucioneve deri në vitin 2033                                                                                                                                       |
| Objektivi 2      | Zhvillimi i qëndrueshëm i shfrytëzimit të Tokës deri në vitin 2033                                                                                                                                                                                                                       |
| <b>QËLLIMI 6</b> | <b>Mbrojtja dhe zhvillimi i sipërfaqeve të Tokës pyjore</b>                                                                                                                                                                                                                              |
| Objektivi 1      | Ruajtja dhe menaxhimi efikas i sipërfaqeve ekzistuese të Tokës pyjore deri në vitin 2033 dhe në vazhdimësi.                                                                                                                                                                              |
| Objektivi 2      | Ripyllëzimi i sipërfaqeve të reja dhe atyre të dëmtuara të Tokës pyjore deri në vitin 2033                                                                                                                                                                                               |
| <b>QËLLIMI 7</b> | <b>Mbrojtja dhe zhvillimi i sipërfaqeve ujore</b>                                                                                                                                                                                                                                        |
| Objektivi 1      | Ruajtja dhe menaxhimi efikas i sipërfaqeve ekzistuese ujore deri në vitin 2033 dhe në vazhdimësi.                                                                                                                                                                                        |
| <b>QËLLIMI 8</b> | <b>Zhvillim i sipërfaqeve të reja për zona komerciale dhe industriale si dhe krijimi i kushteve për hapësira të reja</b>                                                                                                                                                                 |
| Objektivi 1      | Zhvillimi i sipërfaqeve për korridore ekonomike zhvillimore përgjatë rrugës magjistrale M25 në vitin 2033.                                                                                                                                                                               |
| Objektivi 2      | Ruajtja e zonave ekzistuese komerciale dhe industriale deri në vitin 2033.                                                                                                                                                                                                               |
| Objektivi 3      | Zhvillim i sipërfaqeve me kapacitete për turizëm në funksion të zhvillimit ekonomik deri në vitin 2029 dhe në vazhdimësi.                                                                                                                                                                |
| Objektivi 4      | Zhvillimi i sipërfaqeve me potencial për zhvillim të turizmit malor, deri në vitin 2033 dhe në vazhdimësi.                                                                                                                                                                               |
| Objektivi 5      | Zhvillim i qëndrueshëm i turizmit rural në zonat me potenciale për zhvillime të tilla, deri në vitin 2033 dhe në vazhdimësi.                                                                                                                                                             |
| <b>QËLLIMI 9</b> | <b>Krijimi i hapësirave për zgjerim dhe fuqizim të infrastrukturës rrugore</b>                                                                                                                                                                                                           |
| Objektivi 1      | Krijimi i sipërfaqeve për rrugë të planifikuara në shërbim të një infrastrukture rrugore të qëndrueshme, deri në vitin 2033, në sipërfaqe ekzistuese por edhe në ato të planifikuara për zgjerim.                                                                                        |
| Objektivi 2      | Mirëmbajtja dhe zhvillimi i korridoreve ekzistuese rrugore deri në vitin 2033.                                                                                                                                                                                                           |
| OBJEKTIVI 3      | Alokimi sipërfaqeve për korridore, për rrugë bujqësore dhe pyjore deri në vitin 2033.                                                                                                                                                                                                    |

## Koncepti i zhvillimit hapësinor

Koncepti i Zhvillimit Hapësinor i Komunës së Prizrenit është themeli i planifikimit afatgjatë të territorit dhe instrumenti strategjik për orientimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe të integruar hapësinor. Ky koncept është hartuar në përputhje me analizat e detajuara të gjendjes aktuale, vizionin zhvillimor të komunës, qëllimet dhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm agjendat ndërkombëtare dhe qëllimet dhe objektivat sektoriale dhe dokumentet relevante të planifikimit në nivel lokal dhe qendror.


### SKENARËT E PROPOZUAR HAPËSINOR

Ekipi komunal i planifikimit dhe ekipet tjera të angazhuara në hartimin e Planit Zhvillimor Komunal të Prizrenit kanë analizuar nga aspekti ekonomik, social dhe mjedisor edhe integrimin e konceptit të PZHK-së 2013- 2023 përmes Skenarit të 1-të, si pikënisje e mundshme e zhvillimit hapësinor të komunës.

Ndërsa, skenari 2 dhe 3 kanë dalë duke tentuar të adaptohen zhvillimet aktuale, si dhe të planifikohet për projeksionet e dala nga analizat e këtij plani. Në parim, këto dy skenarë dallojnë për kah tipologjia e zhvillimit dhe disa elementeve funksionale e hierarkike.

Të tre skenarët kanë një parim të përgjithshëm të zhvillimit hapësinor të Prizrenit, një komunë me territor rrafshinor dhe kodrinor, që kërkon të ndërtohet mbi një model të rritjes kompakte, ku për dallim nga skenari 1 dhe 3 që promovojnë shpërndarje hapësinore të zhvillimeve, skenari 2 mbështetë një zhvillim monocentrik.

Në këtë pjesë bëhet fjalë për strukturën hapësinore dhe lokacionin e zhvillimit dhe organizimit të ardhshëm. Këtu adresohen çështjet që kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik, infrastrukturën, popullsinë, vendbanimet, çështjet sociale, trashëgiminë kulturore dhe ambientin.



Skenari 1. Skenari i zhvillimit policentrik nga plani i vjetër 2013-2025

Skenari II i Planit Zhvillimor Komunal për Komunën e Prizrenit parashikon një strukturë të koncentruar ne aspektin monocentrike po pa perjashtuar edhe qendra të tjera rurale me intensitet me të lartë të zhvillimit ekonomik dhe hapësinor, me theks të veçantë në konsolidimin e qytetit të Prizrenit si nyja qendrore urbane, ekonomike dhe transportuese në nivel kombëtar dhe rajonal.



Skenari 3, është një skenar policentrik i zhvillimit, i cili nënkupton një zhvillim të qëndrueshëm dhe të koordinuar të të gjitha zonave të Komunës së Prizrenit.

Në aspektin e zhvillimit nacional dhe regional, Komuna e Prizrenit ndodhet në hapësirën e portokalltë me zonë e zhvilluar kulturore e turistike, agro-industriale dhe tregtare, që sipas Planit Hapësinor të Kosovës paraqet qendrat vitale të zhvillimit ekonomik të vendit. Kjo ndikon në parashikimin e zhvillimit të infrastrukturës së transportit modern dhe intensiv, përfshirë modernizimin e transportit ekzistues dhe ndërtimin e transportit përmes hekurudhës që ndërlidhin Prizrenin me kryeqytetin e Kosovës – Prishtinën dhe qendrat tjera si Mitrovicën apo Ferizajin. Këto lidhje të mira me korridoret nacionale dhe ndërkombëtare i mundësojnë Komunës së Prizrenit qasje dhe arritje në tregjet dhe shërbimet që ofrohen në nivel vendi me shpejtësi.

Skenari 3 paraqet një zhvillim policentrik të Prizrenit në aspektin ekonomik dhe social, ku qendra komunale është qyteti i Prizrenit, ndërsa si nën-qendra për zhvillim ekonomik parashihen 4 nën-qendra si Prizreni, Korisha, Zhuri, Landovica kjo duke u bazuar edhe në zhvillimet e deri tanishme në këto zona, por edhe në shtrirjen e shërbimeve më afër qytetarit duke u bazuar në nevojat dhe karakteristikat zhvillimore të zonës.

Skenari 3 promovon zhvillimin ekonomik të qëndrueshm dhe të balancuar duke planifikuar korridore ekonomike përgjatë rrugës N25 (rruga Prizren – Suharekë – Prishtinë dhe ana tjetër Prizren – Vermicë, si dhe korridoret zhvillimore përgjatë rrugës R107 Prizren - Gjakovë), e cila do të krijojë korridore ekonomike dhe logjistike me potencial të lartë të zhvillimit ekonomik, po ashtu me këtë skenar planifikohet edhe zona komerciale dhe tregtare dhe zonë me potencial zhvillimor rekreativ dhe turistik në pjesën lindore dhe pjesën perendimore të Komunës.

Në këtë skenar, synohet fuqizimi i rolit dhe zonave me funksione publike, institucionale dhe rekreative në zonën urbane, duke e integruar me boshtin aktual të qendrës së qytetit.

Për **NYJET** si pjesë të kërkesave nga udhëzimi administrativ, ky skenar bazohet në zhvillimin e zonës urbane të Prizrenit si nyje kryesore, por duke mos lënë anash zhvillimin e vendbanimeve tjera, si nën qendrat të rendit të mesëm si: Zhuri, Reçan, Gjonaj, Piranë dhe Korishë, të cilat do të shërbejnë si Qendra të Rendit të Mesëm për vendbanimet rrethuese.

Ky skenar parasheh mundësinë e krijimit të strukturave administrative apo ndarjes në lagje të zonës urbane.

Për **KORRIDORET** në kuadër këtij skenari, trajtohen vijat më të rëndësishme të zhvillimit dhe të transportit e të telekomunikacionit. Përfshihen linjat e transportit që bëjnë ndërlidhjen e vendbanimeve në mes veti, por edhe janë nyje kryesore për gjithë komunën dhe rajonin. Sa i përket korridoreve të zhvillimit ekonomik, ky skenar propozon korridoret e zhvillimit ekonomik që shtrihen përgjatë gjithë rrugëve nacionale N-25 dhe R107, e cila mundëson zhvillim të qëndrueshëm komercial, akomodimin e bizneseve në këto korridore në mënyrë të planifikuar me infrastrukturë të përshtatshme, me zhvillim të korridoreve të reja të planifikuara me kujdes sipas legjislacionit në fuqi.

Në lidhje me **LOTËSIMIN DHE DENDËSIMIN**, skenari 3 ofron lotësim dhe dendësim në zonën urbane, në funksionon të kompaktimit të qytetit. Sipas nevojave lotësimi dhe dendësimi, planifikohet edhe në vendbanimet tjera, mirëpo gjithmonë të monitoruara dhe duke i ruajtur zonat bujqësore. Vendbanimet në të cilat parashihet zgjerimi dhe lotësimi i kufijve ndërtimor në vendbanimet Hoqa e Qytetit, Gjonaj, Piranë, Zhurë, Landovicë, Korishë etj, gjerë në vendbanimet tjera planifikohet lotësimi përmes dendësimit kompakt të tyre.

Në lidhje me **MBAJTJEN NËN KONTROLL**, synohet mbajtja nën kontroll e të gjithë kufijve të rinj ndërtimor, qoftë të zonës urbane, qoftë të vendbanimeve rurale, e sidomos në zonat rurale ku jetojnë një përqindje më e vogël e banorëve, duke mos lejuar shtrirje të reja dhe intensitet të ndërtimeve jashtë zonave të definuara për ndërtim.

**ZONAT E RITJES**, ofrohet ri-zhvillimi i zonave ekzistuese me intensitet më të lartë. Zonat e ritjes përcaktohen duke u bazuar në resurse dhe potencial për zhvillim, me mundësi drejt tokës së zbrastët të përshtatshme për lotësim, për të siguruar shfrytëzim efektiv të tokës, parashihet dendësimi i zonës urbane në zonën lindore.

Në lidhje me **MBROJTJEN**, mbrohet toka bujqësore, gjithashtu synohet mbrojtja e pasurive të tjera, qoftë nëntokësore, qoftë sipërfaqësore, për t'u shfrytëzuar ose marrë masat e duhura sipas planit në funksion të qëndrueshmërisë afatgjate.

Në këtë skenar, mbrojtja e tokës bujqësore I-IV, mbrojtja e pyjeve dhe ujërave nëntokësore, zgjerimi i sipërfaqeve nën sistem të ujitjes dhe mundësitë për konsolidimin e tokave bujqësore, janë pjesë e disa iniciativave lokale dhe si pjesë e projektit nacional Radoniqi-Dukagjini për ujitjen e tokës bujqësore në rrafshin e Dukagjinit.

**ZHVILLIMI I EKOSISTEMEVE DHE ZHVILLIMI I TURIZMIT RURAL**, në malet e Sharrit, Pashtrikut dhe Kortnikut janë pjesë e skenarit në të cilat planifikohet të zhvillohen aktivitete turistike malore dhe agro-turistike, duke fuqizuar turizmin e fermave dhe llojet e tjera të kulturave agrare në funksion të agro turizmit.

Gjithashtu vlen të theksohet që në këto zona Skenari 3 planifikon kombinimin e turizmit agrar apo agroturizmit me turizmin malor me karakter rekreativ e turistik, me zhvillim të bujtinave, vikend shtëpizave, shtigjeve për ecje, çiklizëm e forma të tjera rekreative.

**ZHVILLIMI I TURIZMIT KULTUROR**, Ky skenar planifikon edhe zhvillimin e turizmit kulturor me theks të veçantë në zonën urbane të komunës pikërisht zonën e vjetër të qytetit.

Këto mund të jenë vizita në Kalanë e Prizrenit, Lidhja e Prizrenit, Hamamin i qytetit, kujtime për ngjarjet historike dhe aktivitete të tjera kulturore në lidhje me ngjarjet historike në këto zona.

**ENERGJIA E RIPËRTRITSHME** në Komunën e Prizrenit planifikohet të sjellë përparim dhe zhvillim ekonomik. Zhvillimi i energjisë së erës dhe energjisë solare planifikohet të ndihmojë në zvogëlimin e emetimeve të gazrave të dëmshëm për mjedisin dhe të ndihmojë në rritjen e prodhimit të energjisë në mënyrë të qëndrueshme dhe të pastër. Kjo ndikon në zhvillimin e sektorit të energjisë së ripërtrishme dhe në rritjen e investimeve në këtë sektor.

Pjesë e këtij skenari janë edhe përcaktimi i disa zonave të reja dhe zonave ekzistuese të cilat kanë potencial dhe ndikim në zhvillim ekonomik të Komunës së Prizrenit Këto zona janë:

1. Korridori zhvillimor ekonomik që lidhë Prizrenin me Gjakovën, Suharekën dhe Shqipërin;
2. Zona ekonomike në Prizren 'IT' dhe Korishë;
3. Zonat historike e qytetit;
4. Zonat me potencial të energjisë së ri-përtrishme.
5. Hapësirat me potencial për turizëm rural.





## ELEMENTET E KONCEPTIT TË ZHVILLIMIT HAPËSINOR




Koncepti i Zhvillimit Hapësinor për Komunën e Prizrenit u zhvillua duke përdorur konceptet hapësinore vijuese për të arritur qëllimet dhe objektivat hapësinore.


Në konceptin kryesor të Zhvillimit Hapësinor janë marrë parasysh dhe është reflektuar gjendja aktuale dhe zhvillimet e planifikuara. Është caktuar logjika hapësinore dhe është bërë integrimi i kërkesave të planifikimit hapësinor që rrjedhin prej vizionit, qëllimeve dhe objektivave të drejtorive përkatëse të Komunës së Prizrenit, përmes tërësive të zgjidhjeve të planifikuara.

Në vijim në mënyrë të përgjithshme janë prezantuar nëpërmjet përshkrimit tekstual dhe hartave konceptuale hapësinore për të gjitha strategjitë sektoriale dhe propozimet për zhvillim për komunën.

Koncepti i Zhvillimit Hapësinor është baza kryesore e zhvillimit dhe shfrytëzimit të tokës për hartat tematike të PZHK-ja. Si përmbajtje dhe elemente të trajtuara në skenare dhe të përvetësuara në konceptin kryesor janë **nyjet, korridoret, plotësimi dhe dendësimi, mbajtja nën kontroll, mbrojtja dhe zonat e rritjes**, të cilat janë analizuar edhe me implikime financiare përveç si përmbajtje dhe elemente hapësinore.


|                                                                                                              |                                                                                                                                                                                 |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <p><b>NYJET</b></p>        | <p><i>Përcaktimi i disa nyjeve dhe trajtimi i tyre si pika hapësinore të përqendruara ku promovohet densifikimi i banimit, intensifikimi i funksioneve dhe aktiviteteve</i></p> | <p>Për <b>NYJET</b> si pjesë të kërkesave nga udhëzimi administrativ ky skenar bazohet në zhvillimin e disa nyjeve që i konsideron të rëndësishme. Ky skenar propozon zhvillimin e qendrës urbane të Prizrenit si qendër e rendit të parë.</p> <p>Nyjet e tjera të rëndësishme vendbanimet Korisha, Zhuri, Reçani, Gjonaj dhe Piranë zhvillohen si qendra të rendit të dytë apo qendra me potencial ekonomik, ndërsa nyjet tjera ekzistuese do trajtohen mjaftueshëm brenda kufijve aktual si qendra bazike.</p>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| <p><b>KORRIDORET</b></p>  | <p><i>Trajtimi i disa lidhjeve/korridoreve ndërmjet nyjeve, përgjatë të cilave natyrshëm mund të nxitet dhe inkurajohet një intensitet i rritur i zhvillimit</i></p>            | <p><b>KORRIDORET</b>, në kuadër të këtij skenari trajtojnë vijat më të rëndësishme të zhvillimit, transportit, telekomunikacionit dhe korridoret ekonomike-tregtare. Përfshijnë linjat e transportit që bëjnë ndërlidhjen e vendbanimeve në mes veti por edhe janë një kryesore për gjithë regionin. Korridor i rëndësishëm i këtij skenari është korridori hekurudhor që lidhë Prizrenin me Prishtinën dhe qendrat tjera brenda Kosovës si dhe me korridoret pan Evropiane. Sa i përket hapësirave zhvillimore komerciale (korridoreve) të zhvillimit ekonomik, ky skenar propozon fuqizimin e korridorit që kalon nga Prizreni në drejtim të Suharekës-Prishtinës, korridorin zhvillimorë në drejtim të Gjakovës dhe korridorin zhvillimor në drejtim të Vërmicës. Korridoret zhvillimore ekzistuese do të monitorohen dhe rehabilitohen, kurse zhvillimi</p> |

|                                                                                                                   |                                                                                                                                                                                                             |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                                                                                                                   |                                                                                                                                                                                                             | përreth korridoreve të reja duhet të planifikohet me kujdes.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| <b>PLOTËSIM DHE DENDËSIM</b><br> | <i>Paraqet mundësi dhe potencial të mbushjes dhe densifikimit të hapësirave me zhvillime të caktuara, për të arritur zhvillim hapësinor kompakt dhe për të rritur pragun e popullsisë</i>                   | Në lidhje me <b>PLOTËSIMIN DHE DENDËSIMIN</b> , skenari ofron plotësim dhe dendësim në zonën urbane, duke u zgjeruar në drejtim të veri-perëndimit të qytetit. Sipas nevojave plotësim dhe dendësim planifikohet edhe në vendbanime tjera, mirëpo gjithmonë të monitoruara dhe duke ruajtur zonat bujqësore.                                                                                                                                                                                               |
| <b>MBAJTJA NËN KONTROLL</b><br> | <i>Koncepti i Mbjajtjes nën Kontroll i referohet nevojës për të kufizuar zhvillimin joefikas me dendësi të ulët, përmes përdorimit të kufirit për zhvillim urban për një periudhë të përkufizuar kohore</i> | Në lidhje me <b>MBAJTJEN NËN KONTROLL</b> , synohet mbajtja nën kontroll e të gjithë kufinjve të ri ndërtimor, qoftë të zonës urbane, qoftë të vendbanimeve rurale, e sidomos në zonat rurale ku jetojnë një përqindje më e vogël e banorëve, duke mos lejuar <b>shtrirje</b> të reja, dhe intensitet të ndërtimeve jashtë zonave të definuara për ndërtim. Po ashtu synohet të mbahet nën kontrollë vendbanimet që shtrihen në zona me sistem të ujitjes për të mbrojtur tokat bujqësore.                 |
| <b>MBROJTJA</b><br>            | <i>Koncepti i mbrojtjes i referohet nevojës për mbrojtjen e resurseve të vlefshme natyrore, kulturore, ekonomike dhe të trashëgimisë</i>                                                                    | Në lidhje me <b>MBROJTJEN</b> , mbrohet toka bujqësore, dhe gjithashtu synohet mbrojtja e pasurive të tjera qoftë nëntokësore, qoftë sipërfaqësore, për t'u shfrytëzuar ose marrë masat e duhura sipas planit në funksion të qëndrueshmërisë afatgjate. Po ashtu skenari promovon mbrojtjen e zonave të trashëgimisë natyrore dhe kulturore si: Kalanë e Prizrenit, apo zona historike e Prizrenit si dhe zonat e mbrojtura natyrore si: Paraku Nacional i Sharrit, Zona e Pashttrikut, Liqeni i Vermicës. |

**ZONAT E RITJES**

Koncepti me Zona të Rritjes paraqet zhvillim të zonave ekzistuese me intensitet më të lartë dhe zhvillim të tokës së zbrazët të përshtatshme për plotësim, në mënyrë që të sigurohet shfrytëzimi i tokës

Në lidhje me **ZONAT E RITJES**, ofrohet ri-zhvillimi i zonave ekzistuese në intensitet më të lartë. **Zonat e rritjes** përcaktohen duke u bazuar në resurse dhe potenciale për zhvillim, me mundësi drejt tokës së zbrazët të përshtatshme për plotësim për të siguruar shfrytëzim efektiv të tokës.



Harta 7 Koncepti kryesor për zhvillimin e ardhshëm hapësinor të komunës së Prizrenit

**Aspekte përkatëse të gjendjes aktuale mjedisore**

Komuna e Prizrenit deri në vitin 2023 u përball me sfidën e madhe lidhur me strukturimin dhe organizimin e menaxhimit mjedisor. Duke pasur parasysh mungesën e një Plani Lokal të Veprimit në Mjedis, ekzistonte një vakum politikash që qoi në më pak efektivitet në ndërhyrjet mjedisore. Kjo rrjedh nga të kuptuarit se dinamizmi dhe qasja proaktive janë një nevojë urgjente për t'iu përgjigjur nevojave aktuale në domenin mjedisor të kësaj komune. Pa hartimin e një plani të ri, bëhet mjaft sfiduese për të adresuar problemet e reja që u shfaqën pas vitit 2018.

Në vitin 2023, Sektori i Mjedisit dhe Menaxhimit të Mbeturinave është angazhuar në aktivitetet e ndërgjegjësimit të publikut, eliminimit të pikave të ndotjes dhe edukimit në shkolla. Përveç kësaj, përfshihet edhe angazhimi në projektet e menaxhimit të mbeturinave, mirëmbajtjes së hapësirave të gjelbra dhe rrugëve. Drejtoria e Inspektorateve gjithashtu ka ndërmarrë masa për të adresuar disa çrregullime mjedisore, përfshirë ndalimin e veprimtarive të paligjshme të guroreve dhe konfiskimin e rërës së nxjerrë nga Drini i Bardhë. Aktivitetet e nxjerrjes së zhavorrit dhe gurëthyesve, veçanërisht në rajonin e Hasit dhe Anadrinës në komunën e Prizrenit, të cilat përmbajnë numrin më të madh të separacioneve në Kosovë, gjithashtu krijojnë një ndikim të madh mjedisor. Situata përkeqësohet edhe më shumë me aktivitetet ilegale që po kryhen në veri të fshatrave Lukinaj dhe Breg Drini, të cilat përfshijnë gjermime të paligjshme dhe degradim të mjedisit. Ky sektor ka nevojë urgjente për monitorim të rreptë dhe zbatim të fortë të ligjeve për mbrojtjen e mjedisit për të ndaluar shkatërrimin e mëtejshëm të ekosistemeve lokale.

Në Prizren dhe në Kosovë në përgjithësi, mungesa e sistemeve të monitorimit është vërtet shumë serioze, veçanërisht për cilësinë e tokës, ujit dhe zhurmës. Pra, problemet janë të vështira për t'u njohur në realitet e rrjedhimisht edhe masat që duhen ndërmarrë për të përmirësuar gjendjen mjedisore. Përderisa cilësia e ajrit monitorohet në nivel qendror, kjo nuk mund të jetë e mjaftueshme për t'iu përgjigjur të gjitha sfidave mjedisore që janë ndjerë nga komuna. Më tej, kërkohen përpjekje shumë më të strukturuar dhe të qëndrueshme në menaxhimin e mjedisit nga komuna e Prizrenit. Zhvillimi i një plani të ri veprimi për mjedisin, përmirësimi i sistemit të monitorimit mjedisor dhe forcimi i politikave në lidhje me menaxhimin e mbeturinave dhe burimeve natyrore, të gjitha këto janë pjesë e nevojave të përgjithshme që duhen adresuar.

### **Popullsia dhe shëndeti publik**

Ndikimet në shëndetin publik, janë ato të cilat lindin si pasojë e bashkëveprimit me receptorët mjedisorë të tilla si ajri, uji apo toka dhe nëpërmjet të cilëve ndotësit bëhen potencial përmes transportit në ujë dhe kontaktit me njerëzit. Kapaciteti mjedisor i komunës do të thotë, para së gjithash ruajtja në nivele të pranueshme e parametrave kryesore mjedisore. Dëndësia e popullsisë në disa vendbanime, zhvillimi pa plan i tyre, mungesa e hapësirave publike rekreative dhe sidomos të gjelbëra sjell pa dyshim uljen e cilësisë së jetës, përkeqësimin e parametrave mjedisorë të pranuar si standarde, shpenzime të larta të shoqërisë për rregullimet e mëtejshme për njësi sipërfaqeje dhe shpenzime me të larta për mbrojtjen e shëndetit. Komuna e Prizrenit ka një sistem solid të shëndetit publik, me qendra familjare dhe spital rajonal që shërbejnë popullsinë. Gjithsejt ka 14 qendra shëndetësore familjare dhe 26 shtëpi shëndetësore në nivel komune.

### **Ndikimet mjedisore të lidhura me popullsinë dhe shëndetin**

Më poshtë, janë identifikuar disa ndikime që janë të lidhura me shëndetin në tërësi:

Ndertimi/rehabilitimi i kanalizimeve dhe trajtimi i ujërave të zeza si dhe manaxhimi i mbeturinave  
Rehabilitimi i zonave me ndotje të lartë dhe atyre që janë potencial për ndotje të komponenteve mjedisore;

Ruajtja dhe mbrojtja e burimeve të ujit të pijshëm nga ndotja;

Konsiderimi i kërkesës së rritur të infrastrukturës intensive në vendbanimet me densitet të lartë;

Promovimi i mobilitetit, ecjes dhe ciklizmit;

Rikonsiderimi i trafikut publik për uljen e emetimit të gazeve dhe zhurmave;

Cilësia e ndërtesave, densiteti dhe zonimi duhet të mbështeten në mënyrë adekuate nga shërbime dhe facilitete të tjera komunale në disa vendbanime të komunës;

Raportet ndërtimore me siperfaqet e gjelbëra duhet të parashikojnë densitetin e popullsisë; Zhvillimi i parqeve dhe sipërfaqeve të gjelbra dhe mirëmbajtja e atyre aktuale; Rritja e koordinimit me autoritetet paralele planifikuese për të vlerësuar impaktet mjedisore në shëndetin e njeriut.

### **Veçoritë natyrore kryesore të komunës dhe zonat që ndikohen**

Në vlerësimin e gjendjes ekzistuese të komunës së Prizrenit, janë evidentuar disa veçori natyrore dhe karakteristika të rëndësishme që ndikojnë në mjedisin dhe zhvillimin e tij. Komuna e Prizrenit, e cila ka një pasuri të madhe natyrore, përfshin luginat, male, pyje dhe toka bujqësore të pasura, por gjithashtu ka përjetuar ndikime të dukshme nga zgjerimi i aktivitetit urban dhe zhvillimi i infrastrukturës. Kjo ka krijuar disa sfida mjedisore që lidhen me përdorimin e tokës dhe menaxhimin e resurseve natyrore.

Një nga sfidat më të mëdha është zgjerimi i vazhdueshëm i zonave të banuara në tokë bujqësore dhe hapësira natyrore, veçanërisht në qytetin e Prizrenit dhe rrethinat e tij. Ky zhvillim ka ndikim të drejtpërdrejtë në pasuritë natyrore të komunës, duke përfshirë zvogëlimin e hapësirave të gjelbërta, ndotjen e ajrit dhe ujërave, si dhe humbjen e biodiversitetit. Përveç zgjerimit të banesave, janë të pranishme edhe aktivitete komerciale dhe industriale që shtrihen në zona që dikur ishin të pasura me lëndë të parë dhe habitate natyrore.

Zgjerimi i qytetit dhe i infrastrukturës ka pasur ndikim të rëndësishëm në zvogëlimin e zonave të pyjeve dhe përdorimin intensiv të tokave për aktivitetet bujqësore dhe ndërtimore. Ky zhvillim ka shpërndarë dhe fragmentuar shumë habitate natyrore, duke e bërë më të vështirë ruajtjen e biodiversitetit dhe përbalimin e kërkesave për menaxhim të qëndrueshëm të tokës.

Zonat që janë më të prekura nga këto zhvillime përfshijnë fushat dhe luginat që rrethojnë qytetin, si dhe zonat malore dhe pyjet që janë të ndjeshme ndaj ndikimeve të zhvillimit urban. Në këtë kuadër, një sfidë e madhe mbetet balancimi i zhvillimit urban dhe ruajtjes së hapësirave natyrore dhe burimeve të rëndësishme bujqësore dhe pyjore. Ky balancim është thelbësor për të siguruar qëndrueshmërinë e zhvillimit dhe për të garantuar ruajtjen e biodiversitetit dhe burimeve natyrore për brezat e ardhshëm.

### *Zonimi i territorit të komunës*

Duke u bazuar në tipologjinë e vendbanimeve, popullsinë, infrastrukturën shoqëruese, arkitekturën, gjeomorfologjitë dhe sidomos çështjet mjedisore që mund të paraqesin komunën e Prizrenit me PZHK janë trajtuar si më poshtë:

### **Zonat e ndërtimit në vendbanime:**

#### *Zonat e pazhvilluara me ndërtim*

PZHK ka identifikuar dhe trajtuar zonat e pazhvilluara me ndërtim duke i destinuar si tokë bujqësore, tokë pyjore, zona të mbrojtura natyrore dhe zona tjera të mbrojtura, zona për infrastrukturë hidrografike dhe infrastrukturë tjetër.

#### *Zonat turistike*

PZHK ka identifikuar zonat rekreative turistike të komunës që përfshijnë monumente historike, pasuri natyrore: si liqenet, lumenjtë, ujëvarat e Lumbardhit dhe të Konjushës, pikat malore, manifestimet kulturore etj. Bukuritë natyrore, lartësia adekuatë, shtigjet e përshtatshme për skijim, janë veçori për zhvillimin e turizmit dimëror, sportiv dhe shëndetësor.

Asetet më të rëndësishme kulturo-historike të komunës janë: Kompleksi i Shatërvanit, Nënkalaja, Marashi, Kalaja, Kisha e Shën Premtës, Kisha e Shën Shpëtimit, Xhamia e Bajraklisë, Xhamia e Safi Sinan Pashës,

Hamamet e qytetit, krojet e qytetit, Ura e Gurit dhe një numër i madh i shtëpive folklorike të qytetarëve, të trashëguara ndër shekuj. Liqenet glacialë në komunën e Prizrenit paraqesin njërën nga bukuritë më të mëdha të Malit Sharr. Pika malore Bistra dhe Maja e Koblicës janë lokalitete shumë tërheqëse dhe vazhdimisht të frekuentuara në masë të madhe nga alpinistët, bjeshkatarët dhe dashamirët e natyrës. Maja e Arnenit është po ashtu një resurs shumë tërheqës natyror, i cili gjendet në afërsi të Prevallës, në lindje të malit Oshllak. Prevalla, nga ana tjetër, është një zonë turistike e cila është e rrethuar me hotele, bujtina dhe vikend shtëpiza.

### **Zona të mbrojtura**

PZHK ka evidentuar gjithashtu asetet e trashëgimisë natyrore dhe kulturore nën mbrojtje, si zona karakteristike me vlera të trashëgimisë kulturore, historike, peizazhike, mjedisore e turistike. Këtu janë identifikuar:

Rezervatet natyrore që janë hapësirat origjinale të natyrës me forma karakteristike të bimëve, kafshëve si pjesë integrale e ekosistemeve të dizajnuara kryesisht për ruajtjen e stoqeve gjenetike. Rezervatet natyrore janë ruajtur in situ (në vend) me nën klasifikimin e bimëve, kafshëve ose rezervateve speciale. Në Kosovë ndodhen 75 zona të mbrojtura natyrore me 46.437 ha (4.25% e territorit të Kosovës). Në Prizren ndodhen tre rezervate natyrore: Maja e Arnetit, Oshllaku dhe Pisha e madhe me përbërje të pastër të munikës-arnenit (*Pinus Heldreichi*);

Hapësira më e madhe e mbrojtur është Parku Nacional “Malet e Sharrit” që ndodhet në Komunën e Prizrenit (Tabela 1.7). Malet e Sharrit ndodhen në Kosovë dhe Maqedoni dhe kanë një sipërfaqe prej 1600 km<sup>2</sup>. Pjesa veriore e Maleve të Sharrit i takon Kosovës me një sipërfaqe prej 1100 km<sup>2</sup>. Në vitin 1986, nga Kuvendi i Kosovës, Parku Nacional i Maleve të Sharrit ka fituar statusin e regjistrimit si trashëgimi natyrore, i klasifikuar si Park natyror. Parku Nacional ka planin e tij zhvillimor të përpiluar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në pajtim me rregullat ndërkombëtare për parqet nacionale.

Me karakteristikat e saja të pasura natyrore, si sipërfaqja topografike, klima, vetitë hidrologjike si dhe biodiversiteti i florës dhe faunës, parku nacional është shpallur si qendër e hulumtimit shkencor dhe edukativ në shkencat natyrore dhe zhvillimin ekonomik rural dhe ekoturizmin. Por parku është në rrezik të madh nga ndotja dhe degradimi i mjedisit si rezultat i përdorimit joracional të burimeve natyrore, si dhe prerja ilegale e pyjeve dhe niveli i lartë i erozionit (Plani Hapësinor – Parku Nacional “Mali Sharr”).

Parku Nacional “Malet e Sharrit” dallon me vlera botanike, shtazore, ekologjike, turistike, rekreative, sportive, edukative dhe kulturore. Parku është aq i pasur me biodiversitet jo vetëm në Kosovë por edhe në regjionin e Gadishullit Ballkanik, dhe përfaqëson një thesar të llojeve bimore ku disa prej tyre janë endemike, të rralla ose të rrezikuara nga shfarosja. Në Parkun Nacional “Malet e Sharrit” ndodhen 4 rezervate të mbrojtura natyrore. Tre prej tyre ndodhen në Komunën e Prizrenit si rezervat natyror: Maja e Arnetit, Oshllaku dhe Pisha e madhe. I katërti është Rusenica e cila ndodhet në komunën e Therandës ku jeton rruqebulli i Ballkanit gjithashtu edhe Zona e Pashttrikut, Liqeni i Vermicës.

### **Zona industriale dhe zonat për zhvillime industriale:**

Zonat industriale paraqesin rol të rëndësishëm për bizneset në zhvillimin e aktiviteteve të tyre dhe rrjedhimisht kanë kontribuar pozitivisht në rritjen ekonomike të komunës.

Parku i Biznesit në Lubizhdë, Komuna e Prizrenit në vitin 2012 ka filluar përgatitjen e zonës së përcaktuar për Park Biznesi, por e cila akoma nuk është e gatshme për funksionim. Lokacioni i Parkut ndodhet në pjesën verilindore të qytetit, në lokacionin e ish-poligonit të shenjëtarisë që shtrihet në boshtin rrugor Lubizhdë – Korishë në largësi 5 km prej qytetit.

Parcela kufizohet në pjesën veriperëndimore me magjistralen Prizren–Therandë, në pjesën jug-perëndimore me fshatin Lubizhdë, në pjesën verilindore me fshatin Korishë, kurse në afërsi ka hotelin “OK”. Kjo zonë llogaritet të jetë zona ekonomike më e madhe në Kosovë, e cila posedon një sipërfaqe prej rreth 80.33 hektarësh, e përbërë nga 22 parcela, sipërfaqja e të cilave shkon deri në 3000 m<sup>2</sup>. Zona llogaritet të ketë hapësirë për rreth 200 biznese. Parcelat janë me pronësi komunale dhe private. Zona është e destinuar për industri të lehtë dhe është planifikuar të përbëhet nga hapësira të gjelbëruara, hapësira për prodhime industriale, hapësira për ofrimin e shërbimeve të përpunimit të prodhimeve industriale, prodhime zejtare, depo të materialeve ndërtimore e të ngjajshme, si dhe hapësira për përpunimin e produkteve artizanale.

Deri më tani në infrastrukturën teknike janë bërë këto investime:

Ndërtimi i rrugëve dhe trotuareve

Kanalizimi atmosferik dhe fekal

Sinjalizimi horizontal dhe vertikal

Ndërtimi i ujësjellësit

Ndriçimi publik

Rrjeti elektroenergjetik

Instalimi i kabllove të internetit dhe telefonit

Lokacioni i përzgjedhur ofron kushte të mira për transport, si të atij publik ashtu edhe të atij privat, të këmbësorëve dhe atij çiklistik. Si arterie kryesore është magjistrala Prishtinë – Prizren si dhe mundësia e lidhjes së ardhshme në autostradën Merdarë – Morinë – Durrës, e me këtë edhe mundësia e lidhjes me portin e Durrësit dhe atij të Shëngjinit.

Mungesa e punës konsistente në investimin e plotë dhe përfundimin e punëve në zonë për funksionalizimin e saj ka bërë që Parku i Biznesit ende të mos jetë i gatshëm për vendosjen e bizneseve. Kjo situatë është shqetësim i madh për bizneset lokale duke paraqitur një kufizim të mundësive për zhvillimin e aktiviteteve biznesore dhe ndikimin pozitiv që do të kishte në rritjen ekonomike të komunës.

### **Pyllëzimi, zhvillimi i pyjeve, zonat e gjelbërta dhe të pushimit**

Shumë nga zonat e gjelbra, zonat rekreative natyrore, në shumicën e rasteve vihen para shkatërrimit total të tyre, si pasojë e prerjeve ilegale, djegieve, zhvillimeve tjera dhe neglizhencës. Hapësira pyjore dhe zonat e shkurreve dhe kullosat janë planifikuar në PZHK. Deri me tani shumë pak është bërë për zonat lokale rekreative apo hapësirat ku mund të organizohen pushime vikendi apo diçka të ngjajshme.

Esenciale të cilat PZHK duhet ofruar është siguri i korridoreve të gjelbërta që do të zhvillohen të bashkë shoqëruara me ndërtimin e rrugëve të reja dhe atyre ekzistuese, korsive për këmbësorët dhe biçikletat, tampon zonave në zhvillimet industriale dhe tjera të ndjeshme, si dhe rritjen e fondit të gjelbërt në komunë.

### **Çështje mjedisore që lidhen me mjedisin fizik**

PZHK duhet të identifikojë qartë në hartë sipërfaqet e ekspozuara ndaj erozionit dhe çfarë shkalle të erozionit, nëse kemi erozion shumë të fortë ose të fortë atëherë të merren rreptësisht masa për parandalimin e tyre. Poashtu duhet të tregoj për zonat e vërshimeve dhe masat të cilat duhet të merren për minimizimin e dëmeve.

- Zhvillimi i zonës industriale duhet të bëhet në territorin e përcaktuar, i pa përzier me hapësirat e banimit duke e precizuar qartë në hartë (pjesa grafike);
- Zhvillimet industriale duhet të zhvillohen sipas standardeve mjedisore të përcaktuara vetëm pas ri-

vlerësimeve mjedisore;

- Zhvillimi i pyjeve, hapësirave të gjelbërta, shiritave gjelbërues dhe tampon zonave duhet të konsiderohet në çdo plan e sidomos në Planet Rregulluese të Hollësishme dhe projekte duke vlerësuar raportet e ndërtimit.

### **Biodiversiteti, flora dhe fauna**

Në komunën e Prizrenit, Parku Nacional Mali Sharr, është një zonë e njohur ku është ruajtur biodiversiteti dhe resurset biologjike janë shfrytëzuar në mënyrë të qëndrueshme. Është e rëndësishë së veçantë për të siguruar mbrojtjen e diversitetit gjeologjik dhe gjeomorfologjik të regjionit dhe diversitetit biologjik, duke përfshirë këtu edhe burimet e pasura të ujit dhe specieve endemike të regjionit. Zonat për rekreacion në Parkun nacional Malet e Sharrit do të përcaktohen në planet detaje të shkallës së ulët të planifikimit duke marrë në konsideratë opinionet e organizatave dhe institucioneve relevante, duke u bazuar në strategji të Planit Hapësinor për Parkun Nacional "Mali Sharr". Me karakteristikat e saja të pasura natyrore, si sipërfaqja topografike, klima dhe vetitë hidrologjike si dhe biodiversiteti i florës dhe faunës, Parku Nacional është shpallur si qendër e hulumtimit shkencor dhe edukativ në shkencat natyrore dhe zhvillimin ekonomik rural dhe ekoturizmin. Por parku është në rrezik të madh nga ndotja dhe degradimi i mjedisit si rezultat i përdorimit joracional të burimeve natyrore, si dhe prerja ilegale e pyjeve dhe niveli i lartë i erozionit (Plani Hapësinor – Parku Nacional "Mali Sharr").

Parku Nacional "Malet e Sharrit" dallon me vlera botanike, shtazore, ekologjike, turistike, rekreative, sportive, edukative dhe kulturore. Parku është aq i pasur me biodiversitet jo vetëm në Kosovë por edhe në regjionin e Gadishullit Ballkanik, dhe përfaqëson një thesar të llojeve bimore ku disa prej tyre janë endemike, të rralla ose të rrezikuara nga shfarosja. Në Parkun Nacional "Malet e Sharrit" ndodhen 4 rezervate të mbrojtura natyrore. Tre prej tyre ndodhen në Komunën e Prizrenit si rezervat natyror: Maja e Arnetit, Oshlaku dhe Pisha e madhe. I katërti është Rusenica e cila ndodhet në komunën e Therandës ku jeton rrëqebulli i Ballkanit.

### **Çështje mjedisore të lidhura me biodiversitetin, florën dhe faunën**

Çështjet kryesore të identifikuara në lidhje me menaxhimin e biodiversitetit në Komunën e Prizrenit, të cilat kërkojnë trajtim të veçantë në kuadër të zhvillimit të mëtejshëm, përfshijnë ndotjen dhe degradimin e trupave ujorë, si dhe shkatërrimin e habitateve natyrore të lidhura me pyjet dhe bimësinë vendase. Monitorimi i trupave ujorë si Lumbardhi i Prizrenit dhe Drini i Bardhë ka evidentuar përqendrimet të larta të ngarkesave organike, të pasqyruara përmes tejkalimeve të vlerave të SHBO5, nitrateve, nitriteve dhe fosforit, që janë indikatorë të ndotjes urbane dhe industriale. Këto ndotje ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e ujit, uljen e përqendrimit të oksigjenit të tretur dhe për rrjedhojë, në rënien e popullatave të peshqve dhe organizmave të tjerë ujorë. Nivelet e larta të lëndëve ushqyese përshpejtojnë eutrofikimin dhe shkaktojnë ndryshime të dukshme në strukturën e ekosistemit akuatik. Po ashtu, shkatërrimi dhe prerja pa kontroll e pyjeve në territorin e komunës, sidomos në zonat malore të Sharrit dhe rajoneve përreth, ka sjellë pasoja të mëdha ekologjike – si rritja e rrjedhës sipërfaqësore, ulja e infiltrimit të ujërave nëntokësore dhe rritja e rrezikut për erozion dhe vërshime. Për të ruajtur biodiversitetin dhe balancin ekologjik në nivel lokal dhe rajonal, është thelbësore që masat për mbrojtje dhe restaurim të habitateve të merren që në fazat e hershme të planeve zhvillimore. Për më tepër, harmonizimi i planeve hapësinore dhe masave për ruajtjen e mjedisit duhet të realizohet në koordinim të ngushtë me institucionet e nivelit qendror dhe agjencitë relevante, për të mundësuar krijimin e korridoreve ekologjike dhe lidhjen natyrore ndërmjet ekosistemeve të ndryshme, të cilat janë jetike për lëvizjen dhe mbijetesën e specieve të egra

### **Planifikimi i përdorimit të tokës dhe çështje të sigurimit të shërbimeve**

Për të vlerësuar tokën si burim natyror i pa rinovueshëm dhe rolin që ka në hapësira banimi, fillimisht po japim definicionin dhe funksionet bazë të saj. Toka përcaktohet si pjesa e sipërme e kores tokësore, veçanërisht komplekse, që luan rol të rëndësishëm në mjedis në zhvillimin social dhe ekonomik të cilat janë vitale për jetën. Direktiva kuadër e tokës (BE) identifikon shtatë funksione bazë të saj të cilat janë:

Prodhimi i biomasës, përfshirë bujqësinë dhe pylltarinë;  
Mbajtjen, filtrimin dhe transformimin e ushqyesve, substancave dhe ujit;  
Mbajtëse e biodiversitetit;  
Mjedis fizik dhe kulturor për njerëzit dhe aktivitetet humane;  
Burim materialesh;  
Si depozitë karboni;  
Vend për trashëgiminë gjeologjike dhe arkeologjike.

Komuna e Prizrenit përballet me sfida të theksuara në fushën e planifikimit dhe përdorimit të qëndrueshëm të tokës, veçanërisht si pasojë e zhvillimeve të pa planifikuara. Ndërtimet joformale dhe jo të kontrolluara kanë çuar në një shfrytëzim të papërshtatshëm të hapësirave tokësore, duke cenuar integritetin urban dhe mjedisor të territorit komunal.

Në kontestin e infrastrukturës së ujit, kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura, situata është pothuajse e papërshtatshme. Shumë prej këtyre strukturave tashmë janë të vendosura në tokë me pronësi private, duke e bërë vështirë kontrollin dhe mirëmbajtjen e tyre për shkak të mangësisë së një përcaktimi të qartë për të drejtat e përdorimit të tokës.

Në mungesë të një planifikimi të integruar dhe të vlerësimit të resurseve, aprovimi i projekteve të reja ka ndodhur pa kujdes të mjaftueshëm. Kjo mungesë e planifikimit ka rënduar situatën e infrastrukturës dhe shërbimeve të nevojshme për vendbanimet, që në thelb duhet të sigurohen nga autoriteti komunal. E kombinuar me një kërkesë për infrastrukturë dhe mobilizim të burimeve financiare, kushtet mjedisore në komunë vazhdojnë të jenë një problem, për adresimin e të cilave është e nevojshme të përmirësohet planifikimi urban dhe vlerësimi/monitorimi i rregullt i resurseve. Gjithashtu, është e rëndësishme që autoritetet lokale të sigurojnë burime financiare të mjaftueshme për të përmirësuar infrastrukturën dhe për të mbështetur projektet e nevojshme që adresojnë problemet mjedisore në komunë.

Rritja e presionit urban, mungesa e strategjive të azhurnuara, zhvillimi i planeve urbanistike, kanë ndikuar në zënien e zonave të gjera për plotësimin e nevojave të banimit/strehimit dhe kanë kufizuar mundësitë për projektimin e hapësirave të gjelbërimit urban duke çuar në degradim të peizazhit urban.

Në këtë kontekst, skenari i zhvillimit policentrik që propozon Plani Zhvillimor Komunal për zhvillimin urban është shumë i rëndësishëm, i cili lejon shpërndarjen e zhvillimeve në zona të ndryshme të qytetit, duke lehtësuar presionin në qendrën kryesore dhe duke ndihmuar në ruajtjen e peizazhit urban. Qasja policentrike inkurajon diversitetin urban dhe krijon mundësi për hapësira të gjelbërta të përshtatshme në secilën zonë të qytetit.

### **Çështje mjedisore që lidhen me përdorimin e tokës**

Planifikimi i zonave ndërtimore (kufinj të zgjeruar ndërtimor) nuk duhet prekur sipërfaqe të gjelbërta, përveç në raste të jashtëzakonshme.

Duke pasur parasysh keto specifika, në kapitullin më poshtë paraqiten masa të pershatshme për shtimin e sipërfaqeve të gjelbra. Për më tepër, paraqiten kriteret mjedisore që kufizojnë zhvillimin e ndërtimeve, që përfshijnë kriteret e forta mjedisore-shëndetsore, kriteret e trashëgimisë kulturore, kriteret peizazhike, inxhinierike dhe të infrastrukturës.

### **Rreziqet natyrore në mjedisin fizik**

Rreziqet natyrore në mjedisin fizik përbëjnë një sfidë të rëndësishme për zhvillimin e qëndrueshëm të Komunës së Prizrenit. Rritja e ndërtimeve, veçanërisht në zona të pambrojtura, si dhe degradimi i vazhdueshëm i sipërfaqeve pyjore, kanë shtuar ndjeshëm rrezikun nga përmbytjet dhe fatkeqësitë e tjera natyrore. Menaxhimi i rrezikut nga katastrofat duhet të shihet si prioritet, përmes një qasjeje të integruar që përfshin:

- Zhvillimin dhe zbatimin e masave për adaptimin dhe zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë;
- Forcimin e kapaciteteve të shërbimeve hidrometeorologjike për parashikim dhe reagim të hershëm
- Zbatimin e kodeve të detyrueshme të ndërtimit, në veçanti në zonat me rrezik sizmik;
- Krijimin e mekanizmave për sigurimin e qytetarëve dhe bizneseve nga pasojat e katastrofave natyrore

### **Mjedisi i ndërtuar dhe kultura**

#### *Cilësia e ajrit*

Cilësia e ajrit është një komponentë e rëndësishme e mirëqenies mjedisore dhe shëndetit publik. Ndërsa monitorimi i vazhdueshëm nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) ka treguar një trend përmirësimi në disa parametra kryesorë, përfshirë grimcat e pluhurit PM10 dhe PM2.5. Sfidat mjedisore dhe burimet e ndotjes mbeten të shumta dhe komplekse. Prizreni bënë pjesë në zonën ZKS1 të monitorimit, ku vlerësohen parametrat si grimcat e pluhurit (PM10 dhe PM2.5) dhe gazrat (NO<sub>2</sub>, SO<sub>2</sub>, O<sub>3</sub>, dhe CO). Ky sistem monitorimi siguron të dhëna për vlerësimin e ndotjes brenda territorit të komunës, duke u bazuar në udhëzimet administrative për normat e cilësisë së ajrit në Kosovë. Kontribuesit kryesor në emetimin e gazrave dhe aerosolëve në ajër konsiderohen aktivitetet industriale, burimet e lëvizshme dhe të palëvizshme, vatrat e djegies përfshirë këtu edhe ngrohjen me lëndë djegëse. Aktiviteti i gurëthyesve, është burim i rëndësishëm i ndotjes së ajrit duke kontribuar në emetimin e pluhurit, procesi i nxjerrjes gjithashtu, i cili kontribuon në çlirimin e SO<sub>2</sub> dhe NO.

Monitorimi i grimcave PM10 dhe PM2.5 gjatë periudhës 2021-2024 tregon një rënie të vazhdueshme të përqendrimeve të tyre, të cilat vazhdimisht kanë qëndruar nën vlerat kufitare vjetore të vendosura për mbrojtjen e shëndetit (PM10: 40 µg/m<sup>3</sup> dhe PM2.5: 25 µg/m<sup>3</sup>). Ky trend nënkupton një përmirësim të cilësisë së ajrit në lidhje me këta ndotës, megjithatë, mbetet thelbësore garantimi i vazhdimësisë së kësaj trajektoreje pozitive.

Përqendrimet e NO<sub>2</sub> të regjistruara në periudhën 2021-2024 janë dukshëm më të ulëta se vlerat kufi për mbrojtjen e shëndetit publik dhe vegjetacionit, duke treguar se ky ndotës nuk ka krijuar probleme serioze gjatë kësaj periudhe.

Përqendrimet e SO<sub>2</sub> dhe O<sub>3</sub> qëndrojnë gjithmonë nën vlerat kufitare të vendosura për mbrojtjen e shëndetit, gjë që tregon një gjendje të favorshme sa i përket këtyre ndotësve. Monoksidi i karbonit (CO) karakterizohet nga përqendrime vazhdimisht të ulëta dhe të qëndrueshme që nuk i tejkalojnë kufijtë rregullatorë, duke treguar një efekt të papërfillshëm në cilësinë e ajrit.

Hartimi i një inventari të përafërt të shkarkimeve në ajër nga aktivitetet e motorizuara (burime të lëvizshme) dhe nga përdorimi i lëndëve djegëse (burime të palëvizshme) do të ishte i realizueshëm; megjithatë, për shkak të mungesës së të dhënave të besueshme, është shumë e vështirë të sigurohet një pasqyrë e qartë mbi koncentrimin aktual të ndotësve dhe të bëhet një vlerësim i saktë i emisioneve."

### **Zhurma**

Në domenin e mbrojtjes së mjedisit zhurma paraqet një faktor me rëndësi hapësinore e cila ka ndikim të madh në dëmtimin e të dëgjuarit, në sistemin nervor, në hipertension, në koncentrim të njeriut në punë etj. Në përgjithësi, aktivitetet ekonomike dhe trafiku rrugor janë kontribues kryesor në ndotjen akustike në komunë. Megjithatë, mungesa e sistemeve të matjes paraqet një sfidë në vlerësimin e saktë të emetimeve të zhurmës. Direktiva evropiane për zhurmën mjedisore kërkon nga autoritetet vendore të vlerësojnë nivelet e zhurmës në mjedisin e tyre lokal, të përbushin treguesit e përbashkët të zhurmës dhe të hartojnë plane veprimi për të parandaluar ose zvogëluar efektet e dëmshme të zhurmës mjedisore. Në këtë aspekt, është e nevojshme zhvillimi i strategjive me objektivin kryesor për reduktimin e zhurmës në fushat e mëposhtme:

- Zvogëlimi i densitetit të trafikut; zvogëlimi i përqindjes së mjeteve të rënda të mallrave; ulje e shpejtësive; rinovimi i transportit publik dhe automjeteve (të rënda) të mallrave; ndërrimi i sipërfaqeve të rrugës etj.; dritare rezistente ndaj zërit;
- Krijimi i rregulloreve dhe standardeve për aktivitetet industriale që emetojnë zhurmë;
- Investime në sistemet e matjes së nivelit të zhurmës.

Çështjet jo-teknike, qasjet organizative dhe strategjike, janë po aq të rëndësishme:

- Një qasje organizative është thelbësore për integrimin e planifikimit të uljes së zhurmës në proceset aktuale të planifikimit në nivel lokal dhe bashkëpunimin me palët e interesuara dhe publikun brenda një qyteti. Qasja strategjike duhet të synojë në mënyrë ideale lidhjen e politikës lokale të zhurmës me politikën në nivel rajonal, kombëtar dhe të BE-së.

### **Burimet ujore**

Vlerësimi i nivelit të ndotjes së ujit zakonisht bazohet në monitorimin e cilësisë së ujërave, me ç'rast të dhënat janë siguruar nga Raporti për Gjendjen e Ujërave të Kosovës, i vitit 2020, për parametrat fiziko-kimik të ujërave për lumin Drini i Bardhë me vendmostrim – Vërmicë dhe Gjonaj, lumin Lumbardhi me vendmostrim - Vlashnje dhe Prevallë dhe lumi Toplluha me vendmostrim – Piranë. Rezultatet e monitorimit të cilësisë së ujërave tregojnë një variabilitet të konsiderueshëm në cilësinë e ujërave të lumenjve të komunës së Prizrenit.

Përqendrimet e oksigjenit të tretur të matura në Prizren në vendet e monitorimit, variojnë nga 7.5 mg/l në Lumbardhin e Prizrenit (Vlashnje) deri në 10.7 mg/l në Lumbardhin e Prizrenit (Prevallë). Ndërsa nivelet e larta në Prevallë tregojnë cilësi të mirë të ujit, nivelet e ulëta në Vlashnje pasqyrojnë një shkallë më të lartë ndotjeje që mund të prodhohet nga shkarkimet e ujërave të zeza dhe mbeturinat organike.

Kërkesa biokimike për oksigjen (BOD5) shërben si një metrikë për identifikimin e ndotjes organike, të cilën mikroorganizmat e metabolizojnë duke përdorur oksigjenin. Në lumenjtë Drini i Bardhë (Gjonaj) dhe Lumbardhi i Prizrenit (Vlashnje), nivelet e BOD5 janë të ngritura (13-16.5 mg/l), gjë që tregon për prani të konsiderueshme të ndotësve organikë. Nivele të tilla i atribuohen shkarkimeve të ujërave të zeza të patrajtuara ose efluentëve industriale.

Përçueshmëria elektrike është indikator i përqendrimit të kripërave të tretura në trupat ujorë, vlerat e larta të të cilit mund të tregojnë ndotje nga mbeturinat industriale ose ato bujqësore. Në mënyrë

domethënëse, përçueshmëri e lartë është matur në lumin Toplluha (Piranë) dhe lumin Drini i Bardhë (Gjonaj), deri në 520  $\mu\text{S}/\text{cm}$ . Vlerat e tilla të larta pasqyrojnë një nivel të konsiderueshëm të ndotjes nga aktivitetet njerëzore, përdorimi i plehrave në bujqësi dhe industri tjera lokale.

Nivelet e pH të regjistruara në stacionet monitoruese, kryesisht bien brenda intervalit standard prej 7.15 deri në 8.22, duke treguar një shkallë të moderuar të aciditetit ose alkalinitetit që është tipike për sistemet lumore të këtij rajoni gjeografik. Megjithatë, çdo devijim dramatik nga një varg i tillë vlerash në të ardhmen mund të tregojë kontaminim kimik.

Vlerat e nitrateve dhe nitriteve mund të konsiderohen si tregues të ndotjes së shkaktuar nga rrjedhjet bujqësore dhe largimi i ujërave të zeza. Vlera të larta të nitrateve deri në 2.4 mg/l janë prezente në lumin Toplluha (Piranë), gjë që mund të tregojë përdorim të madh të plehrave kimike në zonat përreth.

Përqendrime më të larta të fosforit total dhe ortofosfateve janë evidentuar në shumicën e vendeve të monitorimit, kryesisht në Lumbardhin e Prizrenit dhe në lumin Toplluha. Të dy lëndët ushqyese janë të implikuara në shkaktimin e fenomenit të eutrofikimit që rezulton në rritjen e tepërt të algave dhe një rënie të nivelit të oksigjenit të tretur në mjedisin ujor, duke paraqitur kështu probleme për ekosistemet ujore.

#### *Prodhimi i energjisë solare*

Përveç burimeve termike për ofrimin e ngrohjes, një mundësi tjetër e rëndësishme është shfrytëzimi i energjisë diellore. Kjo mund të realizohet përmes ndërtimit të impianteve me panele solare, të cilat shndërrojnë energjinë diellore në energji elektrike, e cila më pas mund të integrohet me sistemet ekzistuese të ngrohjes. Ngrohja përmes energjisë diellore mund të implementohet në dy forma: Në mënyrë të organizuar, përmes ndërtimit të impianteve kolektive me panele solare, të cilat do të ofrojnë ngrohje për një numër të madh të ekonomive familjare, si në lagje të tëra apo fshatra; Përmes impianteve individuale apo të vogla, të instaluar në shtëpi individuale ose ndërtesa kolektive, të cilat mundësojnë ngrohje autonome. Këto praktika janë duke u zbatuar me sukses në shumë vende të zhvilluara dhe vitet e fundit kanë filluar të gjejnë aplikim edhe në Kosovë, falë mbështetjes për energjinë e pastër dhe rritjes së vetëdijes për tranzicionin energjetik.

Përdorimi i energjisë solare paraqet një alternativë të qëndrueshme dhe të leverdishme për ngrohje dhe furnizim me energji elektrike. Përveç zvogëlimit të varësisë nga burimet fosile, energjia solare ndihmon në uljen e ndotjes së ajrit dhe reduktimin e emetimeve të gazrave serrë. Në planin afatgjatë, investimi në impiante solare përkthehet në kursime financiare për konsumatorët dhe rritje të sigurisë energjetike.

Për të nxitur më tej përdorimin e energjisë solare në Kosovë, nevojitet një politikë më proaktive e institucioneve publike për ofrimin e subvencioneve, lehtësimin e procedurave për instalim dhe ofrimin e trajnimeve për profesionistët lokalë. Krijimi i partneriteteve publike-private dhe përfshirja e komunave në projekte të energjisë së pastër do të përshpejtonin tranzicionin drejt një sistemi energjetik më të qëndrueshëm.

## **VII. PARIME, OBJEKTIVA DHE KRITERE MJEDISORE**

### **Objektivat e VSM**

Duke u bazuar në qëllimin e VSM-së, që përkon edhe me qëllimin e mbrojtjes mjedisore të vetë PZHK-së së Komunës së Prizrenit, janë përcaktuar objektivat mjedisore të VSM-së. Objektivat mjedisore qëndrojnë

po njëlloj për planet e niveleve tjera. Për më tepër, këto objektiva janë ndërtuar në përputhje me politikat e strategjitë mjedisore kombëtare, me Planin Hapësinor të Kosovës, si dhe me qëndrimet e sektorëve përkatës (që preken nga objektivat). Për çdo objektiv janë listuar ndikimet e mundshme të Planit në mjedis, nëse objektivi nuk realizohet, pra nëse nuk merren masat zbutëse, eliminuese apo parandaluese të dëmit mjedisor.

Në varësi të rëndësisë së tyre, objektivat ndahen në dy kategori: objektiva primare (ose globale) dhe objektiva lokale në nivel komunal. Vlerësimi realizohet individualisht për secilin nga objektivat mjedisorë të listuar më poshtë.

**Objektivi Mjedisor 1 (OM1) – Ajri:** Reduktimi i emetimeve të gazrave serrë, përmes promovimit të çiklizmit dhe përmbushjes së standardeve të Bashkimit Evropian.

**Objektivi Mjedisor 2 (OM2) – Uji:** Përmirësimi, ruajtja e cilësisë së ujit, parandalimi dhe zbutja e ndikimeve negative të aktivitetit njerëzor mbi burimet ujore dhe territorin, forcimi i kapacitetit për ruajtjen e ujit në ekosisteme natyrore dhe infrastruktura, si dhe minimizimi i përdorimit të panevojshëm të ujit.

**Objektivi Mjedisor 3 (OM3) – Toka:** Mbrojtja dhe përdorimi i manaxhimit të qëndrueshëm të tokës, parandalimi i erozionit të tokës, ruajtja e kapacitetit prodhues të tokës (kullosave);

**Objektivi Mjedisor 4 (OM4) – Biodiversiteti:** Mbrojtja dhe manaxhimi i qëndrueshëm i biodiversitetit, ruajtja e specieve organike dhe habitateve në funksion të ruajtjes së ekosistemeve, veçanërisht specieve endemike dhe endemorelikte të rralla dhe të kërcënuara;

**Objektivi Mjedisor 5 (OM5) – Pyjet:** Manaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve në funksion të garantimit të aftësisë vetëripërtëritëse të ekosistemit pyjor, zbutjes së efekteve të ndryshimeve klimatike;

**Objektivi Mjedisor 6 (OM6) – Peizazhi dhe Ekosistemet:** Rivitalizimi i ekosistemeve dhe peizazheve të prekura nga aktivitetet njerëzore, ruajtja e karakteristikave të dallueshme të peizazhit dhe pamjeve, ruajtja e trashëgimisë kulturore, historike dhe arkitekturore, duke përfshirë traditat lokale;

**Objektivi Mjedisor 7 (OM7) – Ndryshimet klimatike:** Zhvillimi i infrastrukturës urbane që nuk kontribuon në ndryshimet klimatike, përmes reduktimit të emetimeve të gazrave serrë dhe promovimit të formave të qëndrueshme të mobilitetit si çiklizmi, ecja dhe transporti publik.

**Objektivi Mjedisor 8 (OM8) – Trashëgimia kulturore:** Konservimi dhe restaurimi, ruajtja e trashëgimisë kulturore, historike dhe arkitekturore, duke përfshirë traditat lokale;

**Objektivi Mjedisor 9 (OM9) – Shëndeti:** Përmirësimi i shëndetit të popullatës garantimi i zhvillimit social dhe ekonomik në harmoni me mjedisin dhe burimet natyrore si dhe ulja e ekspozimit të komunitetit ndaj rreziqeve natyrore.

**Objektivi Mjedisor 10 (QM10) – Social-ekonomik:** Përmirësimi i mirëqenies sociale dhe ekonomike të komunitetit në përputhje me qëllimet e mbrojtjes së mjedisit, duke përfshirë zhvillimin e projekteve dhe politikave të qëndrueshme, rritjen e përfitimeve të komunitetit nga burimet natyrore dhe promovimin e përdorimit të teknologjive mjedisore në prodhim dhe konsum;

Objektivat e mësipërme synojnë përmirësimin e cilësisë së jetës në komunë (rritjen e sigurisë, ofrimin e mundësive për mënyrë aktive jetese, shtimin e sipërfaqeve të gjelbra, përmirësimin e cilësisë së ajrit, etj.).

Ato duhen shoqëruar me veprime operacionale konkrete që çojnë në përmbushjen e objektivave strategjike të planit.

Ndër të tjera, PZHK duhet të zbatojë disa parime dhe modele zhvillimi të pranura gjerësisht, si psh. Komuna e Prizrenit komunë policentrike, ku qytetari gjen shërbimet pranë vendbanimit të tij dhe nuk ka nevojë të udhetojë për të siguruar shërbimet e ndara në qendrën administrative.

Parime, objektiva dhe kritere mjedisore që kufizojnë zhvillimin komunal

Ky kapitull paraqet parimet për planifikim hapësinor të qëndrueshëm, objektivat strategjike dhe veprime operacionale në kuadër të hartimit të PZHK-së. Më tej paraqiten edhe kriteret mjedisore që kufizojnë zhvillimin komunal në vendbanime të ndryshme të komunës dhe pjesë të caktuara të qytetit.

Parimet e përgjithshme të planifikimit hapësinor

Parimet e përgjithshme të planifikimit hapësinor janë një tërësi rregullash të bazuara mbi eksperiencat ndërkombëtare, të cilat shkurtimisht mund të përmbledhen si më poshtë:

Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm;

Parandalimi i ndikimit të dëmshëm në mjedisin natyror;

Ruajtja e tipareve karakteristike natyrore, peizazhore, të florës e faunës;

Zhvillim ekologjikisht i shëndetshëm, ruajtje e korridoreve ekologjike për të garantuar mbrojtjen e habitateve dhe komunikimin e habitateve mes veti;

Marrja e masave parandaluese dhe rigjenerimi i mjediseve natyrore;

Përfshirja e parimeve të tilla si „ndotësi paguan” ose „përdoruesi paguan”;

Përdorimi i teknikave dhe metodave më të mira për mbrojtjen e mjedisit;

Përdorimi i teknologjisë më të mirë të disponueshme bazuar në ndikimin minimal, ndërtimin pa ndotje dhe përgatitjen e sheshit;

Informimi i publikut, përfshirja e komunitetit në vendimmarrje dhe akses i publikut në informacion; dhe bashkëpunim ndërkombëtar.

Në kuadër të hartimit të PZHK-së, parimet e mësipërme përkthehen në përparësitë e mëposhtme (siç janë paraqitur edhe në këtë material):

Densifikimi përpara shtrirjes – kjo ka për qëllim përdorimin e tokës në vendbanime në mënyrë më efektive dhe ngadalësimin e shpërndarjes së disa vendbanimeve përtej kufijve të planifikuar;

Strukturimi dhe ristrukturimi i zhvillimit koherent të vendbanimeve – kjo synon kryesisht të krijojë një përdorim më efektiv të tokës;

Krijimi i rrugëve të reja brenda strukturës së vendbanimeve – akses i nëpër vendbanime dhe komuna fqinje është një faktor madhor për udhëheqjen e zhvillimit;

Rehabilitimi i tokës bujqësore;

Rizhvillimi i pyjeve ekzistuese, pyllëzime të reja;

Ruajtja e trashëgimisë kulturore – historike dhe natyrore;

Ruajtja e shumëllojshmërisë së aktiviteteve dhe përdorimeve nëpër vendbanime;

Zgjerimi i zonave të banimit atje ku kushtet janë të favorshme.

### **Qëllimet strategjike**

Sipas rëndësisë së tyre, objektivat mund të ndahen në objektiva globale dhe në objektiva të nivelit lokal.

Objektivat kryesorë të shqyrtimit të gjerë që lidhen me këtë plan mund të jetë i definuar si:

Zhvillimi i përmirësuar, ku të gjithë aktorët kanë të drejtën për informim, të dëgjohen, të ndikojnë dhe të jenë pjesë e vendimmarrjes, me ndikim në jetën dhe të ardhmen e tyre. Një nga qëllimet globale është se gjatë zhvillimit dhe implementimit të këtij dokumenti ne kemi pjesëmarrje të cilësisë;

Zhvillimi i qëndrueshëm, i shpejtë e intensiv dhe ndryshimet në strukturën socio-ekonomike, përfshijnë zhvillimin e barabartë në kuadër të komunës;

Për të krijuar kushte për një rritje të përhershme në punësim, zhdukjen e varfërisë, luftimin e sëmundjeve, përmirësimin e shëndetit dhe reduktimin e vdekshmërisë së fëmijëve në bazë të standardeve që do të ofrojnë qëllimet themelore të ndryshimit në strukturën sociale-ekonomike, zhvillimi dinamik i ekonomisë dhe nivelit të jetës dhe forcimin e rolit të sektorit privat në socio-zhvillimin ekonomik;

Rritja e vazhdueshme e sigurisë në të gjitha dimensionet (krijimi i sigurisë për edukim themelor, siguri sociale dhe fizike, siguri të mjedisit etj.);

### **Zhvillimi i partneritetit global për zhvillim.**

Qëllimet strategjike të mësipërme synojnë të sigurojnë pjesëmarrje të përfshirë dhe të drejtën për informim për të gjithë aktorët e interesuar, duke i lejuar ata të ndikojnë në procesin e vendimmarrjes dhe të kenë rol aktiv në përcaktimin e të ardhmes së tyre. Fokus në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe ndryshime në strukturën sociale dhe ekonomike, duke përfshirë zhvillimin e barabartë në nivel komunal për të siguruar të ardhme të qëndrueshme dhe të drejtë për të gjithë banorët.

Qëllimet hartohen në përpjekje për të krijuar kushte për përmbushjen e nevojave themelore duke garantuar qasje të barabartë në shërbimet dhe burimet e nevojshme. Gjithashtu ato ofrojnë përpjekje për sigurimin e arsimit bazë, sigurinë sociale dhe fizike si dhe sigurinë e mjedisit për të garantuar një mjedis të qetë dhe të sigurt.

PZHK parashikon një qasje integrale për zhvillimin e komunës si tërësi, duke përfshirë vendbanimet, lagjet dhe zonat e vogla të banimit brenda kufinjve të komunës. Si një dokument planifikimi, PZHK përcakton kufinjte, kriteret, intensitetet, densitetet dhe standardet e nevojshme për të gjithë territorin e komunës, pas analizës dhe identifikimit të nevojave dhe karakteristikave të secilit prej vendbanimeve.

Duke qenë se PZHK fokusohet në përcaktimin e një strategjie të përgjithshme dhe standardeve të përbashkëta për zhvillim në tërësinë e komunës, në këtë pikë, hartohen Planet Rregulluese të Hollësishme, të cilat specifikojnë detajet e nevojshme për secilën zonë banimi, udhëzime dhe rregulla të detajuara për përdorimin e tokës, intensitetin e ndërtimit, karakteristikat arkitektonike dhe aspekte të tjera e nevojshme për zhvillimin e planifikuar të zonave të banimit. PZHK synon të përmbushë konceptin e menaxhimit të pronës në një mënyrë të drejtë dhe të barabartë për të gjithë pronarët, pa dallim, përfshirë këtu zonat e reja të ndërtimit, zonat industriale dhe të gjelbra, dhe të gjitha aspektet e zhvillimit të infrastrukturës. Megjithatë, në analizën tonë, sfiduese është mungesa e specifikimeve të detajuara për këto zona, duke përfshirë ndikimin e tyre në korridoret e qarkullimit të shtazëve dhe ekosistemet natyrore. Nëse janë marrë masa për të siguruar qarkullim natyror të shtazëve dhe mbrojtjen e llojeve bimore nga një habitat në tjetrin, si dhe për të adresuar pyllëzimin, rypyllëzimin, dhe krijimin e hapësirave të gjelbra dhe të zonave rekreative.

Si konkludim, për përmbushjen e qëllimeve strategjike të përcaktuara, duhen zbatuar parime dhe modele zhvillimore të pranura gjerësisht, duke u përqendruar në qasjen policentrike, ashtu siç edhe propozohet zhvillimi i ardhshëm i Prizrenit. Ky model planifikimi, ndihmon në përmirësimin e efikasitetit dhe

efektivitetit të shërbimeve komunale, duke u fokusuar në përdorimin e burimeve në një mënyrë më të zgjuar dhe të koordinuar. Përveç kësaj, qasja policentrike ulë koston e infrastrukturës dhe e bën aksesin më të lehtë për banorët në shërbimet e tyre rutinë. Gjithashtu, kjo qasje promovon përdorimin e mjeteve alternative të transportit, duke reduktuar ndotjen dhe ndikimin e trafikut në mjedis. Modeli i propozuar për zhvillimin e ardhshëm të Prizrenit përbën një shembull konkret të përdorimit të kësaj qasjeje në praktikë, duke demonstruar suksesin dhe avantazhet e një planifikimi urban të përqendruar dhe të integruar.

Në mënyrë të përmbledhur objektivat për mbrojtjen e mjedisit në kuader të planit mund të përmbledhen si më poshtë:

Reduktimi i sasisë së mbeturinave dhe manaxhimi i integruar i tyre;

Transformimi i komunës në një hapsirë të qëndrueshme, të sigurtë dhe të mirqenë;

Identifikimi dhe krijimi i habitateve të reja, dhe korridoreve të gjelbër;

Përmirësimi i cilësisë së ajrit, përfshirë reduktimin e zhurmave;

Kursimi i energjisë dhe reduktimi i emisioneve të gazrave serrë;

Cilësia e ujërave sipërfaqësore në përputhje me kërkesat e legjislacionit të Kosovës dhe Direktivës Kornizë për Ujërat nga BE;

Reduktimi i intensitetit të trafikut nëpërmjet promovimit të transportit publik, këmbësor dhe qarkullimit me biçikleta;

Shtimi dhe mbrojtja e vlerave kulturore, përfshirë ato arkeologjike dhe arkitekturore;

Mbrojtja e mjedisit natyror në zonat pyjore dhe malore;

#### **Pikat e forta të strategjisë së zhvillimit**

Në qendër të strategjisë është një ndryshim në fokusin e zhvillimit të komunës, i cili merr parasysh përveç zhvillimit ekonomik, edhe aspekte tjera të zhvillimit si organizimin e territorit, zhvillimin e qëndrueshëm, identitetin kulturor dhe proceset demokratike. Plani përcakton strategji të qarta dhe të lidhura me plane konkrete veprimi për të siguruar zbatim të qëndrueshëm të planit. Gjithashtu inkurajon një përfshirje të gjerë të palëve të interesuara dhe përdor proces të hapur dhe të përfshirë gjatë konsultimeve publike, ku identifikon sfidat që ndeshet komuniteti dhe metodat për t'u përgjigjur këtyre sfidave si dhe mbështet dhe strukturon dialogun ndërmjet palëve dhe ndihmon në gjetjen e zgjidhjeve të bazuara në konsensus. Strategjia e planifikimit do të funksionojë si një mjet kyç për menaxhimin e ndryshimeve, duke ndihmuar në përcaktimin e përparësive kryesore dhe përmirësimin e kapaciteteve institucionale dhe vendimmarrëse. Në lidhje me nevojën për rritjen dhe zgjerimin e shërbimeve, plani:

Ndihmon në gjetjen e zgjidhjeve dhe integrimin e vendbanimeve formale dhe joformale në një sistem të unifikuar dhe funksional;

Identifikon nevojat për shërbime dhe burimet e nevojshme për ofrimin e tyre;

Integron aspektet sociale, mjedisore, ekonomike, institucionale dhe kulturore;

Njeh pasuri të prekshme dhe të paprekshme kulturore që i shtojnë vlerën e cilësisë së jetës;

Nxit krijimtarinë dhe shfrytëzon potencialin për tendenca të reja zhvillimore;

Vendos çështjet mjedisore në qendër të zhvillimit të qëndrueshëm urban;

Shërben si platformë për zhvillimin e koncepteve dhe modeleve inovative të qëndrueshme në fushat e strehimit, energjisë dhe transportit;

Ofron instrumente fleksibile që u mundësojnë autoriteteve përgjigje të shpejtë dhe efikase ndaj fatkeqësive natyrore të mundshme.

### **Përmirësimi i mjedisit, cilësisë së shërbimeve dhe efijencës së energjisë**

Në strategjitë zhvillimore të së kaluarës, çështjet mjedisore shpesh janë trajtuar si elementë dytësorë, pa u dhënë rëndësinë e duhur që meritojnë sot. Në këtë kontekst, vlerësimi strategjik mjedisor synon të analizojë nëse strategjia e planifikimit merr në konsideratë ndikimet e zhvillimit urban dhe konsumit, përtej kufijve administrativ të zonës urbane. Ky vlerësim fokusohet në minimizimin e ndikimeve negative mbi pyjet, ujërat sipërfaqësore, biodiversitetin dhe ndryshimet klimatike, duke promovuar një qasje gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme. Për të përmirësuar performancën mjedisore të planit, është thelbësore që të trajtohen në mënyrë të veçantë tri fusha prioritare, përmes të cilave do të ndërtohen strategji të mirëfillta:

Mbrojtja dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore dhe ekosistemeve;

Zhvillimi i infrastrukturës së qëndrueshme dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve publike;

Rritja e efijencës së energjisë dhe promovimi i burimeve të ripërtëritshme të energjisë.

Ndotja e mjedisit në përgjithësi përkeqësohet me industrializimin dhe shpesh është në nivelin e tij më të keq gjatë fazave të hershme të industrializimit. Kushtet e mjedisit përmirësohen si pasojë e iniciativave të ndërmara në përgjigje të kërkesave të qytetarëve. Rritja në mënyrë masive e qarkullimit rrugor, burimi kryesor i ndotjes së arjit në qytet, po ndodh gjithnjë e më shumë në fazën e hershme të trajektorës së zhvillimit. Duke qenë se deri në vitin 2032, Prizreni ka tendencë të ketë një bilanc pozitiv të popullsisë, dhe kjo ndikon në trajektoren e urbanizimit, strategjia duhet theksuar nevojat bazë për burime njerëzore dhe kapital për ofrimin e shërbimeve elementare. Gjithashtu konsumi i energjisë për banorë ka tendencë të rritet, gjë që, me aplikimin e politikave proaktive që inkurajojnë efijencën e energjisë, konsumi i energjisë pritet të ketë rënie.

Lidhur me këto tri fusha, me theks të veçantë në cilësinë e mjedisit, përcaktohen kritere të qarta dhe të domosdoshme që duhet të respektohen për të siguruar ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit në komunë.

### **Kritere të forta mjedisore**

Këto kritere përcaktojnë zonat që do të përjashtohen nga zhvillimi komunal, të ndara në tre kategori kryesore: (i) zona me vlera të veçanta mjedisore (psh. zonat e mbrojtura të natyrës), (ii) zona të rrezikshme për zhvillim, dhe (iii) zona të ndotura të njohura si “hot-spote” mjedisore.

(I) Zonat me vlera të veçanta mjedisore përfshijnë:

Rezervatet natyrore dhe parqët kombëtarë;

Zonat e mbrojtura për biodiversitetin, si habitatet e florës dhe faunës së rrallë dhe të mbrojtur; Pyjet e mbrojtura dhe zonat e gjelbra të rëndësisë ekologjike;

Lumenjtë, liqenet dhe zonat e mbrojtura ujore;  
Zonat e rëndësishme për ruajtjen e tokave bujqësore me vlera ekologjike;

Pasuritë kulturore natyrore që kontribuojnë në identitetin dhe cilësinë e mjedisit jetësor.

Parku Nacional “Mali Sharr” përfaqëson një nga zonat më të rëndësishme natyrore në Kosovë, i karakterizuar nga biodiversiteti i pasur, peizazhe të rralla malore dhe burime të shumta ujore. Ky park mbulon një sipërfaqe të konsiderueshme me ekosisteme të ndjeshme, të cilat janë jetike për ruajtjen e specieve të rrezikuara dhe për ofrimin e shërbimeve mjedisore për komunitetet përreth.

Për shkak të këtyre vlerave të veçanta ekologjike, menaxhimi dhe zhvillimi në këtë zonë duhet të jetë në përputhje me parimet e mbrojtjes së natyrës dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Zonat që përfshihen në kuadër të parkut janë të kategorizuara sipas ndjeshmërisë mjedisore dhe rrezikut nga ndërhyrjet njerëzore. Në këtë kontekst, ndërtimet e reja dhe aktivitetet zhvillimore janë të kufizuara ose të ndaluara në zona të caktuara për të shmangur dëmet në natyrë dhe për të parandaluar rreziqe të mundshme natyrore.

Nuk lejohen ndërtimet në zonat e mësipërme që bartin vlera të veçanta mjedisore.

(II) Zonat e rrezikshme për zhvillim përfshijnë:

Shtretërit e lumenjve dhe zonat buferike rreth tyre

Basenet nëntokësore ujëmbajtëse;

Toka bujqësore me potencial të lartë;

Zonat me pjerrësi më të madhe së 15 apo 20%.

Nuk lejohen ndërtimet në (apo pranë) shtretërve të lumenjve pasi ndërtimet mund të jenë në zonën e përmytjeve (qoftë dhe shumë të rralla), mund të shkaktojnë erozion të brigjeve, si dhe të cenojnë regjimin hidrologjik të sistemit ujor.

Tokat bujqësore janë të rëndësishme për prodhimin bujqësor dhe si të tilla, ndërhyrjet e paplanifikuara dhe praktikat bujqësore jo-të qëndrueshme rrezikojnë të shkaktojnë ndotje të rënda të burimeve ujore nëntokësore dhe degradimin e tokës.

Në mënyrë të ngjashme, nuk lejohen ndërtimet në zonat me pjerrësi të madhe pasi në mjedise argjilore këto ndërtime mund të shkaktojnë (ose përkeqesojnë) situatë erozive të kodrave dhe janë një rrezik publik i përhershëm. Plani përmban “hartën e planifikuar për mbrojtjen nga rreziqet natyrore”.

(III) Zona të ndotura të njohura si “hot-spote” mjedisore përfshijnë:

Zona industriale me ndotje të lartë të ajrit, tokës ose ujërave sipërfaqësore;

Vendndodhjet e deponive ilegale ose të menaxhuara në mënyrë jo adekuate të mbeturinave;

Hekurudha, autostrada apo zonat me trafik të lartë që shkaktojnë ndotje akustike dhe atmosferike;

Zona të prekura nga ndotja kimike ose toksike për shkak të aktivitetit të mëparshëm industrial apo bujqësor;

Burimet e ndotjes së ujit, përfshirë pikat e derdhjes së ujërave të zeza të patrajtuara.

### Deponitë e egra

Përgjatë lumenjve përbëjnë një nga problemet më të mëdha mjedisore në shumë rajone, përfshirë edhe zonat e mbrojtura si Parku Nacional "Mali Sharr". Hedhja e mbeturinave urbane, inerteve ndërtimore dhe mbetjeve industriale në afërsi të shtretërve të lumenjve jo vetëm që ndot ujin dhe tokën, por rrezikon seriozisht edhe ekosistemet ujore dhe shëndetin e komuniteteve lokale.

Këto deponi të pakontrolluara kontribuojnë në ndotjen e burimeve ujore nëntokësore, pengojnë rrjedhjen natyrore të ujit, shtojnë rrezikun nga përmytjet dhe mund të çojnë në përhapjen e sëmundjeve infektive, sidomos gjatë reshjeve intensive kur mbeturinat shpërndahen nëpër terren.

Për të adresuar këtë problem, është e domosdoshme ndërhyrja urgjente për largimin e tyre, vendosja e kamerave mbikëqyrëse në pika kritike, ndëshkime për ndotësit dhe ngritje e vetëdijes qytetare për ruajtjen e lumenjve si burime jetike për jetën dhe biodiversitetin.

## VIII. NDIKIMET E MUNDSHME MJEDISORE DHE MASAT PËR ZBUTJEN E TYRE

### Metodologjia për përcaktimin e shkallës së ndikimeve

Për parashikimin e karakteristikave të shkallës së ndikimeve, janë përdorur metoda të ndryshme, duke përfshirë vëzhgimet e thjeshta, ilustrime fizike, informacione sasiore, etj. Identifikimi i ndikimeve mjedisore është zhvilluar përmes metodave që përfshijnë listat e kontrollit, matricat, rrjetet dhe diagrama, GIS dhe gjykime profesionale.

Para përshkrimit të ndikimeve në mjedis, janë analizuar të gjitha zhvillimet e planifikuara sipas planit. Gjatë hartimit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Planit Zhvillimor Komunal të Prizrenit, me theks të veçantë janë përfshirë këta komponentë mjedisorë:

| Identifikimi i efekteve/ndryshimeve për elementet e mëposhtme: |              |                                                                                      |
|----------------------------------------------------------------|--------------|--------------------------------------------------------------------------------------|
| Uji                                                            | Sipërfaqësor | Shkarkime të substancave toksike, inorganike, organike, etj                          |
|                                                                | Nëntokësor   | Filtrime drejt ujërave nëntokësore                                                   |
| Ajri                                                           |              | Emetimet në ajër që ndikojnë në cilësinë e ajrit                                     |
| Klima                                                          |              | Emetimet e gazrave me efekt serra                                                    |
| Toka                                                           |              | Erozioni dhe sedimentimi                                                             |
| Zhurmat                                                        |              | Emetimet e mundshme të zhurmës                                                       |
| Flora, fauna, habitat                                          |              | Ndikimet e zhvillimeve të propozuara mbi florën, faunën dhe rregullimin e habitateve |
| Peizazhi                                                       |              |                                                                                      |

|                                                   |                                                                                         |
|---------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------|
|                                                   | Ndryshime thelbësore të formës së përdorimit të tokës p.sh. shpyllëzim, urbanizim, etj. |
| <b>Mbeturinat</b>                                 | Deponimi, djegia dhe riciklimi                                                          |
| <b>Vlera të trashëgimisë natyrore e kulturore</b> | Asete të cilat mund të dëmtohen nga aktivitetet e propozuara                            |

*Tabela 10 Komponentët mjedisore të parapara në raportin e VSM*

Vlerësimi i ndikimeve mjedisore të Planit Zhvillimor Komunal për Prizrenin është realizuar në përputhje me qasjet e rekomanduara ndërkombëtarisht për vlerësimin strategjik mjedisor. Për të arritur këtë, është përdorur një metodologji që synon të identifikojë, analizojë, dhe vlerësojë ndikimet e mundshme mjedisore të zhvillimeve të propozuara në plan.

#### **Përcaktimi i Indikatorëve dhe Kriteret e Vlerësimit**

Indikatorët mjedisorë janë përcaktuar për të vlerësuar ndikimet e ndryshme të zhvillimeve të planifikuara në tokë, ujë, ajër, biodiversitet, klimë, mbeturina, zhurmë, peizazh, dhe trashëgimi kulturore. Për secilin indikatorë, janë përdorur kriteret e vlerësimit si mëposhtë:

**A** – Pa ndikim/ndikim pozitiv: Zhvillimet e planifikuara nuk kanë ndikim negativ ose kontribuojnë pozitivisht ndaj qëllimeve mjedisore.

**B** – Ndikim i parëndësishëm: Ndikimet janë të vogla dhe nuk pritët të kenë efekte të ndjeshme afatgjate.

**C** – Ndikimi bëhet i parëndësishëm për shkak të zbatimit të masave zbutëse: Ndikimet potencialisht negative mund të zbuten efektivisht përmes zbatimit të masave të përshtatshme.

**D** – Ndikim i rëndësishëm: Ndikimet janë të mëdha dhe mund të kenë efekte të konsiderueshme negative mjedisore që kërkojnë veprime të mëtejshme për menaxhimin e tyre.

**E** – Ndikim shkatërrues: Ndikimet janë aq të mëdha sa që mund të dëmtojnë seriozisht mjedisin ose të çenojnë qëndrueshmërinë e zonave të caktuara.

**X** – Vlerësimi i ndikimit nuk është i mundur: Nuk ka mjaftueshëm të dhëna për të bërë një vlerësim të qartë ose ndikimi është shumë kompleks për të vlerësuar në këtë fazë.

| Indikatori | Zhvillimi i planifikuar                        | Përshkrimi i ndikimit                                                                                                                  | Shkalla e vlerësimit |                                                                          |
|------------|------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------|--------------------------------------------------------------------------|
| <b>Uji</b> | Infrastruktura e ujësjellësit dhe kanalizimeve | Ndërtimi dhe zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit do të përmirësojë cilësinë e ujit dhe menaxhimin e ujërave të ndotura. | A/B                  | Rritja e efikasitetit dhe sigurisë së furnizimit me ujë për përdoruesit. |

|                              |                                                                                 |                                                                                                                          |     |                                                                                                                                                                          |
|------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Ajri</b>                  | Infrastruktura dhe industrializimi                                              | Emisionet e ndotësve nga ndërtimi dhe operacionet industriale.                                                           | D/E | Ndërhyrje për reduktimin e emisioneve dhe zbatimi i teknologjive më të pastërta.                                                                                         |
| <b>Klima</b>                 | Përshtatje e infrastrukturës për të përballuar ngjarje ekstreme meteorologjike  | Përmirësimi i kapaciteteve të komunitetit për të menaxhuar ndryshimet klimatike.                                         | B/C | Zbatimi i masave për përshtatje dhe zbutje të ndryshimeve klimatike.                                                                                                     |
| <b>Toka</b>                  | Zhvillimi urban dhe rural, përfshirë zonat e reja rezidenciale dhe industriale. | Ndikimi në përdorimin e tokës për banim, industri dhe bujqësi. Intensifikimi i ndërtimit dhe zonat e reja të zhvillimit. | C/D | Potencial për fragmentimin e habitateve dhe ndryshimin e peizazhit natyror. Përdorimi i tokës në mënyrë të qëndrueshme dhe efikase.                                      |
| <b>Zhurmat</b>               | Aktivitetet e ndërtimit dhe operacionale                                        | Ndotja akustike që rrjedh nga ndërtimi dhe operacionet e mëdha industriale.                                              | D   | Implementimi i masave për zbutjen e niveleve shqetësuese të zhurmës përmes dizajnit dhe teknikave të ndërtimit.                                                          |
| <b>Flora, fauna, habitat</b> | Ruajtja dhe zhvillimi i zonave të gjelbra dhe zonave rurale                     | Ruajtja e biodiversitetit përmes menaxhimit të qëndrueshëm të zonave të gjelbra dhe rurale.                              | A/B | Mbrojtja e specieve dhe habitateve natyrore, integrimi i masave të ruajtjes në planifikimin e zhvillimit. Masa mbrojtëse dhe kompensuese për ruajtjen e biodiversitetit. |
| <b>Peizazhi</b>              | Urbanizimi dhe zgjerimi i zonave industriale.                                   | Ndikimi i urbanizimit dhe zgjerimit industrial në peizazhet natyrore.                                                    | B/D | Planifikimi i hollësishëm për të minimizuar ndikimin vizual dhe ekologjik.                                                                                               |

|                                         |                                                                              |                                                                                        |     |                                                                                                    |
|-----------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------|-----|----------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Mbeturinat</b>                       | Sistem i qëndrueshëm i menaxhimit të mbeturinave                             | Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të mbeturinave dhe infrastrukturës së riciklimit. | A/B | Ndarja në burim, përmirësimi i sistemit të reciklimit dhe trajtimit të duhur të mbeturinave.       |
| <b>Trashëgimia natyrore e kulturore</b> | Ruajtja dhe promovimi i aseteve kulturore në zonat e ndikuar nga zhvillimet. | Mbrojtja e aseteve kulturore nga ndikimet negative të zhvillimit.                      | A/B | Implementimi i strategjive për mbrojtjen dhe integrimin e vlerave kulturore në planifikimin urban. |

Tabela 11 Analiza e shkallës së ndikimit në komponentët mjedisore

Tabela 11 përdor indikatorë dhe kriteret e vlerësimit të përcaktuar për të përshkruar se aspekti i zhvillimeve të propozuara mund të ndikojë në mjedis, dhe si mund të menaxhohen këto ndikime përmes zbatimit të masave të përshtatshme zbutëse.

Sipas këtyre rezultateve, shihet që ndikimet pozitive mbizotërojnë në shumicën e komponentëve mjedisorë. Ndikimet më pozitive janë në komponentët e ujit, florës dhe faunës, mbeturinave dhe trashëgimisë natyrore dhe kulturore. Megjithatë, ka edhe ndikime të rëndësishme negative, veçanërisht në komponentën e ajrit. Kjo tregon që strategjitë e mitigimit dhe zbutjes duhet të synojnë përmirësimin e menaxhimit të ajrit dhe ndotjes që ai pëson.

### Efektet kumulative

Efektet kumulative përfaqësojnë ndikimet e përbashkëta dhe afatgjata që aktivitetet dhe projektet e planifikuara në kuadër të PZHK-së së Prizrenit mund të kenë në mjedis dhe shoqëri. Ndërsa ndikimet e veçuara nga projektet individuale mund të duken minimale, ndërveprimet midis tyre, së bashku me presionin ekzistues mbi mjedisin, mund të çojnë në degradim të cilësisë së ajrit, ujit, tokës dhe elementeve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

Në këtë kuptim, është e rëndësishme të merren parasysh efektet e kombinuara që mund të vijnë nga zhvillimi urban, turizmi, ndërtimi i infrastrukturës dhe sektorët ekonomikë që prekin biodiversitetin, burimet natyrore dhe cilësinë e jetesës. Për analizën e efekteve kumulative janë marrë në konsideratë prioritetet strategjike të PZHK-së së Prizrenit dhe ndikimi i tyre në elementet kyç të mjedisit.

| Elementet që vlerësohen          | Zhvillimi i infrastrukturës së transportit | Zhvillimi urban dhe zgjerimi i zonave industriale | Menaxhimi dhe përmirësimi i shërbimeve të publike dhe sociale | Ruajtja e biodiversitetit dhe zonave të mbrojtura | Projektet e ndërtimit dhe zgjerimit të infrastrukturës publike | Zhvillimi i sektorit të bujqësisë dhe pylltarisë | Promovimi dhe ruajtja e aseteve kulturore dhe natyrore |
|----------------------------------|--------------------------------------------|---------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------|--------------------------------------------------------|
| Uji                              | C                                          | C                                                 | B                                                             | A                                                 | C                                                              | B                                                | A                                                      |
| Ajri                             | D                                          | D                                                 | B                                                             | A                                                 | D                                                              | C                                                | B                                                      |
| Klima                            | D                                          | C                                                 | C                                                             | A                                                 | D                                                              | C                                                | B                                                      |
| Toka                             | D                                          | D                                                 | B                                                             | A                                                 | D                                                              | C                                                | B                                                      |
| Zhurma                           | D                                          | D                                                 | B                                                             | A                                                 | C                                                              | B                                                | A                                                      |
| Flora/Fauna                      | C                                          | C                                                 | B                                                             | A                                                 | C                                                              | B                                                | A                                                      |
| Mbeturinat                       | C                                          | B                                                 | B                                                             | A                                                 | B                                                              | B                                                | B                                                      |
| Trashëgimia natyrore e kulturore | B                                          | A                                                 | A                                                             | A                                                 | B                                                              | A                                                | A                                                      |

**Shpjegimi i shkallës së ndikimit:**

A – Ndikim i ulët pozitiv ose minimal

B – Ndikim i moderuar

C – Ndikim i lartë

D – Ndikim shumë i lartë negativ

*Tabela 12 Analizë matricore e efekteve kumulative të elementeve të PZHK-së*

## IX. MASAT E NEVOJSHME PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

### Konceptet zhvillimore të përdorimit të tokës, qasja policentrike

Në analizën e vendbanimeve është vërejtur se në Prizren, si në çdo vendbanim tjetër në Kosovë, kemi problem me shtrirjen disperse (objekte të shpërndara) të ndërtimeve, të cilat më tej paraqesin probleme në ofrimin e infrastrukturës dhe elementeve të tjera urbane. Cilësohet si problem me përmasa serioze zgjerimi i tokës ndërtimore në mënyrë spontane, pastaj shtrirja e ndërtimeve në tokat bujqësore.

Qasja policentrike kërkon ndërtimin e infrastrukturës shtesë dhe shërbimeve në zonat e reja, krijimin e qendrave të reja të komunitetit bashkë me zonat e gjelbra, hapësira të mjaftueshme publike dhe ofrimin e aksesit në shërbime dhe transport. Harta e shfrytëzimit të planifikuar të tokës tregon destinimin e përdorimit të tokës deri më 2032, ku përcakton gjithashtu kufinj të ndërtimor dhe zhvillime të tjera, me ç'rast ndalohen zgjerimet në zonat e gjelbërta dhe peizazhet me interes të veçantë ekologjik dhe të

biodiversitetit. Në raste të jashtëzakonshme, kur hapësira të caktuara preken nga zhvillimet e nevojshme, është shumë e rëndësishme rikompensimi përmes krijimit të parqeve të reja dhe hapësirave rekreative në zona të tjera. Zgjerimet e planifikuara prekin zonat rurale dhe humbjen e mëtejshme të tokës bujqësore, por njëkohësisht sigurojnë ruajtjen e pjesës së konsiderueshme të tokës pjellore, tokës së pasur me resurse dhe zonave pyjore. Gjithashtu ato janë potencial i fragmentimit të habitateve dhe ndryshimeve në peizazhin natyror, për të cilin qëllim planifikimi i parqeve të reja, korridoreve të gjelbra dhe zonave të tjera rekreative siguron habitatet për botën e gjallë dhe njëkohësisht garanton qasje të barabartë në hapësira të hapura publike për banorët e komunës.

Konceptet e zgjerimit të vendbanimeve mundësojnë shfrytëzim racional të tokës, rritje të dendësisë së banimit, e cila do të arrihet edhe me shfrytëzimin racional të zbrazëtirave brenda zonave të ndërtuara, që rrjedhimisht do të ndikonte në zhvillimin e infrastrukturës, uljen e kostos për investime në infrastrukturë, si dhe qasjen më të lehtë të banorëve në këtë sistem, ndërsa në anën tjetër do të zvogëlon rrezet e shërbimeve tjera si: shkolla, institucione shëndetësore, administratë etj. Zhvillimi kompakt i paraparë për vendbanime do të kursej tokën nga ndërtimet e pa kontrolluara, ndërsa në këtë kontekst vendbanimet shndërrohen në zona funksionale, ku duhet vepruar në konsolidimin e infrastrukturës ekzistuese dhe ndërtimin e asaj që mungon.

### **Ndryshimet në klimë**

Masat e përfshira në VSM për adresimin e sfidave që lidhen me ndryshimin e klimës dhe ndotjen e ajrit, uljen e pasigurive në këto çështje, përfshijnë masa drejt përmirësimit të informacionit (shkencor, ekonomik dhe social), parashikimin e veçorive të ndryshme të atmosferës dhe ekosistemeve të prekura si dhe ndikimet shëndetësore dhe ndërveprimet e tyre me faktorët socio-ekonomikë.

Shqetësimi për ndryshimin e klimës, ndotjen e ajrit, ka sjellë kërkesa për informacion shkencor, ekonomik dhe social për të reduktuar pasiguritë në këto fusha. Qeverisja lokale, në bashkëpunim me organe përkatëse, organizata ndërqeveritare dhe joqeveritare apo edhe sektori privat, duhen nxitur hulumtimin në proceset natyrore që ndikojnë dhe ndikohen nga atmosfera, duke studiuar lidhjet midis zhvillimit të qëndrueshëm dhe ndryshimeve të atmosferës. Bashkëpunimet janë të nevojshme për të zhvilluar sistemet e zbulimit të hershëm të ndryshimeve dhe eventeve potenciale dhe parashikimin e ndryshimeve për vlerësimin e dëmeve mjedisore, sociale dhe ekonomike që ato mund të shkaktojnë.

Janë të nevojshme hulumtimet në zhvillimin e metodologjive për identifikimin e niveleve të pragut të ndotësve atmosferikë dhe përqendrimet e gazrave serrë, të cilat do të trajtohen tek seksioni i cilësisë së ajrit.

### **Cilësia e ajrit**

Në Planin Zhvillimor Komunal, cilësia e ajrit trajtohen me një analizë gjithëpërfshirëse me synimin të identifikojë burimet kryesore të ndotjes. Kjo rritje ka qenë më e theksuar gjatë muajve të ftohtë, si rezultat i djegies së lëndëve djegëse për ngrohje (dru, qymyr, mazut), trafikut të rënduar urban dhe ndërrurban dhe kushtet meteorologjike të pafavorshme që pengojnë shpërndarjen e ndotësve. Sipas të dhënave të grumbulluara nga stacioni Prishtinë-IHMK, nivelet e **PM10 dhe NO<sub>2</sub>** shpesh tejkalojnë pragjet e përcaktuara nga legjislacioni për mbrojtjen e shëndetit publik dhe vegjetacionit.

Në mungesë të stacioneve aktive në territorin e Prizrenit, duhet theksuar nevoja për instalimin e infrastrukturës lokale të monitorimit të cilësisë së ajrit, për të pasur një bazë të dhënash të sakta dhe marrjen e masave të nevojshme bazuar në informacion më të besueshëm. Vendosjen e stacioneve automatike të matjes së cilësisë së ajrit në lokacione kyçe (p.sh., zona industriale, qendra e qytetit, pika

me trafik të dendur si Ortakoll, Shatërvan, rruga “Tirana”), aktivitetet ndërtimore dhe industriale në zonën e Landovicës, periferitë dhe deponitë e hapura të mbeturiave dhe djegia e tyre në mënyrë të paautorizuar. Përdorimin e të dhënave reale për të gjurmuar burimet e ndotjes, të matë efektin e masave të marra dhe të orientojë politikatat mjedisore të komunës.

Ndotës specifikë si PM10, PM2.5 shpesh tejkalojnë standardet e përcaktuara në periudha të caktuara, sidomos gjatë muajve të ftohtë kur kushtet meteorologjike janë të pafavorshme për shpërndarjen e ndotësve dhe rritjen e emetimeve nga djegia e lëndëve djegëse për ngrohje. Për të adresuar atë që është thënë më lartë, lidhur me përmirësimin e informacionit, sa i përket cilësisë së ajrit, zhvillimi i një studimi të veçantë për identifikimin e burimeve të grimcave PM është një hap drejt një strategjie efektive të menaxhimit të cilësisë së ajrit. Ky studim duhet të përfshijë analiza të thelluara që do të ndihmojnë në përcaktimin e origjinës së ndotësve kryesorë si grimcat PM10 dhe PM2.5. Rezultatet e këtij studimi do të jenë thelbësore për hartimin e rregulloreve të reja që synojnë të kontrollojnë dhe minimizojnë emetimet e këtyre ndotësve në mjedis.

### **Përfitimet nga hapësirat e gjelbra urbane**

Hapësirat e gjelbra urbane përbëjnë një ndër elementet themelore për zhvillimin e qëndrueshëm urban dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve. Në kontekstin e qytetit të Prizrenit, i cili përballet me rritje urbane, ndotje të ajrit dhe mungesë të balancës ekologjike, investimi dhe menaxhimi i duhur i hapësirave të gjelbra sjell përfitime të shumëfishta mjedisore, shëndetësore, sociale dhe ekonomike.

**Përfitime ekonomike:** Rritje e vlerës së pronës dhe truallit, ulje e kostos së energjisë (ngrohje-ventilim); Nxitje e turizmit, hapësira të gjelbra urbane rrisin atraktivitetin e qytetit për turistët

**Përfitime mjedisore:** Përmirësim i cilësisë së ajrit, reduktimi i rrjedhës sipërfaqësore të reshjeve, erozionit të tokës, përmirësimi i cilësisë së ujit, mbrojtja dhe krijimi i habitateve për botën e gjallë, krijimi i buffer zonave (zonave mbrojtëse), reduktim i niveleve të zhurmës, absorbimi i ndotësve të ajrit, rritja e biodiversitetit urban siguron habitat, ushqim dhe mbrojtjen e bimëve dhe kafshëve, etj.;

**Përfitime sociale:** Përmirësojnë shëndetin fizik dhe mendor; rritje e mundësive për rekreacion; mundësi për aktivitet fizik, çiklizëm, vrapim, shëtitje, etj., zbutja e sëmundjeve respiratore, ndikojnë në rritjen e ndjenjës së pronësisë, stabiliteti i lagjeve, reduktimi i niveleve të zhurmës dhe krijimi i buffer zonave, edukim i hershëm për gjeneratat e reja, etj.

### **Energjia e rinovueshme**

Pozita gjeografike e kësaj komune tregon për potencialin që e posedon në mundësinë për prodhimin e energjisë së erës, hidroenergjisë, energjisë së ripërtrishme dhe energjisë solare. Komuna e Prizrenit posedon poashtu edhe resurse të mjaftueshme ujore, ku ndërtimi i një hidrocentrali është planifikuar në rajonin e Zhurit me një kapacitet prodhues prej 250 megavat (MW). Ndalimi i përdorimit të lëndëve djegëse për ngrohje në zonat urbane dhe ngritja e një sistemi të centralizuar të ngrohjes përmes kogjenerimit janë veprime të cilat ndihmojnë në reduktimin e ndotjes së ajrit dhe ofrojnë një alternativë më të qëndrueshme dhe efikase për ngrohjen e hapësirave. Mbështetja teknike dhe ekonomike për ekonominë familjare për të kryer renovime që përfshijnë izolimin termik të objekteve do të rrisë efikasitetin energjetik dhe do të zvogëlojë konsumin e energjisë. Ofrimi i stimujve, si subvencionimet dhe uljet e taksës për përdorimin e energjisë së rinovueshme dhe instalimin e pajisjeve me efikasitet të lartë, si panelet solare, është gjithashtu një pjesë kyçe e tranzicionit energjetik. Këto stimuj do të nxisin komunitetin lokal dhe bizneset të investojnë në teknologji të gjelbërta, duke kontribuar në një mjedis më të pastër dhe më të shëndetshëm.

### **Mbrojtja e tokës**

Ndotja e tokës në Planin Zhvillimor të Komunës është trajtuar si një çështje kryesore, duke u fokusuar në sfidat dhe rreziqet mjedisore që paraqiten nga ndërtimet e paplanifikuara të vendbanimeve, industrisë (mbeturiat e ngurta, gërmimet), ndërtimit të infrastrukturës rrugore, mbeturinave shtëpiake dhe atyre ilegale, deponive, erozionit dhe nxjerrjes së pakontrolluar të zhavorrit.

Planifikimi përfshin masat për monitorimin e ndotjes, zbatimin e rregulloreve për menaxhimin e mbeturinave dhe përmirësimin e praktikave të minierave. Gjithashtu, theksohet nevoja për transparencë dhe përpjekje të shtuara për të kuptuar dhe zbutur nivelet e ndotjes. Për problemet ekzistuese të tokës propozohen masat e mëposhtme:

Implementimi i një programi të rregullt të vlerësimit të ndikimit në mjedis për të identifikuar dhe menaxhuar pasojat mjedisore të aktiviteteve minierare, përfshirë matjet e niveleve të ndotjes dhe ndikimin në ekosistemet e afërta;

Zbatimi i projekteve të restaurimit që përshtaten me standardet mjedisore për të rikthyer dhe përmirësuar cilësinë e tokës në zonat e prekura nga minierat. Këto programe fokusohen në rikthimin e biodiversitetit dhe stabilizimin e tokës për të parandaluar erozionin më tej;

Krijimi i zonave tampon për të ndarë hapësirat e minierave nga zonat e banuara dhe tokat bujqësore, të cilat do të kryejnë funksionin e barrierave për të reduktuar shpërndarjen e ndotësve dhe për të mbrojtur komunitetet dhe ekosistemet lokale;

Kufizime të qarta për llojet e veprimtarive që lejohen në afërsi të minierave. Sa i përket nevojës për monitorimin e cilësisë së tokës dhe vlerësimit të shkallës së erozionit, duhet të mirren masa për:

Përcaktimin e stacioneve të monitorimit në zona kyçe, marrjen e mostrave dhe vlerësimin e cilësisë së tokës në mënyrë të vazhdueshme;

Implementimi i programeve të vazhdueshme që monitorojnë dhe raportojnë për cilësinë e tokës;

Kryerja e studimeve të hollësishme për të vlerësuar shkallën dhe rrezikun e erozionit në stacionet e monitorimit.

### **Mbrojtja e resurseve ujore**

Ndotja e ujit është trajtuar sipas një analize të përgjithshme të problemeve dhe sfidave të cilësisë së ujit në lumenjtë e Komunës. Janë identifikuar burimet kryesore të ndotjes përfshirë këtu ujërat e zeza urbane, shkarkimet industriale dhe ujërat e minierave dhe ndikimin e tyre në cilësinë e lumenjve si Sitnica dhe Prishtevka. Janë vlerësuar nivelet e ndotësve si oksigjeni i tretur, SHBO5, azoti i nitrates, azoti i nitrates dhe fosfori, për të kuptuar pak a shumë shkallën dhe natyrën e ndotjes. Planit thekson rëndësinë e transparencës në monitorimin e cilësisë së ujit, sigurimin e qasjes në të dhëna mbi cilësinë e ujit.

Për të pasur një qasje të qëndrueshme në aspektin e menaxhimit të ndotjes dhe përmirësimin e cilësisë së resurseve ujore, VSM identifikon disa masa të cilat adresojnë shqetësimet aktuale kë këtij sektori. Me qëllim që të kemi një rrjet efikas monitorimi fiziko-kimik, duhet vendosur stacione monitorimi në pika kyçe (aty ku presionet janë më të mëdha), për matjen e parametrave të ndotjes së ujit dhe sigurimin e të dhënave periodike për analizë dhe raportim të rregullt. Në përputhje me nevojën për të mbështetur industrinë në zbatimin e teknologjive të trajtimit të ujërave të ndotura, vlerësimi i buxhetit duhet të përcaktojë një skemë të granteve të mesme dhe të vogla, si iniciativë që synon të inkurajojë investimet në teknologji që ulin ndotjen dhe përmirësojnë cilësinë e ujit.

Për një vlerësim më të thellë të gjendjes aktuale të trupave ujqorë të komunës, hartimi i një plani veprimi nga kompani konsulente ofron një vlerësim të tillë për të adresuar më pas sfidat të cilat identifikohen, rekomandimet specifike dhe vendimmarrjen në të ardhmen. Përcaktimi i zonave të mbrojtura sanitare dhe vendosja e shenjëzimeve garanton mbrojtjen e resursit ujqor nga presionet potenciale ndotëse.

Gjithashtu, duhen paraparë projektet për restaurimin dhe rregullimin e shtratit të lumenjve, mirëpo përtej masave strukturore, projektet e zgjerimit, restaurimit, etj., duhet të kenë për qëllim përmirësimin e kapacitetit natyror të lumenjve për të menaxhuar rrjedhat e ujit dhe reduktuar rrezikun nga përmbytjet, ruajtjen e ekosistemit ujqor dhe natyralizimin e shtratit dhe hapësirave përreth. Restaurimi i shtretërve dhe rigjenerimi i korridoreve lumore duke i natyralizuar ato, rrit biodiversitetin dhe mbrojtjen nga përmbytjet. Ato funksionojnë si barriera gjatë ngjarjeve të përmbytjeve duke thithur tejmbushjen e ujit pasi ndihmojnë në reduktimin e efektit në drejtim të rrymës, nëpërmjet vegjetacionit natyror. Duke vepruar kështu, specie të ndryshme bimësh dhe kafshësh gjejnë ekosisteme jetike në habitatet e restauruara, të cilat lehtësojnë biodiversitetin dhe shëndetin e ekosistemit.

Rehabilitimi dhe zgjerimi i infrastrukturës për ujësjellës dhe kanalizim do të adresojë çështjet e kapacitetit dhe do të përmirësojë efikasitetin e menaxhimit të ujërave të ndotura urbane.

#### **Reduktimi i rrezikut nga fatkeqësitë natyrore**

Në kuadër të mbrojtjes dhe minimizimit të rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe ruajtjes së mjedisit, janë identifikuar masa specifike:

Rehabilitimi i tokave të degraduara ose të kontaminuara përmes teknikave të remedimit;  
Vlerësimi i rrezikshmërisë, përcaktimi i zonave të rrezikuara bashkë me hartimin e planeve të emergjencave dhe sistemeve paralajmëruese;  
Implementimi i metodave si rivegjetimi, ndërtimi i terracave për mbrojtjen dhe stabilizimin e dheut;  
Implementimi i strukturave mbajtëse në lokacionet subjekt i rrëshqitjeve;  
Pastrime periodike të lumenjve (minimum dy herë në vit) për largimin e mbeturinave dhe aluvioneve për të garantuar rrjedhjen e lire të ujit dhe reduktuar rrishtun nga përmbytjet;  
Zbatimi i politikave dhe praktikave që ndalojnë shpyllëzimin e pakontrolluar, promovimi i teknikave të qëndrueshme të pylltarisë.

#### **Rritja e mbrojtjes, menaxhimit dhe ruajtjes së qëndrueshme të të gjitha pyjeve dhe gjelbërimi i zonave të degraduara**

Hartimi dhe zbatimi i Planit Lokal të Veprimit në Biodiversitet, i cili përcakton objektivat dhe strategjitë për ruajtjen e biodiversitetit, dhe përfshin analiza të detajuara të statusit aktual të biodiversitetit, identifikimin e specieve dhe habitateve të rrezikuara, masat për mbrojtjen e tyre. Identifikimi dhe klasifikimi i zonave të reja të natyrës të cilat kanë rëndësi ekologjike të lartë dhe të integrohen në rrjetin e zonave të mbrojtura.

Mirëmbajtja e pyjeve ekzistuese përmes ruajtjes dhe menaxhimit, mbrojtjes, rehabilitimit, rigjenerimit, pyllëzimit, ripyllëzimit dhe mbjelljes së pemëve, me qëllim të ruajtjes dhe rivendosjes së ekuilibrit ekologjik.

Gjithashtu duhen zbatuar strategji dhe teknika për parandalimin e zjarreve, përfshirë këtu kapacitetin për reagim të shpejtë si dhe ndërgjegjësimin e komunitetit për rrezikun ndaj zjarrit dhe masat preventive.

Gjuetia ilegale është një tjetër problematikë, për të cilën forcimi i masave ligjore dhe zbatimi i operacioneve të rregullta mbikqyrëse është një mjet për luftimin e dëmeve.

### **Menaxhimi i mbeturinave**

Në Planin Zhvillimor Komunal, fusha e menaxhimit të mbeturinave është trajtuar si një çështje komplekse dhe sfiduese që kërkon një sërë ndërhyrjesh për të përmirësuar infrastrukturën ekzistuese dhe për të adresuar mungesat në zbatimin e politikave dhe nismave për menaxhimin e mbeturinave.

Fillimisht, problemi i infrastrukturës së pamjaftueshme dhe mungesa e zbatimit të nismave efektive kanë bërë të vështirë jo vetëm grumbullimin dhe transportin, por edhe trajtimin dhe deponimin e duhur të mbeturinave. Kjo çështje është theksuar edhe më shumë nga përpjekjet e kufizuara të komunës për të organizuar shërbimin e grumbullimit dhe transportin e mbeturinave të vëllimshme dhe të ndërtimit/demolimit, të cilat kanë dështuar për shkak të mungesës së infrastrukturës adekuate dhe sfidave organizative. Prania e deponive ilegale, veçanërisht ato që përmbajnë mbeturina nga ndërtim/demolimi, ka ngritur shqetësime serioze mjedisore. Për të adresuar këtë problem, VSM propozon kryerjen e studimeve për të vlerësuar shkallën e ndotjes nga këto deponi dhe organizimin e pastrimit të tyre. Këto studime do të ndihmojnë në hartimin e strategjive për trajtimin e duhur të mbeturinave në të ardhmen dhe minimizimin e hedhjeve të paligjshme.

Mungesa e të dhënave të sakta dhe të besueshme për sasinë dhe përbërjen e mbeturinave urbane ka bërë të vështirë vlerësimin e nevojave dhe planifikimin e shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave. Planifikimi i ri kërkon përmirësimin e metodave të mbledhjes së të dhënave për të siguruar një bazë të fortë informative që do të mbështesë vendimmarrjen e informuar dhe zhvillimin e politikave efektive.

Iniciativat për riciklim janë të kufizuara dhe mbeten sporadike, kryesisht të kufizuara në projekte pilot që nuk janë të mjaftueshme për të përballuar sasinë në rritje të mbeturinave që prodhohen në komunë. Planifikimi përfshin nisma për të rritur grumbullimin e ndarë të mbeturinave dhe për të nxitur riciklimin dhe kompostimin si pjesë të një strategjie më të gjërë për reduktimin e mbeturinave.

Masat e propozuara për adresimin e sfidave lidhur me menaxhimin e mbeturinave komunale:

Implementimi i kontejnerëve për kompostim në zonën urbane;

Zhvillimi i metodave të sakta për matjen dhe analizimin e mbeturinave përmes mostrave nga kamionët e grumbullimit, për përcaktimin e saktë të sasisë dhe rrymave të mbeturinave;

Ngritja e infrastrukturës së nevojshme për grumbullimin e ndarë të mbeturinave të riciklueshme, të rrezikshme dhe atyre organike; Ngritja e sistemit të monitorimit dhe vlerësimit të efektivitetit të programeve për grumbullimin e ndarë të mbeturinave;

Zhvillimi dhe Implementimi i sistemeve të riciklimit dhe kompostimit në bashkëpunim me sektorin privat dhe publik;

Identifikimi i vendeve të përshtatshme për qendrat e kompostimit dhe riciklimit, si dhe sigurimi i monitorimit dhe mirëmbajtjes së duhur të objekteve të kompostimit;

Identifikimi i vendeve të hedhjes ilegale, hartimi dhe zbatimi i planeve për pastrimin dhe rehabilitimin e këtyre lokacioneve;

Ngritja e kapaciteteve për inspektim mjedisor;

## X. PLANI I MONITORIMIT

Monitorimi në vetvete, është grumbullimi sistematik, analiza dhe përdorimi i informacionit mbi progresin e një strategjie, plani, programi apo projekti, në një periudhë të caktuar. Ai jep mundësinë për konstatimin e problemeve dhe zgjidhjen e tyre gjatë zbatimit. Bazohet në objektivat e caktuara dhe aktivitetet e planifikuara gjatë fazave të planifikimit të procesit, duke ndihmuar në ruajtjen e përqendrimit dhe kapacitete më të mira të manaxhimit. Ligji Nr. 03/L-230 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor mandaton autoritetet përgjegjëse të monitorojnë efektet e mundshme mjedisore të secilit plan apo program, me qëllim identifikimin e efekteve të kundërta, të paparashikuara, në një fazë më të hershme, që të mund të ndërmerren veprime të menjëhershme rehabilituese.

Deri më sot, Kosova ka ndjekur përafrimin me standardet mjedisore të BE-së me përpertime të rëndësishme në legjislacion në lidhje me mbrojtjen e mjedisit në tërësi, VNM, VSM, IPPC (International Plant Protection Convention) dhe Mbrojtjen e Natyrës. Mbrojtja e Mjedisit, VSM, VNM dhe Planifikimi Hapësinor grupohen në legjislacionin horizontal dhe transpozimi i legjislacionit të BE-së në sektorin horizontal është i avancuar. Direktiva e VSM 2001/42/EC dhe Direktiva për Pjesëmarrjen Publike 2003/35/EC raportohen si të transpozuara plotësisht. Për sa i përket vlerësimit të ndikimit në mjedis, transpozimi i plotë është arritur në lidhje me dispozitat e Direktivës 2011/92/BE.

Neni 10 i Direktivës së VSM gjithashtu mandaton shtetet anëtare të monitorojnë efektet e rëndësishme mjedisore të zbatimit të planeve dhe programeve në mënyrë që, ndër të tjera, të identifikojnë në një fazë të hershme efektet negative të paparashikuara dhe të jenë në gjendje të ndërmarrin veprimet e duhura korrigjuese.

Qëllimi i planit të monitorimit është që të sigurojë të dhëna përmes të cilave vlerësohet nëse zhvillimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe standardet mjedisore që lidhen me të, për të vlerësuar shkallën e ndikimit (nëse ka), si dhe për të vlerësuar performancën mjedisore të menaxhimit të saj në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm, duke siguruar që aktivitetet e propozuara nuk shkaktojnë nivele të papranueshme të efekteve mjedisore apo rrezik për shëndetin publik. Monitorimi i elementeve të mjedisit është aspekt kryesor për të mbajtur nën kontroll zbatimin e strategjive, planeve, programeve dhe projekteve.

Me qëllim që PZHK të zbatohet me efektivitet dhe të realizohen objektivat dhe synimet që janë paraparë me këtë plan, është e domosdoshme që të monitorohet zbatimi i të njëjtit, për të shmangur që në fazat fillestare ndikimet eventuale negative në mjedis. Në mënyrë që zbatimi i planit të monitorimit mjedisor të jetë sa më efektiv, tabela e mëposhtme i referohet objektiveve të përcaktuara për mbrojtjen e mjedisit dhe seksionin që trajton ndikimet dhe masat zbutëse. Realizimi me sukses kërkon angazhimin e institucioneve relevante, për bashkërendimin e aktiviteteve përkatëse monitoruese nën drejtimin e Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK).

Mbështetur në Ligjin Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligjin Nr. 03/L-230 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor dhe Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Komuna e Prizrenit ka për detyrë të kryej monitorimin e aktiviteteve që kryhen në kuadrin e zbatimit të PZHK-së, ku përfshihen qoftë planet, projektet e infrastrukturës që po hartohen ndërkohë, edhe detajimi i PZHK-së në Plane Rregulluese të Hollësishme për vendbanimet me nënqendra, lagje apo blloqe banimi.

Komuna e Prizrenit ka karakter administrativ dhe pa struktura të plota dhe të afta për të kryer veprimtari si monitorimi mjedisor dhe për rrjedhojë, nuk mund të mbulojë me kapacitetet dhe burimet e saj njerezore dhe financiare të gjithë këtë veprimtari. Megjithatë, me angazhimin e Drejtorisë së Urbanizmit

dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe strukturave të tjera në vartësi të saj, mund të mbulojnë një pjesë të planit të monitorimit si cilësia e ndertimeve, ecurinë me masat e pyllëzimit dhe zhvillimit të pyjeve, zgjerimit të parqeve dhe sipërfaqeve të gjelbra, ecurinë ndërtimit të rrugëve të reja përfshirë ato për qarkullimin me biçikleta dhe të tjerë indikatorë që janë paraqitur në planin e monitorimit të PZHK-së.

Sipas Ligjit për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, rezultatet e monitorimit duhet të publikohen nga Komuna, në mënyrë periodike çdo vit. Për elementet e tjerë të mjedisit dhe monitorimin, duhet të procedohet sipas ligjeve që mbulojnë fushën e VSM, dhe rezultatet t'i përcillen Komunës së Prizrenit dhe AMMK-së. Kjo e fundit ka detyrim ligjor t'i publikojë në kuadër të Raportit Vjetor për Gjendjen e Mjedisit në Republikën e Kosovës.

| Receptorët mjedisor   | Objektivat Mjedisore                                                                                                                                                                                                                     | Indikatori                                                                                                                                                                                           | Raportimi | Institucioni përgjegjes         |
|-----------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|---------------------------------|
| <b>UJI</b>            | Përmirësimi, ruajtja e cilësisë së ujit, zbutja, kufizimi dhe parandalimi i efekteve negative të aktivitetit njerëzor në territorin, përmirësimi ruajtja e aftësisë për të deponuar ujin, minimizimi i përdorimit të panevojshëm të ujit | Monitorimi i rregullt i parametrave fiziko-kimik të cilësisë së ujërave sipërfaqësore dhe ujit të pijshëm, prurjeve, pranisë së ndotësve                                                             | 6 muaj    | Komuna/DSHP<br>M IHMK<br>IKSHPK |
| <b>AJRI</b>           | Reduktimi i emetimeve të gazrave serrë (p.sh., duke promovuar çiklizmin dhe përmbushja e standardeve të Bashkimit Evropian)                                                                                                              | Monitorimi i rregullt i parametrave të cilësisë së ajrit (PM2.5 PM10, NO2, SO2, CO) në komunë, sidomos afër zonave me qarkullim të lartë dhe ato industriale                                         | Vjetor    | Komuna/DSHP<br>M AMMK/IHMK      |
| <b>TOKA</b>           | Mbrojtja, përdorimi dhe manaxhimi qëndrueshëm i tokës, parandalimi i erozionit të tokës, ruajtja e kapacitetit prodhues të tokës (kullosave)                                                                                             | Zvogëlimi i sipërfaqeve që janë subjekt i erozionit dhe degradimit;<br>Nivelet e lëndës organike në tokë;<br>Ndryshimet pozitive në mbulesën bimore;<br>Vëzhgimi i ndryshimeve në përdorimet e tokës | Vjetor    | DBZHR<br>MBPZHR                 |
| <b>BIODIVERSITETI</b> | Mbrojtja dhe manaxhimi i qëndrueshëm i biodiversitetit, ruajtja e specieve organike dhe                                                                                                                                                  | Numri i llojeve të pranishme dhe shpërndarja e grupimeve të llojeve në natyrë; kategorizimi (të                                                                                                      | Vjetor    | AMMK                            |

|                                           |                                                                                                                                                                                                                                                   |                                                                                                                                                                                                                    |        |                                                                                                     |
|-------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                                           | habitateve në funksion të ruajtjes së ekosistemeve, veçanërisht specieve endemike dhe endemorelikte të rralla dhe të kërcënuara                                                                                                                   | rralla, endemike, të kërcënuara); Cilësia dhe madhësia e habitateve natyrore; Shumëllojshmëria biologjike përmes Indekseve të Diversitetit                                                                         |        |                                                                                                     |
| <b>PYJET</b>                              | Manaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve në funksion të garantimit të aftësisë vetë ripërtëritëse të ekosistemit pyjor, zbutjes së efekteve të ndryshimeve klimatike                                                                                      | Sipërfaqja e mbuluar me pyje<br>Shkalla e degradimit                                                                                                                                                               | 2 vite | DBZHR                                                                                               |
| <b>PEIZAZHI DHE EKOSISTEMET</b>           | Rivitalizimi i ekosistemeve dhe peizazheve të prekura nga aktivitetet njerëzore, ruajtja e karakteristikave të dallueshme të peizazhit dhe pamjeve, ruajtja e trashëgimisë kulturore, historike dhe arkitekturore, duke përfshirë traditat lokale | Ndërhyrjet në peizazh<br>Ndryshimet në përdorimet e tokës                                                                                                                                                          | Vjetor | Komuna/DPU                                                                                          |
| <b>KLIMA</b>                              | Ndërtimi i infrastrukturës duke mos kontribuar në ndryshimet klimatike, reduktimi i emetimeve të gazrave serrë duke promovuar mobilitetin urban, çiklizmin dhe ecjen                                                                              | Emisionet e gazrave serrë; Sipërfaqja e objekteve (m <sup>2</sup> ) me izolim adekuat; Sipërfaqja (m <sup>2</sup> ) e paneleve solare të instaluara dhe sipërfaqja e ngrohur nga energjia e erës (m <sup>2</sup> ) | Vjetor | Komuna<br>Ministria e Ekonomisë<br>MMPHI                                                            |
| <b>TRASHËGIMIA NATYRORE DHE KULTURORE</b> | Konservimi e restaurimi, ruajtja e trashëgimisë kulturore, historike dhe arkitekturore, duke përfshirë traditat lokale                                                                                                                            | Statusi i monumenteve dhe hapësirave të mbrojtura dhe restauruara                                                                                                                                                  | Vjetor | Komuna/DKRS<br>Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve<br>Instituti i Kosovës për Mbrojtje të Natyrës |

| SHËNDETI | Përmirësimi i shëndetit të popullatës njerëzore, garantimi i zhvillimit social dhe ekonomik në harmoni me mjedisin dhe burimet natyrore dhe ulja e ekspozimit ndaj rrezikut natyror | Statistikat e sëmundjeve lidhur me ndotjen mjedisore dhe prania e grupeve vulnerabël | Vjetor | Komuna/DSH MS |
|----------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------|--------|---------------|
|----------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------|--------|---------------|

Tabela 13 Plani i Monitorimit Mjedisor

## XI. PËRFUNDIME

Raporti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor i PZHK së Komunës së Prizrenit ka për qëllim të integrojë sistematikisht çështjet mjedisore. Gjatë implementimit të PZHK si dhe procesit të vendimmarrjes, VSM synon të marrë masa plotësuese për projektet të cilat do të realizohen. VSM, si e tillë përkufizohet si:

Një nga instrumentet kyç për integrimin e çështjeve mjedisore dhe parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në planifikimin strategjik dhe vendimmarrjen. Ai është një mjet i njohur globalisht për planifikimin me pjesëmarrje që përdoret për të analizuar dhe përfshirë çështjet e mjedisit në politikat, planet dhe programet e propozuara;

Instrument i cili do të sigurojë udhëzime për menaxhimin e qëndrueshëm të aspekteve dhe konsideratave mjedisore të PZHK-së;

VSM do të jep udhëzime për përfshirjen e çështjeve mjedisore në projektet të cilat do të realizohen në të ardhmen;

Raporti i VSM-së propozon rregullore institucionale për menaxhimin e qëndrueshëm të aspekteve mjedisore të PZHK-së.

PZHK prezanton profilin, konceptin e zhvillimit hapësinor, vizionin, prioritetet strategjike, strategji e masa zbatimi. Në PZHK vërehen përpjekje për të orientuar rritjen e mundshme dhe të parashikuar të popullsisë në disa nën-qendra të komunës, bazuar edhe në disa shembuj të përkufizimit të zonave të ndërtimit (jo në definim të zonave në bazë të analizave profesionale) me qëllim dendësimin në zonat që janë ende në proces zhvillimi dhe kanë synim zgjerimi edhe në zonat e reja të banimit. Zgjerimet e planifikuara marrin parasysh edhe shërbime të qëndrueshme rreth këtyre vendbanimeve.

PZHK ka rol përmbajtësor edhe në ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe trashëgimisë së ndërtimeve. PZHK, bashkë me sygjërimet që dalin nga VSM, mundohen të ndikojnë pozitivisht në revitalizimin e ekosistemeve të degraduara, ripyllëzimin e zonave të zhveshura, pyllëzimin e disa zonave që vazhdimisht janë nën ndikimin e erozionit, etj. Pozitivisht do të ndikojë edhe në ruajtjen e zonave të pasura me ujëra nëntokësore, ekosistemeve të lumenjve nga degradimi dhe nga ndërtimet pranë brigje të lumenjve.

Gjatë përpilimit të raportit të VSM, janë hasur sfida, si mungesa e studimeve në fushën e mjedisit, informata, hulumtime dhe analiza profesionale. PZHK ka definuar disa tregues numerik ose kualitativ për disa pika, vija dhe sipërfaqe të rëndësishme për trajtim adekuat të aspektit mjedisor të planit, vlen të theksohet se në zonat e zhvillimeve të reja të infrastrukturës (korridoret rrugore), zona industriale (sipërfaqja), ndikimi i tyre në korridoret e qarkullimit të shtazëve, masa të duhura për qarkullim natyrorë të shtazëve dhe llojeve bimore nga një habitat në tjetrin, zonat me ujëra nëntokësore, zonat me erozion,

zonat e deponive dhe të ndotjes, zonat me mundësi pyllëzimi dhe ripyllëzimi, shiritat e gjelbër, tampon zonat, parqet, si dhe janë treguar disa zona të ndotura, për të cilat kanë munguar informatat për tokat e ndotura nga pesticidet apo nivelet e metaleve të rënda. Këto zona apo vija të infrastrukturës përmenden edhe në pjesën strategjike. Një sfidë e veçantë mbetet zbatimi në praktikë i synimeve të PZHK-së; për pyllëzim, ripyllëzim, shirita të gjelbër, tampon zona, dhe në përgjithësi shtimin e hapësirave të gjelbra, krijimi i zonave rekreative dhe përmirësimi i treguesve mjedisorë të komunës.

VSM miraton qasjet novatore drejt dekarbonizimit, duke harmonizuar zgjerimin e rrjetit primar të energjisë termike me një inkurajim të fuqishëm për adoptimin e energjisë së rinovueshme në zhvillimet e reja. PZHK nënvizon rëndësinë e diversifikimit të burimeve të energjisë dhe hap pas hapi reduktimin e varësisë ndaj lëndëve djegëse fosile. Theksi vihet në zgjedhjen e përgjegjshme të vendit për projektet e energjisë diellore. Prioritizimi i zonave jo të punueshme bujqësore dhe më pak të ndjeshme siguron përçarje minimale në zonat thelbësore bujqësore dhe ekologjike, duke zbutur kështu konfliktet e mundshme midis infrastrukturës energjetike dhe peizazheve jetike natyrore. Qasja garanton ndikim minimal në rrugët e migrimit të kafshëve të egra dhe korridoret natyrore, duke siguruar lëvizjen e pandërprerë të faunës.

## **XII. LITERATURA**

(UNECE), n. N. (1998, June 25). Convention on Access to Information, Public Participation in Decision-making and Access to Justice in Environmental Matters. Aarhus, Denmark.

AMMK. (2022, Gusht). Raport vjetor për gjendjen e mjedisit. Prishtinë.

Kosovës, R. e. (2009, Prill 06). Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit. Prishtinë.

Kosovës, R. e. (2010, Tetor 29). Ligji Nr. 03/L-230 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor. Prishtinë.

Programme, U. N. (2009). Planning Sustainable Cities-Global Report on Human Settlements. London: Earthscan.

Union, E. (2001, June 27). Directive 2001/42/EC on the assessment of the effects of certain plans and programmes on the environment.

Union, E. (2003, May 26). Directive 2003/35/EC for public participation.

Union, E. (2011, December 13). Directive 2011/92/EU on the assessment of the effects of certain public and private projects on the environment.

Instituti Hidrometeorologjik I Kosovës, Vjetari Hidrometeorologjik 2023

.American Planning Association (Steiner Frederick and Butler Kent eds.). 2010. Standardet e planifikimit dhe projektimit urban, Ufo University Press;

Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK). Raport Vjetor për Gjendjen e Mjedisit, 2023

Komuna e Vitise. 2025 Hartat e prezantuar në PZHK

Draft Harta Zonale Komunale e Vitise 2025-2031;

Emetimi i gazeve serrë në Kosovë 2008 – 2009; UNDP- Kosovë;

Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin; 2011 – 2020;

Millennium Development Goals Global Targets-Local Approaches.

Qendra Rajonale e Mjedisit. REC.

Strategjia për Menaxhim të Integruar të Mbeturinave 2024-2030 dhe Plani i Veprimit 2024-2027

Raporti i Menaxhimit të Mbeturinave Komunale në Kosovë 2022

Vlerësimi i Rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera për Komunën e Prizrenit

Instituti të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, AMMK

Raport Monitorimi i Sektorit të Mjedisit në Nivel Komunal, 2023. EC Ma Ndryshe

**RAPORT I VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR (VSM) PËR PLANIN ZHVILLIMOR KOMUNAL TË KOMUNËS SË PRIZRENIT  
(2025-2033)**

Raport i Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) për Planin Zhvillimor Komunal të Komunës së Prizrenit (2025-2033) është hartuar në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-230 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, Direktivën 2001/42/EC të BE-së, si dhe aktet nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Përgatitja e këtij dokumenti është bërë mbi bazën e të dhënave zyrtare, analizave mjedisore, pjesëmarrjes së institucioneve komunale dhe konsultimeve me aktetë relevante, duke marrë në konsideratë parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe mbrojtjes së mjedisit.


Përgatitësi i Dokumentit

Instituti për Shkencë dhe Teknologji – INSI Sh.P.K

Ismajl Baftijari



Valon Germizaj



Reshat Azizi



Data: 08.08.2025